

Janar 2023
Numri: 178
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.progresibotime.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

ALLAHU DO TA PLOTËSOJË DRITËN E TIJ



revistaetika



progresibotime

Fjala më e bukur është Libri i Allahut. Rruga më e mirë është sunneti profetik. Streha më e sigurt është devotshmëria. Të folurit më me virtyt është përmendja e Allahut.

Tregimet më të bukura gjenden në Kuran. Rrugët më të ndritura janë rrugët udhëzuese të profetëve.

Dija më e mirë dhe më e dobishme, është ajo që kthehet në kulturë. Justifikimi më i keq është ai që bëhet në momentin e vdekjes. Pendimi më i keq, është ai në ditën e kiametit. Pasuria më e mirë, është ajo e zemrës.



Besimtarët janë në trupa të ndryshëm, ata janë të detyruar ta konsiderojnë njëri-tjetrin si organet e një trupi që jetojnë me një zemër të vetme. Ashtu siç i gjithë trupi e ndjen dhimbjen e një organi, edhe perceptimi i vuajtjeve të vëllezërve të fesë, është një sprovë ndërgegjeje për të gjithë besimtarët.

Allahu i Lartëmadhëruar i ka krijuar njerëzit nevojtarë ndaj njeri-tjetrit. Shoqëria, ashtu si ka klasën e pasur dhe të fortë, ka e do të ketë gjithmonë edhe klasën e të dobëve, të njerëzve me probleme shëndetësore dhe të nevojtarëve. Ne duhet të pyesim veten: "Pse i krijoi Allahu i Lartëmadhëruar nevojtarët?" Përgjigjja dihet: "Nevojtarët janë amanet i Allahut (xh.sh.), që ua ka lënë jonevojtarëve." Këtë përgjegjësi e ka dhënë Vetë Allahu.



Janar 2023

VITI: XVII

NUMRI: 178

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

ËEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Allahu do ta plotësojë dritën e Tij dhe do t'i vë frerët e botës (udhëheqjen) në duart e njerëzve të devotshëm. Por realizimi i kësaj është i lidhur me ngritjen tonë në gradën e devotshmërisë. Dhe kjo nuk do të realizohet pa i edukuar nefset tona. Ne nuk do ta arrijmë devotshmërinë derisa ta bëjmë dritë nefsin, zemrën dhe trupin tonë dhe derisa ta bëjmë dritën e Allahut (xh.xh.), të dominojmë në tokë, e cila na është dhënë si amanet.

Abdullah ibn Amri (r.a.), kishte një fletore që e quante Sahifetu's-Sadika, në të cilën kishte mbledhur hadithe. Një ditë, pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut (a.s.), ai u pyet nëse Roma apo Stambolli do të çlirohej më parë. Hz. Abdullahu e nxori fletoren e hadithit, i hodhi një sy dhe u përgjigj siç vijon:

«Ndërsa po rrinim rreth të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe po shkruanim një hadith fisnik, dikush pyeti: "Cili nga qytetet do të çlirohej më parë, Stambolli apo Roma?" I Dërguari i Allahut, (a.s.), u përgjigj kështu:

"Së pari do të çlirohet Stambolli, qyteti i Herakliut."

Stambolli vetë u çlirua nga një ushtri e bukur dhe nga një komandant i mirë. Tani është radha e Romës. Ajo është në pritje për t'u çliruar. Kjo është molla jonë e kuqe (qëllimi ynë). Çlirimi i Romës është një horizont i vendosur para nesh nga vetë i Dërguari i Allahut (a.s.). Ky horizont, i cili është vendosur më shumë se 1400 vjet më parë, kur të mendohet bashkë me premtimin se Allahu Teala do ta plotësojë dritën e Tij, atëherë do të thotë se do të realizohet në mënyrë të sigurt.

Toka është e Allahut. Këtu herët apo vonë do të mbizotërojnë mirësia dhe e vërteta, përpjekjet e atyre që shkatërrojnë do të shkojnë dëm dhe Allahu (xh. xh.), me siguri do ta plotësojë dritën e Tij. Fakti që Allahu do ta plotësojë dritën e Tij, do të thotë se e vërteta përfundimisht do të mbizotërojë mbi supozimet dhe gabimet që mendohen se janë të drejta. Islami në këtë kontekst është e vërteta më e madhe. Me siguri do të dalë në pah se ai është i vetmi sistem shpëtimi dhe lumturie. Allahu është drita e qiejve dhe e tokës.

Shfaqja e asaj drite është Islami, është Kurani, është i Dërguari i Allahut (a.s.). Përsosmëria e njeriut realizohet me dritë. Ai duhet të jetë në përpjekje të vazhdueshme për ta shtuar dritën e tij. Të duash që drita të shtohet, do të thotë të duash të jesh në siratu'l-mustekim. Ky drejtim, të cilin e kërkojmë dyzet herë në ditë, është një qëllim që e ëndërrojmë aq shumë saqë, kurrë nuk duhet t'i mungojë gjuhës si lutje:

"O Zoti ynë! Na e plotëso dritën tonë dhe na fal. Pa dyshim, fuqia Jote mjafton për çdo gjë." (Tahrim, 8) Kjo lutje gjendet edhe ndërmjet duave të të Dërguarit të Allahut (a.s.): ***"O Allah! Më jep dritë në zemër, në sy, në veshë, djathtas, majtas, sipër meje, poshtë meje, para meje, pas meje dhe ma shto dritën."*** (Buhari, «Da'avat», 9.

Duhen myslimanë që të jenë
në zjarr po nuk digjen
Muhamed Jusuf

12

Përmbajtja



8

Kalorësit trima
që ndriçojnë errësirën
Dr. Adem Ergyl



Çfarë është Drita e Allahut?
Dr. A. Hamdi Jëllderëm

16



10

30



Imam Maliku (a.s.)
Osman Nuri Topbash

- 5 Allahu do ta plotësojë dritën e tij
Mehmet Lutfi Arslan
- 10 Po lind dielli i Islamit
Prof. dr. Sulejman Derin
- 18 Të mos i japim mundësi
padrejtësisë dhe të padrejtit
Iskender Karajigjit
- 20 A është islami në krizë?
Hashim Akën
- 24 Pengesat në rrugë
Dr. Murat Kaja
- 26 Fryma është ringjallje në përjetësi
Rabia Brodbeck
- 28 Allahu do ta plotësojë mirësinë
e të Dërguarit të Tij
Abdullah Sert

26

- H.z. Jusufi (a.s.) dhe H.z. Musai (a.s.) - 2 36
(Një krahasim etno-psikologjik)
Et'hem Xhebexhiollu
- O Allah ne preokupo 39
me adhurimin ndaj Teje
Sadik Dana
- Modeli i Aishes dhe Ummu Sherik (r.a.) 40
në predikimin e Islamit
Shefika Kaja Meriç


22

Fjala e ditës
dhe dëmet e saj
Adem Shahin



Aventura martesore
Esin A. Tyxhar

43



ALLAHU

DO TA PLOTËSOJË DRITËN E TIJ

— Mehmet Lutfi Arslan —

Allahu do ta plotësojë dritën e Tij dhe do t'i vë frerët e botës (udhëheqjen) në duart e njerëzve të devotshëm. Por realizimi i kësaj është i lidhur me ngritjen tonë në gradën e devotshmërisë. Dhe kjo nuk do të realizohet pa i edukuar nefset tona. Ne nuk do ta arrijmë devotshmërinë derisa ta bëjmë dritë nefsin, zemrën dhe trupin tonë dhe derisa ta bëjmë dritën e Allahut (xh.xh.), të dominojmë në tokë, e cila na është dhënë si amanet.

Abdullah ibn Amri (r.a.), kishte një fletore që e quante Sahifetu's-Sadika, në të cilën kishte mbledhur hadithe. Një ditë, pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut (a.s.), ai u pyet nëse Roma apo Stambolli do të çlirohej më parë. Hz. Abdullahu e nxori fletoren e hadithit, i hodhi një sy dhe u përgjigj siç vijon:

«Ndërsa po rrinim rreth të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe po shkruanim një hadith fisnik, dikush pyeti: “Cili nga qytetet do të çlirohej më parë, Stambolli apo Roma?” I Dërguari i Allahut, (a.s.), u përgjigj kështu:

“Së pari do të çlirohet Stambolli, qyteti i Herakliut.”

Stambolli vetë u çlirua nga një ushtri e bukur dhe nga një komandant i mirë. Tani është radha e Romës. Ajo është në pritje për t'u çliruar. Kjo është molla jonë e kuqe (qëllimi ynë). Çlirimi i Romës është një horizont i vendosur para nesh nga vetë i Dërguari i Allahut (a.s.). Ky horizont, i cili është vendosur më shumë se 1400 vjet më parë, kur të mendohet bashkë me premtimin se Allahu Teala do ta plotësojë dri-

tën e Tij, atëherë do të thotë se do të realizohet në mënyrë të sigurt.

Toka është e Allahut. Këtu herët apo vonë do të mbizotërojnë mirësia dhe e vërteta, përpjekjet e atyre që shkatërrojnë do të shkojnë dëm dhe Allahu (xh.xh.), me siguri do ta plotësojë dritën e Tij. Fakti që Allahu do ta plotësojë dritën e Tij, do të thotë se e vërteta përfundimisht do të mbizotërojë mbi supozimet dhe gabimet që mendohen se janë të drejta. Islami në këtë kontekst është e vërteta më e madhe. Me siguri do të dalë në pah se ai është i vetmi sistem shpëtimi dhe lumturie. Allahu është drita e qiejve dhe e tokës.


Shfaqja e asaj drite është Islami, është Kurani, është i Dërguari i Allahut (a.s.). Përsosmëria e njeriut realizohet me dritë. Ai duhet të jetë në përpjekje të vazhdueshme për ta shtuar dritën e tij. Të duash që drita të shtohet, do të thotë të duash të jesh në siratu'l-mustekim. Ky drejtim, të cilin e

kërkojmë dyzet herë në ditë, është një qëllim që e ëndërrojmë aq shumë sa që, kurrë nuk duhet t'i mungojë gjuhës si lutje:

“O Zoti ynë! Na e plotëso dritën tonë dhe na fal. Pa dyshim, fuqia Jote mjafton për çdo gjë.” (Tahrim, 8)

Kjo lutje gjendet edhe ndërmjet duave të të Dërguarit të Allahut (a.s.): “O Allah! Më jep dritë në zemër, në sy, në veshë, djathtas, majtas, sipër meje, poshtë meje, para meje, pas meje dhe ma shto dritën.» (Buhari, «Da'avat», 9.)

Mendja e ndritur është



të mendja e devotshme. Kjo mendje e koncepton anën e brendshme të ngjarjeve. Ajo e di se kush janë njerëzit dhe se kë duhet të vlerësojë e sa duhet ta vlerësojë. Megjithatë, në këtë botë, e cila është një vend i shtypjes, shkujdesjes dhe mashtrimit, shumë pak njerëz e arrijnë përsosmërinë e mendjes ose të gjithë dritën. Ahireti (bota tjetër) është koha kur do të hiqen perdet dhe do të dihet dallimi mes të vërtetës, dritës dhe mendjes. Ja pra, atëherë gjithçka do të zbulohet qartë: **“Ti ishe në shkujdesje dhe sot ne ta kemi hequr perden. Tashmë sytë e tu janë të mprehtë.”** (Kaf, 22)

Plotësimi i dritës do të thotë që mendja të përsoset dhe që çdo pjesë e trupit të shkëlqejë me këtë dritë e të ketë një qëndrim dhe ecje në harmoni me dritën e tokës dhe të qiellit. Një nivel i tillë do të thotë jo vetëm shpëtim nga errësira, por edhe një degë e vetë dritës. Sepse Allahu, i cili është “en-Nur”, është edhe burimi i dritës: **“Allahu është Drita e qiejve dhe e Tokës. Drita e Tij shëmbëllen me atë të një kamareje, në të cilën ndodhet një llambë. Llamba është në një kristal, kurse kristali është si një yll i shndritshëm. Ajo (llamba) ndizet nga druri i bekuar i ullirit, as lindor, as perëndimor, ndërsa vaji i saj shkëlqen edhe pa e prekur zjarri. Dritë sipër dritës. Allahu udhëzon drejt dritës së Tij kë të dojë dhe paraqet shembujt për njerëzit. Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.»** (Nur, 35)

Plotësimi i dritës tek njeriu do të thotë përsosmëri e mendjes, e cila është mjeti për të ndarë dritën nga errësira, të drejtën nga e gabuara dhe të mirën nga e keqja, kurse përsosmëria e mendjes është devotshmëria. Devotshmëria është një gradë drejt së cilës mund të shkohet me qëllimin dhe përpjekjen e njeriut, por që mund të arrihet vetëm me mirësinë e Zotit (xh.xh.). Njeri i devotshëm do të thotë njeri i mirë, i mbarë, i dobishëm dhe i rregullt, pra është i kundërta i ngatërrestarit dhe prishësit. Mallrat më të pastra dhe hallall janë ato më të mirat, fëmijët më të mirë janë fëmijët e devotshëm, populli më i virtutshëm është populli i devotshëm, veprat më të pranuar janë veprat e mira, gratë më të dëlira janë gratë e devotshme dhe njerëzit më të mirë janë njerëzit e devotshëm. Allahu i ka ndarë njerëzit pjesë-pjesë (shik. A'raf, 168), duke i përshkruar ata si disa të devotshëm dhe disa që nuk e kanë arritur dot këtë gradë.

Të jesh i devotshëm do të thotë të bësh vepra të mira. Të devotshmit janë një grup që përkujtohet me profetët, të singertët dhe dëshmorët. Ata janë njerëz që e besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, urdhërojnë të mirën dhe e ndalojnë të keqen dhe

garojnë në vepra të mira. Miku i tyre është Allahu, mbrojtësi i tyre është përsëri Allahu (xh.xh.). Të devotshmit janë besimtarë të zgjedhur të cilët kanë marrë selamin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.) dhe selamin e Allahut (xh.xh.), që përmenden të tehijjat. Ata kanë një pozitë të lakmueshme. Aq shumë saqë në lutjet e shumë profetëve gjendet kërkesa për t'u bashkuar me të devotshmit:

Ibrahimi, (a.s.), u lut: **“O Zoti im! Më jep urtësi dhe më përfshi në mesin e të devotshmëve.»** (Shuara, 83) Po ashtu, u lut që djali i tij të ishte prej të devotshmëve: **“O Zot! Më jep (një djalë) prej të devotshmëve!”** (Saffat, 100)

Edhe Jusufi, (a.s.), iu lut Zotit: **“O Zoti im, që i ke krijuar qiejt dhe tokën nga asgjëja! Ti je kujdestari im, ma merr jetën si mysliman dhe më përfshi në mesin e robërve të Tu të devotshëm!”** (Jusuf, 101)

Edhe Sulejmani (a.s.), kërkoi që të ishte me të devotshmit duke u shprehur: **“...O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!”** (Neml, 19)

Edhe për Jahjanë (a.s.), i cili iu dha si përgëzim Zekerijas, (a.s.) dhe emri i të cilit është vendosur nga Allahu, është përdorur shprehja i devotshëm: **“...Allahu të jep lajmin e mirë për Jahjanë, i cili do të vërtetojë Fjalën e Allahut (Isanë a.s.), do të jetë një fisnik, i dëlirë dhe profet, një prej të devotshmëve.”** (Al Imran, 39)

Të devotshmit, të cilët përpiqen të zënë vend ndërmjet pejgamberëve dhe të përfshijnë aty edhe pasardhësit e tyre, janë ata që bëjnë vepra të mira dhe këshillojnë të vërtetën dhe durimin. Slogani i tyre është rregullimi, kurse ajo që e kundërshtojnë është prishja. Jetën e tyre e kalojnë me përpjekje për shfaqjen e së mirës dhe së drejtës. Disa e shohin rezultatin e kësaj përpjekjeje si trashëgim të tokës derisa janë gjallë, ndërsa të tjerë e shohin atë si rend në fushën e pushtetit. Por në një mënyrë apo tjetër, të devotshmit do ta trashëgojnë tokën. Kjo trashëgimi ndodh me përfaqësim ose me të vërtetë në jetën e kësaj bote, dhe në të vërtetë në botën tjetër.

Kjo botë është një shtrat, i cili është përgatitur dhe shtrirë për të devotshmit, në të cilin ka male, lumenj, rrugë dhe gjallesa, i zbukuruar me gjelbërim dhe kafshë, i mbjellë me një shumëllojshmëri të madhe bimësh. Është një mundësi meditimi, i zbukuruar me argumente të ndryshme, për ata që


mendojnë dhe marrin mësim. Viza e xhenetit është në këtë botë. Në fund të sures Zumer, njerëzit e devotshëm që do të dërgohen në xhenet grupe-grupe do ta lavdërojnë Allahun duke thënë: **“Falënderimi i takon Allahut, i Cili na qëndroi besnik në premtimin e Tij dhe na ka bërë trashëgimtarë të tokës. Në xhenet mund të qëndrojmë ku të duam. Sa i bukur është shpërblimi i atyre që punojnë.”** (Zumer, 74)

Të devotshmit janë me Zotin përderisa të jenë të devotshëm, sepse Zoti u ka premtuar atyre tokën. E vërteta e shprehur në librin tonë: **“Nëse një njeri i shtypur në një vend dëshiron të shpërngulet, ai do të gjejë shumë vende të frytshme dhe hapësira për të shkuar në tokë.”** (Nisa, 100), del në pah me të devotshmit. Të devotshmit janë kaq të rëndësishëm për sa u përket qëllimeve të tyre, saqë ne duhet t'i kuptojmë jo ata nga vendi ku kanë shkuar, por vendin me ata. Është fryma e devotshmërisë ajo që e bëri Jethribin Medine. Në këtë kuptim, devotshmëria është edhe emri i kuptimit, bollëkut, vullnetit dhe dëshirës... Dhe më e rëndësishmja, devotshmëria është adresa e dritës.

Ne jemi trashëgimtarët dhe shërbëtorët e premtimit se Allahu do ta plotësojë dritën e Tij. Ky premtim është edhe ëndrra, edhe realiteti ynë. Kjo e vërtetë na është bërë borxh në qafë me ajetin: **“Ne shënuam në Zebur, pas Teuratit, që tokën (e Xhenetit) do ta trashëgojnë robërit e Mi të devotshëm.”** (Enbija, 105) Allahu me siguri do ta plotësojë dritën e Tij. Ne jemi këtu për t'u bërë shkak për këtë. Të devotshmit do ta trashëgojnë tokën. Ne kemi ardhur për t'iu bashkuar atyre njerëzve të devotshëm.

Kushti i trashëgimisë është të jesh i devotshëm dhe të qëndrosh kundër prishjes. Ne kemi ardhur për të trashëguar tokën dhe për t'u bashkuar me të devotshmit. Andaj detyra jonë është: Të ndihmojmë të mirën dhe të parandalojmë të keqen. Kjo kauzë është kauza e Islamit, e cila nuk ka ndryshuar që nga koha e Ademit (a.s.). Allahu i ka dërguar pasardhësit e Ademit (njerëzit) për të qenë të devotshëm dhe këtë e ka lidhur me kushtin e përpjekjes për vendosjen e mirësisë. Kushdo që ka punuar për këtë kuptim, Allahu e ka bërë atë qendër të tokës, sepse toka faktikisht ekziston për këtë përpjekje.

Çlirimi i Romës është horizonti përpara umetit. Nëse nuk ecim në këtë botë me këtë kuptim, nuk është e mundur që ne të jemi një umet i denjë për Profetin (a.s.). Paraardhësit tanë dikur kanë punuar për këtë kuptim, janë njohur me këtë përpjekje dhe Zoti ynë i ka bërë qendër të tokës. Edhe ne duhet



“...Allahu e përsos dritën e Vet, edhe nëse (këtë gjë) e urrejnë jobesimtarët.”

(Saf, 8)

Toka është e Allahut. Këtu herët apo vonë do të mbizotërojnë mirësia dhe e vërteta, përpjekjet e atyre që shkatërrojnë do të shkojnë dëm dhe Allahu (xh.xh.), me siguri do ta plotësojë dritën e Tij. Fakti që Allahu do ta plotësojë dritën e Tij, do të thotë se e vërteta përfundimisht do të mbizotërojë mbi supozimet dhe gabimet që mendohen se janë të drejta.

të jemi trashëgimtarë të të njëjtit kuptim dhe si rrjedhojë, të tokës si ata. Trashëgimia është devotshmëri. Devotshmëri do të thotë të veprosh kundër prishjes kudo që ka dhe mobilizim për të rregulluar atë që kemi. Devotshmëri do të thotë të mos demoralizohesh, të mos kesh frikë, të mos hezitosh dhe ta pranosh si detyrë përhapjen e emrit të lartë të Allahut në të gjithë rruzullin tokësor.

Kjo e vërtetë është një ligj hyjnor i pandryshueshëm: **“...Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë çfarë kanë në vetvete...”** (Rad, 11) Allahu do ta plotësojë dritën e tij dhe frerët e kësaj bote (udhëheqjen) do t'ua japë të devotshmëve. Por realizimi i kësaj është i lidhur me ngritjen tonë në gradën e devotshmërisë. Dhe kjo nuk do të realizohet pa i edukuar nefset tona. Ne nuk do ta arrijmë devotshmërinë derisa ta bëjmë dritë nefsin, zemrën dhe trupin tonë dhe derisa ta bëjmë dritën e Allahut (xh.xh.), të dominojmë në tokë, e cila na është dhënë si amanet. Zoti na dhëntë suksese!

Kalorësit trima që ndriçojnë errësirën

— Dr. Adem Ergyl —

Natyrisht, është e pamendueshme që ky ummet, të cilit i është dhënë një mision për të ndriçuar vendet e errëta, të ulet e të presë i pafuqishëm dhe të ngecë e të zhytet në këtë botë. Ata që ulen bëhen të gjymtuar me kalimin e kohës. Andaj (besimtari) duhet të ngrihet në këmbë, të ecë, të vrapojë, madje edhe të bëhet kalorës.

Nuri dhe zulmeti, me fjalë të tjera, drita dhe errësira, janë dy koncepte që ku ekziston njëra, nuk mund të thuhet se ekziston tjetra. Zoti (xh.xh.), i paraqet mesazhet e larta dhe profetët që i dërgoi, si llamba që e nxjerrin njerëzimin nga errësira në dritë. Gjithashtu na informon për Qenien e Tij Supreme se ajo është dritë që ndriçon qiejt dhe tokën. Ai tërheq vëmendjen se idetë, ndjenjat, sjelljet dhe morali i atyre që takohen siç duhet me dritën e Zotit, janë të ndriçuara dhe se edhe ata vetë do të bëhen personalitete të ndritura e do të jenë të lumtur. Madje, drita e tyre do të shkëlqejë në fytyrat e tyre në Ditën e Gjykimit dhe ata do të ndriçojnë e do të vijnë në vendin e mahsherit si njerëz yje.

Islami është emri i kësaj drite të Zotit (xh.xh.). Është një diell përshpirtshmërie dhe udhërrëfyes që e ndriçon çdo zemër, vend dhe kohë ku hyn. Vullneti hyjnor ua cakton si detyrë besimtarëve që kjo dritë hyjnore të arrijë vend më vend, tokë më

tokë, zemër më zemër. Zemrat besimtare, duke u takuar me një dritë të tillë hyjnore, para së gjithash ndriçojnë veten e tyre, qelizë për qelizë, dhe pastaj ndriçojnë pikat e errëta të tokës si një llambë ndriçuese. Ai që u ngarkohet robërve besimtarë është ky bosht kryesor i detyrës së rindërtimit të tokës. Natyrisht, shejtanët nga njerëzit dhe nga xhindët, të cilët e kanë bërë mision të tyre padrejtësinë, do ta kundërshtojnë këtë ndriçim dhe do të përpiqen ta shuajnë, ta dëmtojnë dhe bllokojnë çdo rreze drite që shohin. Ata do ta përdorin errësirën në zemrat e tyre, të nxira nga femohimi, dhe të gjitha mundësitë e tjera të tyre, veçanërisht gjuhën, për ta mbuluar dhe shuar dritën e Islamit dhe llambën ndriçuese të Islamit, të Dërguarin e Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të. Por pavarësisht se çfarë bëjnë, ata do të fundosen ndërsa luftojnë. Shumë prej tyre do të mposhten (vdesin) si Ebu Xhehli me mërinë dhe urrejtjen e tyre. Sepse, dielli i Islamit nuk është një qiri që mund ta shuajnë me gojën e tyre. Zoti (xh.xh.), thotë:

“Ata duan ta shuajnë dritën e Allahut me gojët e tyre. Megjithatë, Allahu do ta plotësojë dritën e Tij edhe nëse jobesimtarët nuk e dëshirojnë atë.”
(Saff, 8)

I frymëzuar nga ky ajet, Zija Pasha e shpreh këtë të vërtetë siç vijon:

“Caktimi hyjnor nuk kthehet me forcën e disave.

Një dritë që e ndez Zoti dhe nuk shuhet duke i fryrë.»



Ky premtim hyjnor me siguri do të përmbushet. Edhe fatlumët që do ta përmbushin këtë vullnet të Zotit kanë ekzistuar gjithmonë në kohë dhe vende të ndryshme dhe do të vazhdojnë të ekzistojnë. Në këtë udhëtim sublim, edhe pse do të ketë prej atyre që do të mbesin mbrapa, do të lodhen, do të frikësohen, do të tundohen pas disa pëshpëritjeve mashtruese dhe do të zhyten në këtë botë dhe mirësitë e saj, prapë se prapë, me durim e këmbëngulje, me shpresë të pafundme dhe më e rëndësishmja, me besimin dhe dashurinë e fortë që kanë ndërtuar mes vetes e Zotit (xh.xh.), gjithmonë do të ketë trima (ndriçues) që do të ndriçohen me dritën e Zotit dhe do t'i ndriçojnë edhe të tjerët biidhnil-lah (me lejen e Zotit). Ky është gjithashtu një premtim hyjnor:

«O ju që keni besuar! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dijeni se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan; të përulur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit; që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi. Kjo është mirësia e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Bujar i madh dhe i Gjithëditur.» (Maide, 54)

Detyra kryesore e kalorësve trima që do të bartin dritën hyjnore është të përhapin dritën e besimit në zemrat e tyre, dritën e Islamit në jetën e tyre dhe dritën e ihsanit (mirësisë) në veten e tyre, qelizë për qelizë, dhe të mos lënë asnjë pikë errësire në personalitetin e tyre. Lutjet e mëposhtme të Profetit të Mëshirës, karakteristikë e të cilit ishte edhe «Nur-Dritë», tregojnë për një horizont të tillë:

«O Allah! Ndriçoje zemrën time, ndriçoje gjuhën time, ndriçoji veshët e mi, ndriçoji sytë e mi, më ndriço para-mbrapa, më ndriço lart-poshtë. O Allah, më jep dritë mua! Më ndriço në të djathtë dhe të majtë. Zoti im, ma rrit dhe ma shto dritën time!» (Muslim, Salatu'l-Misafirin, 181.)

Dëshmitarët e vërtetë të Zotit në tokë janë ata fatlumë që u kujtojnë bashkëbiseduesve Zotin dhe të vërtetën dhe që bëhen shkak për hapjen e një dritareje drejt dritës në zemrat e tyre (bashkëbiseduesve) me një bukuri që reflekton nga drita hyjnore në fytyrat, sjelljet dhe moralin e tyre. Në histori, ata i shohim si adhures natën dhe muxhahidë (luftëtarë) ditën. Ata i gjallërojnë, përforcojnë dhe i bëjnë të qëndrueshme vetët e tyre me begatinë e kohës së seherit (pak para agimit) që shprehet si «kijamu'l-lejl / namazi i natës» dhe më pas përpiqen të përhapin dritën e Zotit me dritën që shkëlqen në ballin e tyre, me pikat e urtësisë që derdhen nga gjuhët e tyre dhe me sharm e finesë që reflekton në veprimet e tyre. Sot, ndoshta, mund t'i konsiderojmë përpjekjet për të arritur një personalitet të tillë në fillimin e veprave të mira më të rëndësishme që duhet t'i shfaqim si besimtarë. Sepse, si mundet që ta zgjojë i fjeturi të fjeturin? Si mundet që një llambë, e cila ende nuk ndriçon për vete, të përhapë reze

drite në zemrat e tjera?

Nëse hapi i parë është të bëhesh një intelektual i tillë, hapi i dytë është të bëhesh një «siraxhu'l-munir / llambë ndriçuese» në gjurmët e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili ishte një siraxhu'l Munir, dhe që e shton dritën e reflektuar prej Hz. Pejgamberit. Formimi i një umeti (bashkësie) nga besimtarët që janë bërë yje të tilla është obligim për umetin e Muhamedit (a.s.), sepse ky është shkaku i ekzistencës së këtij umeti dhe misioni kryesor i tij:

«Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun...» (Al Imran, 110)

Ky umet, të cilit i është dhënë misioni për të ndriçuar vendet e errëta, sigurisht nuk mund të mendohet që të ulet e të presë në dëshpërim dhe të zhytet e të mbërthehet në këtë botë. Ata që qëndrojnë ulur, me kalimin e kohës bëhen të gjymtuar. Andaj duhet të ngriheni, të ecni, të vraponi dhe madje, të bëheni kalorës. Zoti (xh.xh.), duke iu referuar kuajve që shkojnë në luftë nga një vend në një vend tjetër duke ngritur pluhur me nijetin e ilaji kelimatulllahut (lartësimin e fjalës së Allahut), shprehet:

«Betohem në kuajt që vrapojnë shpejt, që nxjerrin shkëndija duke (goditur këmbët kur vrapojnë), që bastisin herët në mëngjes, që ngrejnë pluhur aty dhe që zhyten në mes të armiqve...» Duke u shprehur kështu, tërheq vëmendjen edhe te kuajt, edhe te ata kalorësit trima që nuk u tremben sytë dhe që mbartin mëshirë në zemrat e tyre.

Kjo dritë e besimtarëve të tillë, të cilët kanë në zemër dhe ballin e tyre dritë për ta nxjerrë njerëzimin nga errësira e madhe e mosbesimit në dritën e Zotit dhe për t'i bërë ata ta braktisin adhurimin e njerëzve duke i çuar drejt adhurimit të Zotit, nuk do të shuhet as kur ata të ngrihen nga varret në mëngjesin e mahsherit (Ditës së Gjykimit) e të shkojnë drejt audiencës së Zotit (xh.xh.) dhe do të vazhdojnë të shkëlqejë:

«Ditën që do të shohësh besimtarët dhe besimtarët, me dritën e tyre që shkëlqen para dhe në të djathtë të tyre (e do t'u thuhet): "Lajm i mirë sot për ju: kopshtet e Xhenetit nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të banoni përgjithmonë. Kjo është fitorja më e madhe!" (Hadid, 12)

«Atë Ditë, hipokritët dhe hipokritet do t'u thonë besimtarëve: "Na prisni edhe ne që të marrim nga drita juaj"! Por atyre do t'u thuhet: "Kthehuni prapa e kërkoni tjetër dritë!" Dhe, ndërmjet tyre, do të vendoset një mur me portë: brenda saj ka mëshirë, kurse jashtë saj ka dënim.» (Hadid, 13)

Atëherë duhet të ngrihemi dhe nuk duhet të ulemi më kurrë duke thënë: «E bëra nijet për t'u bërë kalorës.»

PO LIND Dielli i Islamit

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Kishte ende shumë kohë për ardhjen e namazit të drekës. Shumica e xhamive në Gjermani janë struktura të përbëra nga shtëpi dhe punishte. Edhe kjo ishte një xhami e tillë. Mua më tërhoqi vëmendjen një kishë madhështore me një kullë të lartë të kampanës pranë xhamisë. Shokut tim që kisha pranë i thashë: «Le të shkojmë pak në atë kishë dhe të shohim se si është frekuentimi i xhematit të saj.»



Ajeti fisnik: «**Allahu do ta plotësojë dritën e Tij edhe nëse jobesimtarët nuk e duan këtë.**» (Saff, 8), është një sihariq dhe një mbështetje morale e madhe që na jepet ne besimtarëve, sepse në këto ditë të vështira që po kalojmë, myslimanët në shumë vende të botës po persekutohen, po trajtohen keq vetëm pse janë myslimanë, e përtej kësaj, gjaku i besimtarëve po derdhet me arsyetime të parëndësishme. Po sulmohen gjërat e shenjta të besimtarëve dhe po flitet keq për Pejgamberin (a.s.). Me përhapjen e shpejtë të Islamit në mbarë botën, urrejtja e jobesimtarëve po shtohet dhe ata po tërbohën duke menduar se çfarë shëmtie të bëjnë për shkak të zemërimit të tyre.

Ndërsa ne tregojmë respekt të madh për të gjërat e shenjta të të gjitha feve, veçanërisht ndaj fesë së krishterë dhe hebraizmit, ata sulmojnë xhamitë tona, Profetin tonë dhe shaminë tonë, që është detyrë e fesë sonë, me pretekstin e lirisë së mendimit dhe të shprehjes. Zoti i Plotfuqishëm thotë në librin e Tij (Kuranin): «**Ne do t'ju sprovujmë me pak frikë, me pak uri dhe me pak humbje të pasurisë, jetëve dhe frutave, jepu përgëzim durimtarëve.**» (Bekare, 155) Duke u shprehur kështu na njofton se do të kemi vështirësi në këtë botë. Në këtë rast, ne si myslimanë, nuk duhet të bëjmë lëshime, sado që të biem në gjendje të vështira, sepse Allahu Teala do ta plotësojë dritën e Tij dhe do t'i ndihmojë myslimanët pavarësisht nga të gjitha llojet e kushteve negative. E rëndësishme është që sjellja jonë të jetë në një mënyrë që ta meritojmë ndihmën hyjnore, pra, ta mbrojmë Islamit

qoftë edhe me çmimin e jetës sonë ashtu siç bënë sahabët e nderuar, radijall-llahu anhum.

Myslimanët, veçanërisht Profeti (a.s.), ka kaluar nëpër sprova të vështira pothuajse në çdo periudhë të historisë. Ndryshe nga umetet e kaluara, sahabët e nderuar janë shembulli ynë më i mirë, sepse ata i kaluan me sukses sprovat e pamëshirshme. Imam Rabbani e përshkruan kështu guximin dhe heroizmin e tyre përballë mosbesimit:

“Edhe pse myslimanët ishin kaq të paktë dhe të dobët në vitet e para të Islamit, kjo situatë nuk i shërbeu asnjë qëllimi tjetër përveç se myslimanët vazhduan në fenë e tyre dhe jobesimtarët vazhduan në mosbesim. Kjo situatë nuk çoi në asnjë lëshim për myslimanët. Me gjithë fuqinë dhe mjetet e tyre, jobesimtarët nuk mundën të ndryshonin asgjë nga besimi i myslimanëve dhe ata kurrë nuk mundën t'i zbatonin rregullat e mosbesimit të tyre mbi ta. Në fakt, këtë të vërtetë e nxjerr në pah ajeti fisnik: «**Feja juaj është për ju, feja ime është për mua.**» (Kefirun, 6)” (Mektubat, vëll. I, 47.)

Ndërsa mesazhi universal i Zotit e ruan freskinë e tij në çdo kohë, ajetet dhe suret gjejnë adresues të rinj në çdo epokë. Ashtu si në epokën e lumturisë, ndërsa njerëzit si Ebu Xhehli dhe Ebu Lehebi e shkatërruan veten e tyre duke u përpjekur për të shuar dritën e Islamit, edhe në ditët e sotme disa mbetje të kryqëzatave që mendojnë se janë të fortë, kanë dalë vullnetarë të digjen në zjarrin e kësaj drite dhe të shkatërrohen. Arsyeja kryesore pse njerëzit e mosbesimit e sulmojnë Islamit dhe

Profetin (a.s.), është sepse myslimanët janë të përçarë politikisht. Në këtë rast, detyra jonë është t'i inkurajojmë dhe t'u japim guxim zyrtarëve tanë shtetërorë që të luftojnë kundër blasfemisë dhe t'i mbështesim sa më shumë që të kemi mundësi ata që e mbajnë mbi supe kauzën e Zotit (xh.xh.). Të jesh musliman nuk do të thotë të qëndrosh ulur në një qoshe pa u përfshirë në asgjë e duke i parë ngjarjet në mënyrë të paanshme, siç pandehet. Ne jemi palë në anën tonë aty ku bëhet fjalë për Profetin (a.s.), i cili u dërgua si mëshirë për botët. Një arsye tjetër për shtimin e shëmtive të mosbesimit është dëshpërimi i tyre kur shohin dritën e Islamit që po e shkatërron shpejt errësirën e mosbesimit. Ndërsa xhamitë po shfaqen në të gjithë botën përndimore, të pafetë e egër, të cilët po shpërthejnë nga mllefi, po sulmojnë Pejgamberin tonë të Nderuar dhe myslimanët. Në lidhje me këtë çështje, dëshiroj të ndaj me ju një kujtim timin. Ishim të ftuar në një xhami në Hamburg me hoxhën tonë të ndjerë, Hafiz Rexhep Katërxhëogllunë, i cili, pavarësisht syve të tij të verbër, përpiquej ta përhapte Islamit me zemrën e tij që rrezatonte dritë, kudo që mbizotëron mosbesimi. Ishte ditë e diel dhe ne arritëm herët në xhami. Kishte ende shumë kohë për namazin e drekës. Shumica e xhamive në Gjermani janë struktura të përbëra nga shtëpi dhe punishte. Edhe kjo ishte një xhami e tillë. Vëmendjen time ma tërhoqi një kishë madhështore me një kullë të lartë të kampanës pranë xhamisë. Shokut që kisha pranë i thashë:

«Le të shkojmë pak te ajo kishë dhe të shohim se si është gjendja e atyre që e frekuentojnë.» Sepse siç dihet, e diela është dita e tyre e shenjtë. Arritëm te kisha, shërbesa e së dielës sapo kishte mbaruar, por njerëzit nuk ishin shpërndarë ende.

Çuditërisht pamë se nuk kishte njeri tjetër veç 10-12 pleq e plaka, më i riu prej të cilëve ishte në moshën 65 vjeçare. Unë i thashë priftit se jam një klerik mysliman. Kështu desha të bisedoja me



priftin dhe të dëgjoja gjendjen e krishterimit nga goja e tij. Por ja që ai, në vend që të fliste për fenë e vet, menjëherë e solli bisedën te turqit në Evropë. «Edukimi fetar i turqve në Gjermani duhet të bëhet gjermanisht.», u shpreh ai dhe përfitimet e kësaj u përpoq të mi shpjegonte me insistim. Unë thashë me vete: «Lëri turqit të qetë dhe shqetësohu për problemet e tua, sepse ti ke mbledhur vetëm një grup prej rreth 10 vetash në një kishë kaq madhështore sikundër asaj që ndodh në namazin tonë të xhumasë.»

Pasi biseduam pak rreth kësaj çështjeje dhe u ktheva në xhami, e kuptova shumë mirë problemin e vërtetë të priftit. Sepse në xhaminë e vogël ngjitur me kishën e tyre gjigante, erdhën për të dëgjuar bisedën fetare një xhema prej gati 300 vetash, madje në një kohë kur kishin pushime! Oborri i xhamisë ishte i gjallë me xhematin e burrave dhe grave, pleqve e të rinjve, nga shtatë deri në shtatëdhjetë vjeç. Më preku shumë mbledhja e një xhemati të tillë në një qytet të largët nga ne në Gjermani, në Hamburg, që është ngjitur me Detin e Veriut dhe Danimarkën, dhe ky ishte problemi i priftit:

Që turqit të ftoheshin nga feja e tyre duke marrë arsim fetar në gjermanisht! Sepse, sipas mentalitetit të tij, nëse arsimit do të jepej në gjermanisht, mësuesit laikë dhe jofetarë do të hynin në mendjen e turqve dhe do t'i ftohnin nga feja e tyre. Shikojeni gjendjen në të cilën kishin rënë priftërinjtë e mëdhenj! Çfarë mendimi i pabazë! Islami, i cili nuk e kapërceu dot Vjenën në epokën më të lavdishme të osmanëve, në ditët e sotme e ka rrethuar të gjithë Evropën me xhami dhe qendra kulturore islame në Londër, Paris, Bruksel, Amsterdam, Oslo, Helsinki, Berlin. Edhe pse myslimanët duken të dobët në këtë periudhë, asnjë fuqi nuk do të mund ta shuajë këtë zjarr të ndezur nga Zoti (xh.xh.), përkundrazi, presionet do ta përshpejtojnë hyrjen në Islam.

Si rezultat, Zoti po e plotëson fenë e Tij dhe dielli i Islamit po e ngroh gjithë botën. Në një kohë kur kishat në Evropë janë bosh dhe njerëzit e dehur e të pastrehë shtrihen në cepat e dyerve të tyre madhështore, xhamitë tona atje janë të mbushura plot e përplot dhe xhemati vërshon rrugëve ditëve të premtë. Shumë komunitete të vogla, me besimin dhe urtësinë e tyre, po triumfojnë ndaj turmave të mëdha dhe Allahu po e plotëson dritën e Tij. Lum për ata që janë ushtarë të sinqertë në këtë rrugë!

Duhen myslimanë që të jenë në zjarr, por që nuk digjen



— Muhammed Jusuf —

Ndërsa rritja e interesit për Islamin ofron mundësi të rëndësishme për myslimanët, ajo gjithashtu kërkon edhe përballimin e sfidave. Me fjalë të tjera, të qenët mysliman në Evropë, siç shprehet shkrimtarit egjiptian Mustafa Sadik er-Rafii, kërkon që myslimani të ketë një pjekuri fetare aq sa «të gjendet në zjarr dhe të mos digjet», pikërisht si Hz. Ibrahim.

- Në këtë intervistë me ju, duam të flasim për islamofobinë, pra për frikën në rritje ndaj Islamit në perëndim, profesor. Le të fillojmë me mesin e librit nëse keni dëshirë. A ka frikë perëndimi nga Islami? Nëse ka frikë, pse ka frikë?

PROF. DR. ĒZKHAN HIDIR:

Në fakt, faza e frikës tashmë ka shumë që ka kaluar. Edhe pse në literaturë përdoret termi “islamofobi”, sot “fobia” është kthyer në kundërshtim dhe kundërshtimi është shndërruar në sulme kulturore raciste. Kjo ka arsye historike, fetare, politike, kulturore, demografike dhe ekonomike. Në këtë kontekst ka kuptim pyetja: “Në të vërtetë perëndimi është kundër Islamit apo kundër myslimanëve?”

Përgjigja ime është se perëndimi në të vërtetë ka frikë nga Islami, «që është feja e vetme e pranuar te Allahu», dhe se kjo ka një histori 1400 vjeçare që nga fillimi i Islamit. Që kur i Dërguari i Allahut (a.s.), u dërgua si «Profeti i fundit» dhe Islami filloi të përhapej me shpejtësi, filloi të kishte njerëz që shqetësoheshin, veçanërisht të mëdhenjtë e kishave që i përkisnin krishterimit. Këta bënë cilësime si “Islami është fe heretike e devijuar nga krishterimi», “ismailizëm-haxherizëm-heretizëm-barbari”. Këto diskurse dhe të tjera të ngjashme me to, u përsëritën me nuanca nga shkrimtarë-mendimtarë-orientalistë, të cilët formonin kodet mentale të perëndimit, si

një “trashëgimi e trashëguar brez pas brezi”, pastaj u shndërruan në projekte teo-politike. Në ditët e sotme, në shumicën e librave të botuar në gjuhët perëndimore në lidhje me Islamin, Kuranin dhe të Dërguarin e Allahut (a.s.), pohohet se “Origjina e Islamit bazohet në fetë dhe kulturat e mëparshme dhe se Hz. Pejgamberi e ka formuar Kuranin me informacionin që ka marrë nga kleri judeo-krishterë. Për këtë arsye, Islami dhe Profeti janë perceptuar si një «kërcënim».

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë (1990) dhe me ngjarjet e 11 shtatorit, në perëndim ka pasur një ndryshim të rëndësishëm paradigme në këto çështje dhe Islami-myslimanët janë shpallur si “armiku i ri” nga gojë të autoritare. Në këtë aspekt u vunë në praktikë projektet teo-politike, u shtua dhuna verbale ndaj myslimanëve dhe institucioneve të tyre dhe akoma vazhdon të rritet.

- Sot, myslimanët jetojnë pothuajse në çdo vend të botës. Veçanërisht myslimanët në perëndim përballen me probleme shumë të ndryshme. Çfarë do të thotë të jesh mysliman në Evropë? Në njërin anë përgjegjësia e përfaqësimit, në anën tjetër lufta me padrejtësitë...

ĒZKHAN HIDIR: Të qenët mysliman në Perëndim paraqet dy fusha kryesore sprove përballë nesh. Një-

ra është “sprova e Evropës me Islamin-myslimanët” dhe tjetra është “sprova e myslimanëve në Evropë”. Në të dyja sprovat ka probleme. Sidomos pas ngjarjeve të 11 shtatorit, Islami dhe myslimanët filluan të shiheshin si kërcënim dhe u bënë objekt i politikave asimiluese të orientuara drejt sigurisë. U zhvilluan detabe të tilla si “Liria te myslimanët”, “multi kulturalizmi”, “vendi i fesë-Islamit në sferën publike” dhe “përkushtimi ndaj vlerave normative europiane”. Si ndryshe nga hebrenjtë dhe të krishterët, në praktikë u futën politika raciste kulturore dhe standarde të dyfishta kundrejt myslimanëve. Kjo situatë është sprova e Evropës me Islamin dhe myslimanët.

Nga ana tjetër, myslimanët në perëndim kanë një sprovë. Përveç pikëpamjeve se nuk lejohet realisht të jetosh në Evropë, në ditët e sotme në Evropë jetojnë 25-30 milionë myslimanë. Kështu, sprova e myslimanëve del në pah se si këta të fundit mund ta ruajnë ekzistencën e tyre në këto shoqëri duke ruajtur identitetin e tyre dhe ndërkohë që e bëjnë këtë, si do ta kryejnë detyrën e «përfaqësimit të Islamit». Ky përfaqësim është i rëndësishëm për t’ua mundur brezave myslimane të jetojnë si «myslimanë», si dhe korrigjimin e imazhit negativ të njerëzve perëndimorë për Islamin, gjë e cila mund t’i çojë në konvertimin në Islam, me lejen e Allahut. Pavarësisht gjithë propagandës negative, interesi për Islamin po rritet në perëndim. Për shembull, një nga arsytet e projektit «Islami i Francës» i Makronit dhe iluzionet e tij të fundit është se numri i myslimanëve në vend, jo zyrtarisht, është më shumë se 10 milionë dhe mesatarisht 20 mijë njerëz bëhen myslimanë çdo vit.

Ndërsa këto ofrojnë mundësi të rëndësishme për myslimanët, ato gjithashtu kërkojnë përballimin e sfidave. Me fjalë të tjera, të qenët mysliman në Evropë është, siç shprehet shkrimtari egjiptian Mustafa Sadik er-Rafii, kërkon që myslimani të ketë një pjekuri fetare aq sa «të gjendet në zjarr dhe të mos digjet», pikërisht si Hz. Ibrahim. Në këtë mënyrë, në muajt e parë të pandemisë, “përhapja e sinofobisë (frika nga Kina) dhe shfaqja e xhamive dhe institucioneve të tjera islame në shumë vende të perëndimit me ndihmë dhe higjieno-pastërti në traditën profetike (Artikulli i Newsweek), kontribuuan pozitivisht në imazhin e myslimanit. Në këtë periudhë ka edhe konstatime se interesimi për fenë-spiritualizmin në përgjithësi dhe Islamin në veçanti është rritur. Thuhet se edhe te ateisto-gnostikët ka një normë kërkimi prej 22% gjatë kësaj periudhe. Ndoshta kjo është vënë re, ngaqë me armiqtësinë që



është përshkallëzuar sërish që prej gushtit, kjo pikëpamje pozitive tentohet të bllokohet deri diku.

- Pas deklaratave të fundit të Makronit flitet për “Islamin e Evropës-Islamin e Francës”. Cili është qëllimi në këtë? A është Islami një fe që kuptohet ndryshe në rajone të ndryshme të botës?

ËZHXHAN HIDIR: “Ligji i separatizmit” që Makroni do të paraqesë në parlament më 9 dhjetor, mund të thuhet se është zbatimi pilot i meta-projektit “Islami Evropian” në Francë, i cili lidhet me projektet “neo-orientaliste”. Në vendet e Evropës perëndimore, projekte të tilla vazhdojnë në një mënyrë ose në një tjetër. Madje ka raportime se janë zhvendosur në BE. Nga ana tjetër, Makroni së fundmi e ka bërë si mision të tij krijimin e “Islamit të Francës” me motive të brendshme dhe të jashtme. Motivi më i rëndësishëm këtu, siç theksuam më sipër, është kodimi i Islamit si «armiku i ri» në perëndim pas 11 shtatorit. «11 Shtatori» i Francës ishte sulmi i Charlie Hebdo në 2015 dhe projektet mbi myslimanët në Francë u përshpejtuan pas kësaj date dhe «ligji i seperatizmit» është një hap i rëndësishëm në këtë çështje.

Epo, meqë Islami nuk është një fe që ndryshon në pjesë të ndryshme të botës, me çfarë qëndrimi do ta vazhdojnë jetën myslimanët në këtë çështje? Këtë pyetje mund ta parashetrojmë edhe kështu: “Myslimanë evropianë” apo “Myslimanë në Evropë”?

Dallimi midis këtyre dy situatave është i dukshëm. «Islami-myslimanët në Evropë» do të thotë se myslimanët kontribuojnë në shoqërinë në të cilën jetojnë me integrim (pjesëmarrje) të shëndoshë duke ruajtur fenë-identitetin e tyre si «vetvetja». Përçarjet e tyre reaktionale (pasiviteti) dhe etniko-sektare etj., pra për shumë arsye, nuk mund të thuhet se myslimanët e bëjnë këtë mjaftueshëm. Me këtë rast, duhet theksuar se aspekti fetar-juridik i çështjes po diskutohet nën titujt si «fikhu’l-ekalijjat» (fikhu/jurisprudenca islame e pakicave), «fikhu’z-zarurat»



(fikhu i nevojave) dhe «maslahat-mekasid» (dobitë, nevojat etj. në përputhje me dispozitat sheriatike-qëllimet).

Nga ana tjetër, “Islami evropian” shpreh kuptimin që bazohet në normat-vlerat evropiane, që është i pastruar nga pamja dhe pretendimet shoqërore si myslimanë sa më shumë që të jetë e mundur dhe që e kufizon zbatimin e Islamit në zona private. Ky është në fakt një botëkuptim mysliman i sekularizuar. Ashtu si në debatet për «fetaritetin pa fe» në Evropë, dëshirohet një tipologji myslimane me një botëkuptim «Zoti deist-pasiv» që nuk ndërhyr në jetë.

- **A nuk mbahen diskutime të ngjashme për hebrenjtë dhe të krishterët?**

ËZKHAN HIDIR: Të gjitha këto diskutime rreth islamit-myslimanëve, në fakt pritej të bëheshin bashkë me hebrenjtë dhe të krishterët. Megjithatë, nuk ndodhi kështu. Projektet-diskutimet për Islamin-myslimanët diskutohen përgjithësisht në kontekstin e «sigurisë-integritit» dhe «asimilimit kulturor». Në këtë kontekst, duhet të kujtojmë qëndrimet me standarde të dyfishta të tyre për “synetllikun”, “therjen hallall të kafshëve”, «mbajtjes së shamisë në shkolla» dhe «ndalesave të minareve dhe ezanit». “Therja hallall e kafshëve” dhe “synetlliku i meshkujve” janë në thelb diskutime (argumente) teologjike për çifutët dhe muslimanët, ndërkohë përjashtime bëhen vetëm për hebrenjtë. Për myslimanët, këto diskutime kryhet në bazë të «të drejtave të njeriut dhe integritit».

- **Ndërsa ka mijëra mirësi të myslimanëve, pse grupe të caktuara në perëndim duan t'i vënë terrorizmin dhe Islamin krah për krah?**

ËZKHAN HIDIR: Siç e thamë edhe më sipër, ka shumë arsye për këtë. Megjithatë, njëra nga arsyet kryesore është se edhe pse qytetërimi islam nuk është «aktualisht» kundër perëndimit, «faktikisht» është i vetmi qytetërim-fe që ekziston dhe për këtë arsye ai perceptohet si një kërcënim. Sipas tyre, mënyra më efektive është kriminalizimi i Islamit-myslimanëve me terrorizëm.

Natyrisht, këtu nuk duhet të jemi kategorikisht kundër perëndimit. Sepse, duhet theksuar se “Perëndimi” i referohet vendimmarrësve që drejtojnë agjendat-projeksionet ideologjike anti-islame. Sepse, dihet që ka njerëz me arsye të shëndoshë në perëndim që nuk i miratojnë këto akte kulturore raciste kundër Islamit dhe myslimanëve.

- **Kohët e fundit janë botuar karikatura të neveritshme për Profetin (a.s.). Në të njëjtën mënyrë, është e mundur të shikosh karikatura të ngjashme për Hz. Isanë (Jezusin). A mund të themi se ka një sulm sistematik ndaj të gjitha vlerave të Islamit nën emrin e lirisë së shprehjes?**

ËZKHAN HIDIR: Në fakt, ka pasur sulme të tilla ndaj gjërave të shenjta, veçanërisht në Evropë. Kurse në aspektin Islam, kjo kryesisht kryhet përmes Profetit dhe Kuranit. Sepse shkalla e largimit nga feja-kisha në forma të ndryshme (deizëm-ateizëm-gnosticizëm-nihilizëm-apateizëm) është e lartë në Evropë. Për këtë arsye, ka diskutime për “fetarizmin pa fe” me botime ku thuhet se “jofetaria është kulti i ri i botës”. Madje, disa priftërinj shkruajnë libra me titull «Besimi në një Zot që nuk ekziston». Në disa vende, ofendimi i «Zotit dhe gjërave të shenjta» është nxjerrë nga të qenët krim. Për këtë arsye, shpesh herë publikohen edhe karikatura për Isanë (a.s.). Megjithatë, veçanërisht në sulmet kundër

Judaizmit-Krishterimit, hyjnë në lojë institucionet e tyre të fuqishme. Në anën tjetër, myslimanëve u mungojnë institucionet e forta. Për më tepër, të ashtuquajturat vlera evropiane si «liria e mendimit dhe shprehjes» përdoren në mënyrë të papërgjegjshme si një standard i dyfishtë për Islamin dhe myslimanët në emër të «lirisë nga feja».

- **Çfarë paralelizmi tregon ngritja e ksenofobisë në perëndim krahas kundërshtimit ndaj Hz. Pejgamberit? Çfarë fton kjo në të ardhmen?**

“Ksenofobia” është në fakt një koncept i lartë i armiqësisë ndaj Islamit.

Megjithë prejardhjet etnogeografike midis të huajve në perëndim janë të ndryshme, ka edhe fetarë të tjerë si të krishterët. Atje ka armiqësi edhe ndaj të huajve humanistë, por ngaqë ata u përmbahen normave dhe vlerave perëndimore, armiqësia ndaj tyre është relativisht e ulët.

Prandaj, edhe pse sot ka retorika-veprime ksenofobike, ajo është kthyer në armiqësi ndaj Islamit dhe myslimanëve. Madje, pas iluzioneve të fundit të Makronit, disa klerikë dhe studiues kanë deklaruar se «myslimanët në perëndim po shtyhen në pozicionin e hebrenjve në epokën e Hitlerit». Abraham Soetendorp, lideri i hebrenjve liberalë holandezë dhe Job Cohen, ish-kryetari i Partisë së Punës holandeze, e kanë shprehur këtë vitet e fundit. Akademikja amerikane Anne Norton shkroi në librin e saj me titull «Rreth Problemit të Myslimanëve / On the Muslim Question» të vitit 2012 mbi çështjen myslimane se, “problemi hebre është zëvendësuar nga problemi mysliman në ditët e sotme”. Kështu është edhe kërkesa që Kurani të ndalohej e Wildersit që i përket ekstremit të djathtë holandez, i cili kohët e fundit ka dalë në pah me deklaratat e tij anti-islame dhe kundër Turqisë, duke e krahasuar Kurandin me Mein Kampf-in e Hitlerit. Thuhet se para epokës së Hitlerit, libri i shenjtë hebre u dogj dhe hebrenjtë tregoheshin si «armiku-tjetri», si shkaktar i negativiteve në shoqëri.

- **Ndërsa e gjithë kjo po përjetohet, çfarë duhet të bëjnë myslimanët që jetojnë në Evropë për ato që po ndodhin? A është e mundur të jetosh sipas Islamit në Evropë?**

ËZHXHAN HIDIR: Sigurisht, kjo është ndoshta pyetja dhe problemi më i rëndësishëm. Edhe pse në përgjithësi ka një situatë negative në lidhje me të ardhmen e islamit dhe myslimanëve në perëndim,

duhet ta dimë se kjo u ofron edhe mundësi myslimanëve. Sepse dihet që konvertimet janë shtuar pas 11 shtatorit. Prandaj, përballë këtyre negativiteve, është thelbësore që myslimanët të thonë «përsëri Islami» dhe të përgjigjen me një «përfaqësim të mirë islam», larg të qenët reaksionar. Kjo duhet të jetë në dy drejtime:

Së pari, duke u identifikuar saktë shkaku dhe qëllimi i sulmeve ndaj Hz. Pejgamberit, Kuranit dhe Islami në tërësi, duhet të jepen përgjigje me një qëndrim “që i ka hije Profetit”. Edhe nëse mosmarrja në konsideratë e kundërshtarëve të Islamit dhe dënimi i tyre me privim është një përgjigje, ajo mund të çojë në vendosjen e koncepteve të gabuara në mendjet e myslimanëve dhe në mendjet e njerëzimit, që është «umeti davet». Është detyrë e umetit që ta largojë këtë në një mënyrë që i përshtatet Profetit (a.s.). Sepse, kur shqyrtohen transmetimet e shumë të konvertuarve, shihet se në fillim ata kanë hezituar për shkak të opinionit të gabuar në mendjen e tyre për Hz. Pejgamberin, por kur lexuan për të, u bënë myslimanë.

Së dyti, pa këto armiqësi, këto janë hapa aksionarë që dijetarët, mendimtarët, akademikët dhe shkrimtarët e umetit mund t’ia paraqesin Islamin, Kurandin dhe Profetin gjithë njerëzimit me një metodë të përshtatshme. Ne e dimë nga Suneti i tij se Hz. Profeti nuk deklaroi armiqësi kategorike, nuk iu përgjigj urrejtjes me urrejtje dhe armiqësisë me armiqësi, por siç thuhet në Kuran, ai iu përgjigj të keqes me të mirë, gjë që ishte jashtëzakonisht efektive në konvertimin e shumë njerëzve në Islam. Me fjalë të tjera, siç është shprehur Arif Nihat Asja, “njerëzit si Ebu Lehebi nuk kanë vdekur, edhe njerëzit si Ebu Xhahili po udhëtojnë nëpër kontinente”. Ajo që i takon umetit për të bërë është përpjekja (lufta) sipas Hz. Pejgamberit dhe Hz. Ebu Bekrit me njerëzit si Ebu Lehebi dhe Ebu Xhehli.

Për këtë nevojiten udhëheqës fetaro-intelektualë (oksidentalistë) që e njohin mirë Islamin dhe do ta shfaqin atë në perëndim pa bërë lëshime nga thelbi i tij. Veç kësaj, shumë të rëndësishme janë edhe kontributet e tyre aktive në problemet e vendit ku jetojnë, me vlerat e tyre, në vendet perëndimore duke e konsideruar veten jo si “nomadë emigrantë”, por si muhaxhirë që kanë si synim përcjelljen e bukurive të Islamit te zemrat e etura pa u asimiluar dhe pa e prishur fenë, kulturën dhe lidhjet me vendin e origjinës.

Çfarë është Drita e Allahut?



— Dr. A. Hamdi Jëlldërëm —

Shprehja se Allahu do ta plotësojë dritën e Tij përmendet në dy vende në Kuranin Fisnik. Allahu do ta plotësojë dritën e Tij. Qafirët që e kundërshtojnë këtë, do të përpiqen ta shuajnë atë dritë. Mjeti që jobesimtarët përdorin për të shuar dritën e Allahut është goja e tyre. Ata përpiqen ta shuajnë dritën e Allahut me fryrjen që nxjerrin nga goja e tyre.

“Ata duan ta shuajnë dritën e Allahut me gojët e tyre. Mirëpo, edhe nëse jobesimtarët nuk e pëlqejnë këtë, Allahu nuk është i kënaqur me asgjë tjetër përveçse me plotësimin e dritës së Tij.” (Teube, 32).

“Ata duan ta shuajnë dritën e Allahut me gojët e tyre. Megjithatë, Allahu do ta plotësojë dritën e Tij edhe nëse jobesimtarët nuk e dëshirojnë atë.” (Surja Saff, ajeti 8.)

Shprehja se Allahu do ta plotësojë dritën e Tij përmendet në dy vende në Kuranin Fisnik. Allahu do ta plotësojë dritën e Tij. Kurse jobesimtarët që e kundërshtojnë këtë, do të përpiqen ta shuajnë atë dritë. Mjeti që jobesimtarët përdorin për ta shuar

dritën e Allahut është goja e tyre. Ata përpiqen ta shuajnë dritën e Allahut me frymën që nxjerrin nga goja e tyre.

Nga njëra anë, drita e Allahut; nga ana tjetër, gojët e jobesimtarëve... Nga njëra anë, vullneti i Allahut për të plotësuar dritën e Tij; nga ana tjetër, fakti që jobesimtarët nuk e pëlqejnë këtë... Ngado që të shikohet, është shumë e qartë se sa i paqëndrueshëm është ky ekuacion.

Çfarë është drita e Allahut që jobesimtarët përpiqen ta shuajnë?

Imam Kurtubiu thotë në interpretimin e ajetit të 8-të të kaptinës Saff se qëllimi i dritës së Allahut mund të jetë një nga pesë gjërat e mëposhtme:

- 1) Drita e Allahut është Kurani Fisnik. Ata duan ta injorojnë dhe mohojnë Kuranin me fjalët e tyre.
- 2) Drita e Allahut është Islami. Ata duan ta eliminojnë Islamin me fjalët e tyre.
- 3) Drita e Allahut është Muhamed Mustafai, (a.s.), Pejgamberi ynë i Nderuar. Ata dëshirojnë shkatë-

rrimin e Profetit (a.s.), përmes lajmeve të rreme që shkaktajnë grindje dhe trazira.

4) Drita e Allahut janë argumentet e Allahut (xh. xh.). Me mohimin dhe përgënjeshtimin e tyre ata duan t'i shkatërrojnë argumentet e Allahut Teala.

5) Qëllimi nga Drita e Allahut është dhënia e she-mbullit. Me fjalë të tjera, nëse puna e një personi që përpiket të shuajë dritën e diellit me gojën e tij është të sforcojë të pamundurën, edhe të përpiqesh të shpërfillësh të drejtën është e njëjtë.

Përsëri, sipas asaj që transmeton Imam Kurtubiu, Ibn Abbasi (r. anhumu), thotë sa vijon për arsyen e zbritjes së këtij ajeti:

«Kur Profetit (a.s.), nuk i erdhi shpallje për dyzet ditë, Ka'b ibn Eshrefi tha: "O çifutë! Gëzohuni, sepse Allahu e fiku dritën që ia zbriti Muhamedit. Ai nuk do ta përfundojë punën e tij." Edhe Pejgamberi (a.s.), ishte shumë i mërziur për këtë ngjarje. Më pas, Zoti i Madhëruar e shpalli këtë ajet dhe pas tij shpallja vazhdoi pa ndërprerje."

Drita e Allahut përfshin fenë islame në tërësi. Kjo armiqësi kundër dritës së Allahut fillon me mohimin e profecisë së të Dërguarit të Allahut dhe shkon deri në fajësimin e personalitetit të tij të bekuar. Mohimi i revelatës që i është shpallur atij dhe mohimi i Kuranit janë një pjesë e kësaj. Ndërsa politeistët mekas, hebrenjtë dhe hipokritët përpiqeshin ta shuanin dritën e Allahut dje, edhe në ditët e sotme ndjekësit e tyre shfaqin të njëjtën paturpësi.

Në fakt, fillimi i ajetit në formën e kohës së tashme tregon se fatkeqët e tillë do të vazhdojnë të ekzistojnë deri në ditën e kiametit. Sepse, është e njohur për dijetarët se forma e së tashmes nënkupton ndodhjen dhe ripërtëritjen në kohën e tashme dhe të ardhshme të ngjarjeve. Me fjalë të tjera, gjithmonë do të ketë njerëz të tillë me mangësi. Jobesimtari nuk do të tërhiqet nga mosbesimi i tij dhe do të përpiket ta shuajë dritën e Allahut për aq kohë sa të ketë fuqi për të fryrë. Mirëpo, përderisa shihet në ajetin e kaptinës Teube se jobesimtarët përpiqen ta shuajnë dritën e Allahut haptazi dhe në mënyrë ashiqare, në suren Saff kuptohet gjithashtu se ata përpiqen ta bëjnë këtë fshehurazi.

Përpjekjet e jobesimtarëve për të shuar dritën e Allahut janë të drejtuara kryesisht ndaj përfaqësuesve të Profetit, alejhi's-selam, që përfaqësojnë atë dritë. Ata sulmojnë komunitetet dhe dijetarët e Ehli Sunetit që ndjekin rrugën e Profetit dhe shokëve të tij. Ata i shpallin terroristë komunitetet myslimane që përfaqësojnë Siratu'l-Mustakimin (Rrugën e Drejtë) dhe përpiqen t'i diskreditojnë. Ata sulmojnë

burimet kryesore të Islamit. Flasin keq për Buhariun dhe Muslimin. Dhe për fat të keq, kur e bëjnë këtë, përdorin fëmijët e myslimanëve që i rekrutojnë nga vendet myslimane.

Sa mjet i dobët dhe i pafuqishëm është goja e jobesimtarit kundrejt dritës së Allahut! Ata mendojnë se mund ta shuajnë dritën e Allahut. Megjithatë, Allahu është plotësues i dritës së Tij.

Qëllimi nga kjo shprehje që përmendet në të dyja ajetet nuk është vetëm ndriçimi i përjetshëm i dritës së Tij. Përtej kësaj, Zoti thotë se drita e madhështisë së Tij do të plotësohet, do të lartësohet, do të arrijë në çdo pikë të globit dhe do të mbizotërojë mbi të gjitha fetë. Kjo fe do të arrijë kudo që të arrijnë dita dhe nata. Qoftë me tulla balte apo pëlhura prej leshit të deveve, nuk do të mbetet shtëpi ku Allahu të mos e fusë këtë dritë. Me besimin që buron nga kjo e vërtetë, Hz. Pejgamberi betohet në besimin e tij të fortë se drita hyjnore do të plotësohet pavarësisht kushteve të vështira në të cilat ndodhej dhe dobësisë së dukshme, duke thënë:

"Betohem në Allahun se Allahu do ta plotësojë këtë punë (Islamin)." (Buhari, Menakib, 25.)

Habbab Ibnu'l-Ereti, radijall-llahu anh, transmeton: «Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte ulur duke u mbështetur tek një pelerinë, shkuam tek ai dhe u ankuam duke i thënë:

«A nuk do të na ndihmosh, a nuk do të lutesh për ne?»

Nisur nga këto, ai na tha:

"Kishte njerëz para jush që kapej, vendosej në gropën e përgatitur për të dhe më pas i ndahej kokë më dysh me sharrë. Kishte disa që gërvishteshin me krehër hekuri, duke u lënë në trup vetëm mishin e kockat. Këto veprime nuk mund t'i largonin ata nga feja e tyre. Betohem në Allahun se, Allahu do ta plotësojë këtë fe! Aq sa kur një udhëtar të hipë në devenë e tij, do të niset nga Sanaja dhe do të shkojë deri në Hadrameut, nuk do të ketë frikë prej asgjëje tjetër përveç Allahut dhe për delen e tij do të ketë frikë vetëm prej ujkut. Por ju po nxitoni." (Buhari, Menakibu'l-Ensar 29, Menakib 25, Ikrah 1; Ebu Davud, Xhihad 107; Nesai, Zinet 98.)

Islami do të arrijë në çdo vend të tokës dhe do të dominojë kudo. Detyra jonë në këtë proces është të punojmë për fitoren e Islamit. Fitorja do të arrihet absolutisht me konfirmimin hyjnor. Nuk ka asnjë dyshim për këtë. E gjithë çështja është se cila është pjesa jonë në këtë fitore? Tashmë është detyra jonë të punojmë, të lutemi dhe ta ndajmë këtë ideal.

TË MOS I JAPIM MUNDËSI PADREJTËSISË DHE TË PADREJTIT



— Ali Riza Temel —

Kur izraelitët ranë në mëkat, dijetarët ndërhyjnë të parët. Mirëpo, kur nuk mundën të ishin efektivë, edhe ata vetë gradualisht e humbën reagimin e tyre ndaj së keqes dhe filluan t'i pranoin mëkatet si normale, madje edhe të ulëshin me mëkatarët dhe të bëheshin partnerë në mëkat. Si rezultat, morën një mallkim gjithëpërfshirës.

Zjarri fillon me një shkëndijë, nëse nuk shuhet që në fillim, atëherë ajo përhapet, bëhet e pandalshme dhe çdo vend digjet e bëhet shkruamb e hi. Edhe të këqijat fillojnë si shkëndija. Nëse nuk shmangen dhe nuk parandalohen, përhapen gradualisht dhe i shkatërrojnë të gjitha vlerat morale dhe njerëzore të shoqërisë. Si rezultat, të këqijat zëvendësojnë të mirat dhe të këqijtë zëvendësojnë të mirët. Në këtë mënyrë shoqërisë nuk i mbetet mundësi të jetojë.

Në mënyrë që shoqëria të mbetet e shëndetshme si materialisht ashtu edhe shpirtërisht, çdo individ ka detyra dhe përgjegjësi. Të gjithë duhet ta ndjejnë veten si një ushtar që qëndron roje në kufi për të parandaluar depërtimin e armikut. Nëse kjo ndjeshmëri nuk vërehet, vendi dhe shoqëria bien në një gjendje të pambrojtur. Nëse trupi nuk shfaq rezistencë kundër mikrobeve, sëmuret dhe kur masat mbrojtëse janë të pamjaftueshme, vdekja është e pashmangshme.

Ka shumë paralajmërime hyjnore për ndjeshmëri sociale kundrejt të këqijave dhe të këqijve. **“Kini kujdes ndaj fitnes, sepse ajo përhapet jo vetëm te zullumqarët mes jush, por te të gjithë.”** (Enfal, 25) **“A do të na shkatërrosh për shkak të mëkateve të bëra nga disa njerëz budallenj prej nesh?”** (A'raf, 155) Në njëfarë mënyre, për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë:

“Allahu nuk i dënon njerëzit për mëkatet e disa njerëzve. Megjithatë, nëse shumica që e ka fuqinë

për ta parandaluar gabimin e pakicës, nuk e pengon atë, atëherë Allahu e lejon shkatërrimin e shumicës.” (Ahmet ibn Hanbel, Musned, 4/192.)

Nëse të këqijat tolerohen dhe nuk ngrihet zëri kundër padrejtësisë dhe të padrejtëve, atëherë ndjenja për të mbrojtur të drejtën dhe të drejtët dobësohet gradualisht, gjërat që janë jonormale fillojnë të shihen si normale dhe kështu humbet ndjeshmëria sociale. Ndërsa u hapet rruga të këqijave, fillon prishja dhe përfundimisht ndodh kolapsi total. I Dërguari i Allahut (a.s.), e tërheq vëmendjen ndaj këtij rreziku siç vijon. **«Beto hem në Allahun se, ose do të urdhëroni për të mirë dhe do të ndaloni nga e keqja, do ta kapni zullumqarin për dore dhe do ta ndaloni nga padrejtësia, do ta ktheni te e vërteta dhe do ta mbani në të, ose Allahu Teala do t'i bëjë zemrat t'i ngajnë njëra-tjetrës dhe pastaj do t'ju mallkojë ashtu siç i mallkoi Beni Israilët.»** (Ebu Davud, Melahim, 17.)

Kur izraelitët ranë në mëkat, dijetarët ndërhyjnë në fillim. Mirëpo, kur nuk patën efektivitet, ata gradualisht e humbën reagimin e tyre ndaj të këqijave dhe filluan t'i pranoin mëkatet si normale, madje edhe të qëndronin me mëkatarët dhe të bëheshin partnerë në mëkat. Si rrjedhojë, ata morën një mallkim të përgjithshëm.

Nëse padrejtësitë dhe të padrejtët nuk parandalohen kur ekziston mundësia për t'i parandaluar, me kalimin e kohës padrejtësia dhe të padrejtët dominojnë në shoqëri. Kur zjarri ta rrethojë oxhakun, atëherë është vonë, kështu që nuk ka dobi vajtimi dhe klithma. Hz. Pejgamberi (a.s.), e vë në dukje kështu këtë të vërtetë:

“Beto hem në Allahun, me fuqinë e të Cilit jetoj, ose do të urdhëroni për punë të mira dhe të ndaloni nga punët e këqija, ose së shpejti Allahu do t'ju dërgojë dënim nga ana e Tij. Pastaj do t'i luteni dhe përgjë-

roheni Allahut, por lutja juaj nuk do të pranohet.” (Tirmidhiu, Fiten 9.)

Detyra e myslimanit është të mbrojë të drejtën dhe të rezistojë kundrejt të pavërtetës. Ky është një xhihad. Siç ka thënë i Dërguari i Allahut (a.s.): «*Xhihadi më i virtytshëm është të thuash të vërtetën kundër një udhëheqësi të padrejtë.*» (Nesai, Bejat 37.)

Myslimani është njeri me dinjitet. Ai është i dhënë pas nderit dhe namusit të tij.

Ai nuk përkulet para padrejtësisë dhe të padrejtë, ai qëndron gjithmonë drejt. Vetëm përulet në ruku dhe sexhde në audiencën e Allahut (xh.xh.). Hz. Pejgamberi (a.s.), e tregon këtë çështje siç vijon: “*Askush prej jush nuk duhet ta nënçmojë veten.*» I thanë: «O i Dërguari i Allahut, si e nënçmojmë ne veten?» I Dërguari i Allahut (a.s.), u përgjigj: «*Nëse njeriu hesht kur duhet të flasë për të mbrojtur urdhrat e Allahut, Allahu i Madhëruar do ta pyesë atë në Ditën e Gjykimit: «Çfarë të pengoi të flasësh për këtë e për atë çështje?» Ai njeri do të përgjigjet: “Kisha frikë nga njerëzit.” Allahu do t’i thotë: «A nuk jam Unë më i denjë për t’u pasur frikë.» (Ibn Maxheh, hadithi nr: 4008.)*

Pejgamberi (a.s.), e ka ngjasuar shoqërinë me një anije dhe individët me pasagjerët e saj. Nëse anija lejohet të shpohet, ajo fundoset dhe të gjithë mbyten. Andaj shprehjet dhe qëndrimet në formën: “Çdo dele varet nga këmba e vet.», “Gjarpri që s’më prekë mua, jetoftë një mijë vite.», “Mos i jep shumë rëndësi.», janë krejtësisht të gabuara dhe të rrezikshme.

Një dele e varur nga këmba e vet, i vjen erë e keqe dhe kështu i shqetëson të gjithë. Gjarpri i kafshon të gjithë kur i jepet rasti. Nëse nuk i jep rëndësi, një ditë do të jetë radha jote.

Të rezistosh kundrejt zullumqarit është nder, kurse t’i nënshtrohesh dhe ta mbështesësh zullumqarin është poshtërsi. “*Mos anoni nga zullumqarët, përndryshe zjarri do t’ju prekë edhe ju.*» (Hud, 113)

I Dërguari i Allahut (a.s.), e ka shprehur këtë të vërtetë siç vijon: “*Atij që e ndihmon një zullumqar, Allahu do t’ia bëjë atij bela mbi kokë atë zullumqar.*” (Axhluni, Keshfu’l-Hafa, nr: 2380.)

Ata që nuk bëjnë rezistencë kundër zullumqarëve dhe që i mbështesin zullumqarët për interesat e tyre

personale, i djegin dhe i shkatërrojnë edhe veten, edhe shoqërinë e tyre.

Historia është dëshmitar i gjallë i kësaj. Ka vende dhe shoqëri që tashmë po vuajnë nga ky problem.

Në fakt, zullumqarët nuk kanë pushtet të vetëm. Në fund të fundit, edhe ata janë individë të vdekshëm dhe të pafuqishëm si gjithë të tjerët. Ata që i bëjnë të fortë zullumqarët janë ata që i mbështesin për përfitime materiale dhe për shkak të injorancës. Fuqia e zotërinjve është falë skllëvërve. Zullumqarët nuk mund të qëndrojnë as për një moment pa mbështetje. Kjo është fuqia e Faraonit dhe e Nemrudit.

Gjithmonë është e mundur që zullumqarët të ndalohen dhe t’u tregohen kufijtë e tyre. Edhe nëse nuk bëhet asgjë, të shfaqësh rezistencë pasive, të mos i duartrokasësh, të mos u buzëqeshësh dhe të mos i shikosh në fytyrë, madje t’u kthesh kurrizin, i bën ata të shkatërrohen. Sepse nuk është krim të mos duartrokasësh, të mos buzëqeshësh dhe të kthesh kurrizin. Mosdhënia e votës në kutinë e votimit është një qëndrim i lehtë dhe pa rrezik.

Ndërkohë që ka mënyra kaq të lehta dhe pa rrezik lufte, përdorimi i drejtpërdrejtë i dhunës dhe fillimi i një kryengritjeje pa marrë masa konsekuente, shpesh është në dobi të zullumqarëve, gjë që shkakton shtypjen totale të të pafajshmëve.

Meqenëse padrejtësia, e cila është e kundërta e drejtësisë, është koka e të gjitha të këqijave, gjëja e parë që duhet kundërshtuar dhe të shfaqet rezistencë ndaj saj është padrejtësia dhe të padrejtët që e përvetësojnë atë. “*Luftoni me ata derisa të shkatërrohet fitneja dhe adhurimi të jetë vetëm për Allahun. Nëse heqin dorë, nuk ka armiqësi përveçse ndaj zullumqarëve.*” (Bekare, 193) Kjo do të thotë se burimi i të gjitha armiqësive është padrejtësia, shkatarrët e së cilës janë të padrejtët. Shkatërrimi i armiqësisë mund të realizohet ose duke e shkatërruar armikun, ose duke i treguar cakun atij. Fakti që armiqësia kufizohet vetëm ndaj zullumqarëve në ajet tregon se arsyeja që e legjitimon xhihadin është ndalimi i padrejtësisë dhe të të padrejtëve. Luftërat që çojnë në mizori të reja janë gjithashtu padrejtësi. “*Vërtet, Allahu nuk i do zullumqarët.*” (Shura, 40) “*Zullumqarët nuk mund ta arrijnë kurrë shpëtimin.*» (En’am, 21)



A është Islami në krizë?

— Hashim Akin —

Nëse ende nuk e kuptojmë se, “nëse mbreti është vërtet lakuriq”, nuk ka nevojë të presim të tjerë apo fatkeqësi të mëdha për ta shprehur këtë gjendje të tij, kur dhe me çfarë ngjarje do ta realizojmë këtë? Ne si vend kemi paguar një çmim të rëndë për faktin që nuk iu përgjigjëm dot në kohën e duhur diskurseve të shtrembëruara fetare.

Presidenti i Francës ditët e fundit ka mbajtur një fjalim që e kalon cakun. Ai tha se feja islame është në krizë. Me shumë mundësi, frika e Islamit të cilën ai e përjeton brenda tij, po e shqetëson seriozisht. Ai po kërkon një zgjidhje që do t'i japë siguri. Sigurisht, kjo nuk do të jetë e lehtë për të...


Këto thënie duhet të kenë diçka që na intereson neve... E gjithë jeta, individët dhe mënyrat e jetesës jashtë fesë islame e shohin fenë islame si një kërcënim për të ardhmen e tyre. Dëshirat e tyre për ta përshtatur me qëllimet e veta Islamit, të cilin nuk mund ta shkatërrojnë, nuk duhet t'i shohim si të mëdha.

Feja Islame nuk përjeton krizë. Megjithatë, botë-

kuptimi i myslimanëve për Islamit dhe mënyra e tyre e jetesës ndonjëherë mund të shkaktojnë kriza. Në fakt, është thelbësore që ky problem të korrigjohet me dinamikë të brendshme pa asnjë ndërhyrje të jashtme dhe të bëhet sa i jetueshëm aq edhe i zbatueshëm.

Sot, në vend që të kuptojë Islamit dhe frymën e burimeve të tij kryesore, tradicionalizmi, i cili i bashkëngjitet vetëm kuptimit më të thjeshtë të fjalisë, lufton me kuptimin derivator që përpiqet t'i dënojë këto fjali në të kaluarën brenda kuptimit të historicizmit dhe të plotësojë hendekun me diskurset moderne.

Kur shikohen seriozisht, të dy këto pole të kundër-



ta marrin ujë nga i njëjti burim dhe e çojnë ujin në të njëjtin mulli. Qasja tradicionaliste që nuk e kupton/ nuk mund ta kuptojë në formën “të kënaqesh me atë që ke në posedim dhe të jetosh me modesti” hadithin fisnik: “Çfarë ushqimi i mrekullueshëm që është uthulla”, i atribuon uthullës shenjteri, tjetri e hedh fjalën diku tjetër duke u shprehur: «A hahet uthull për tri vaktet në shtëpinë tuaj?»

Turma e mashtruar që i percepton vargjet e xhi-hadit si prerje koke para kamerës dhe shpreson se me të do të fitojnë parajsën dhe polet që kënaqen me sjelljen e tyre pa treguar asnjë reagim apo lëvizje dhe e përshkruajnë këtë si kader hyjnor, të gjithë dalin nga e njëjta fushë. Nuk ka njeri që të mos ketë dëgjuar për hadithin rreth ndalimit të veshjeve të gjata, të cilat shiheshin si shenjë krenarie dhe mendjemadhësie në kushtet e asaj periudhe. Ky hadith kuptohet si treguesi i vetëm i të qenët mysliman në shumë vende afrikane, duke përfshirë Burkina Fason, dhe atyre që pantallonat i kanë aq të gjata sa prekin këpucët nuk u jepet selam. Pothuajse veshja e një kapri do të perceptohet si një shenjë devotshmërie...

Një xhami që është përdorur prej vitesh në Burkina Faso, vend i cili është 65 për qind mysliman, u shkatërrua nën mbikëqyrjen e policisë si rezultat i kërkesës së një prifti se «toka këtu ishte pronë e imja». Ata që preferonin të mos bënin gjë kundrejt kësaj duke thënë: «Çfarë të bëjmë! Nëse shteti ka vendosur kështu, duhet t’u bindemi ulu’l-emrit / udhëheqësve.», dhe ata që kapen lehtësisht pas lutjeve duke thënë: «I ndjeri Shejh Ebu Bekr Sana njëqind vjet më parë ulej dhe bënte dhikër në kohë të tilla persekutimi të madh dhe i mallkonte ata.» Të

gjithë këta janë myslimanë. Edhe ata që e kalojnë kufirin duke thënë: “Atëherë edhe ne le ta prishim kishën për hakmarrje.”, nuk e nisin rrugën duke lexuar Biblën.

Ajetet dhe hadithet fisnike nuk do të ndryshojnë dhe atyre nuk do t’u shtohen të reja. Por në vend që të kuptojnë shpirtin e tyre, ngecja në lojërat e fjalëve dhe fjalive është një krizë. Bota islame dhe ata që ecin në krye të saj duhet ta pastrojnë vetë këtë. Mundësinë që e kërkojnë hoxhallarët, të cilët i kënaqin zemrat dhe i magjepsin njerëzit me leximin e Kuranit në Qabe, për t’i thurur lavde Izraelit, nuk duhet ta kenë gjetur shumë larg.

Nëse debatet e «qefinit që nuk digjet» do të dalin në pah ndërsa diskutohen çështjet e padukshme të besimit si parajsja, ferri dhe ndëshkimi në varr, përsëri do të ishte naivitet t’ia hidhnim fajin presidentit francez.


Nëse ende nuk e kuptojmë se, “nëse mbreti është vërtet lakuriq”, nuk ka nevojë të presim të tjerë apo fatkeqësi të mëdha për ta shprehur këtë gjendje të tij, kur dhe me çfarë ngjarje do ta realizojmë këtë? Ne si vend kemi paguar një çmim të rëndë për faktin që nuk iu përgjigjëm dot në kohën e duhur diskurseve të shtrembëruara fetare.

Nëse komuniteti nuk reagon dhe nuk i rregullon budallallëqet e pseudoshehlerëve dhe dervishëve që shfaqen me çallma në kokë, mantel në supe dhe disa tabela me kaligrafi në kurriz, atëherë kriza rritet.

Shkurtimisht, ne duhet të merremi me problemin e myslimanëve për kuptimin dhe zbatimin e frymës dhe themeleve të Islamit përpara se ai të marrë formën e një krize. Fjala nuk duhet t’u lihet të tjerëve...



A nuk ka asnjë njeri që të thotë: “Çfarë është një ajet, një hadith, një fjalë, o vëlla? A ke pirë ndonjëherë një gllënjë çaj dhe e ke lënë? A mjaftohesh me një gllënjë pije të ftohtë? Nëse fillon të ushqehesh, a thua: «Mjafton një kafshatë?» Nëse del në ajër të pastër, a lehtësohesh me një frymëmarrje? A jemi sa milingonat që të ngopemi me pika të vogla uji?



Fjala e Ditës dhe dëmet e saj

— Adem Shahin —

Çfarë është një ajet, një hadith, një fjalë? A ke pirë ndonjëherë një gllënjë çaj dhe e ke lënë? A je mjaftuar ndonjëherë me një gllënjë pije të ftohtë? Nëse fillon të hash qebap dhe lahmaxhun, a thua «mjafton një kafshatë»? Nëse del në ajër të pastër, a lehtësohesh me një frymëmarrje? A jemi sa milingonat që të ngopemi me pika të vogla uji?

Bota e internetit ka kohë që po formaton mendjet tona dhe mënyrën se si funksionon truri ynë. Nuk po flas për ndryshimin e perceptimeve dhe për të luajtjen me ndjenjat e mendimet. Ajo është një çështje më vete.

Vite më parë kishte kaseta 2-3 orë. Ne i vendosim këto kaseta në madhësinë e një libri në video dhe i shikonim disa herë, jo për disa orë. Tani, edhe videot disa minutëshe i shikojmë duke ecur përpara. Videot 7 sekondëshe janë në modë tani. Kush mundohet për të shikuar videot e gjata! Kush ka gjithë atë kohë, gjithë atë durim?

Ngjarjet e shkurtra nga jeta e të famshmëve i publikojnë duke shkruar mbi foton e tyre (Caps). Ndonjëherë, një fotografi ndahet me disa rreshta aforizmi. Sa do të ishte e mundur ta njohësh me disa rreshta dialogu dhe një rresht fjalësh një njeri që ka bërë një jetë të gjatë, që është dërrmuar nën

vështirësitë e fatit dhe që ka treguar histori sukcesi duke bërë ndryshim me bashkëkohësit e tij?

Mevlana e përmbloodhi udhëtimin e tij të mundimshëm me tri fjalë duke u shprehur: “Isha i papjekur, u poqa, u dogja.” A është e mundur ta mësosh këtë jetë të mbushur me dashuri me tri fjalë duke parë një fragment? Për të mësuar rreth treshes «Isha i papjekur, u poqa, u dogja», është e nevojshme të



lexohen veprat e Mevlanës nga fillimi në fund dhe të hyhet në atë rrugë të bekuar ku kishte hyrë Hz. Mevlana. Ndërsa me imazhe që nuk janë gjë tjetër veçse një pjatë sallatë fjalësh, nuk mund të shkohet nga papjekuria drejt pjekurisë dhe djegies.

Cili imazh na ka çuar nga pika A në pikën B? Shprehja “sa elbi” në përralla, i ngjan botës së internetit. Ecëm pak, ecëm gjatë, ecëm drejt e poshtë përroit, ecëm një vjeshtë për gjashtë muaj. Ne kemi akses në internet nga telefoni nëpërmjet wifi. Po udhëtojmë me internetin në mal, në terren, në metro, natën dhe ditën. Por kur shikojmë pas, vëmë re se kemi bërë një rrugë sa gjatësia e elbit. Apo kemi mbetur prapa duke mos e kaluar edhe atë?

Ka faqe/programe interneti që ndajnë çdo ditë një histori, një ajet dhe një hadith. A nuk ka asnjë njeri që të thotë: “Çfarë është një ajet, një hadith, një fjalë, o vëlla? A ke pirë ndonjëherë një gllënjë çaj dhe e ke lënë? A mjaftohesh me një gllënjë pije të ftohtë? Nëse fillon të hash qebap dhe lahmaxhun, a thua: «Mjafton një kafshatë?» Nëse del në ajër të pastër, a lehtësohesh me një frymëmarrje? A jemi sa milingonat që të ngopemi me pika të vogla uji? Njeriu ka nevojë për gota, shishe, broke dhe kova me ujë. Cili libër mund të lihet pasi të lexohen disa rreshta prej tij? Cili njeri mund të kuptohet me pak fjalë? Oreksi nuk ka lidhje vetëm me ngrënien dhe pirjen. Duhet të ketë oreks edhe për leximin, shkri-min dhe mendimin.

Nëse lexon/dëgjon një ajet çdo ditë, do ta lexosh/dëgjosh Kuranin Fisnik nga fillimi në fund në një mesatare prej njëzet vjetësh. Nuk bën të mjaftohesh me pak në vepra të mira. Merre Kuranin Fisnik apo

librin e hadithit dhe lexo të paktën një faqe! Përkule kokën! Zhytu në të! Harroji orët dhe faqet! Truri është i ndarë si tweete me karaktere të kufizuara. Lëreni studimin e artikujve të gjatë, por është e vështirë të lexosh edhe disa karikatura me disa rreshta. Tweet do të thotë të cicërosh «ciu, ciu» si zogjtë. A do ta shihnim edhe vlerësimin e veshit të gjatë në një farë mënyre? Kur bërtet, e mban aaaaaa-në gjatë me një frymëmarrje të gjatë.

Të qenët afatgjatë në institucione, njerëz dhe ecje është veçoria e dëshiruar. Leximi, të menduarit, marrja e një mësimi dhe të mësuarit nuk duhet të jenë sa tweet tweet, por duhet të kenë frymë më të gjatë se veshi i gjatë që thotë «aaaa». Sa më shumë gjak të marrë një mizë nga një njeri, aq më shumë informacion, mençuri dhe kuptim jep çdo mesazh që fillon me «ditën». Sa mund të ngrohesh me flakën e kashtës? Sa rrugë shihet? A gërmohet një pus me gilpërë? A mundet truri i njeriut, i cili peshon rreth një kilogram e gjysmë, të kënaqet me fjalët e ditës? Fjalët e ditës, ajetet e ditës, historitë e ditës nuk duhet të të pengojnë të shohësh pamjen e madhe. Të afrosht një pemë shumë afër syrit, e fsheh pyllin pas. Me një ajet, një hadith, një fjalë njeriu mund ta mashtrojë veten duke thënë: “Bëra diçka, bëra një hap.”

“Parku i Turqisë në miniaturë” (Miniaturk) me modelet e tij të reduktuara të vendosura me sloganin “Një model i vogël i vendit të madh”, përmban 1/25 e 122 veprave arkitekturore në Turqi. Një njeri pasi vizitoi parkun e miniaturës së Turqisë në breg të Haliçit, tha: «Nuk kam nevojë t’i shoh origjinalet e këtyre, miniaturat e tyre më mjaftojnë!» Kështu do të thotë edhe të mjaftohesh me një ajet në ditë, një hadith në ditë, me disa video vine dhe me pak caps në rrjetet sociale dhe të mos shkosh te origjinalet. Çdo gjë që paraqitet si “dita jote” (ajeti, hadithi, aforizmat, recetat...) është ylber. Është e nevojshme të përqendrohemi te shiu para tij, jo te ylberi. Dhënia pas ylberit është një emër tjetër për t’u magjepsur nga ngjyrat, për të harruar dheun, për të mos prekur ujin dhe sapunin dhe për t’u kënaqur me modelet.

Librat e thellë dhe njerëzit e thellë janë si sapuni dhe uji. Me mallëngjim i presin ata që u shkojnë. Siç pritën dje, po presin edhe sot, dhe do të presin gjithmonë edhe nesër. Kush e prek librin dhe njeriun? Sa frymëmarrje është mbretërimi i ylberit?





PENGESAT NË RRUGË

— Dr. Murat Kaja —

Njeriu, i cili është krijuar në xhenet dhe është zbritur në tokë si mëkëmbës, është si një udhëtar i çuditshëm, në rrugën e tij drejt audiencës së Allahut (xh.xh.). Në mënyrë që ai të përparojë në këtë rrugë i sigurt dhe të arrijë në destinacionin e synuar, duhet të ndjekë udhëzimin e Allahut dhe t'i kapërcejë disa pengesa.

Armiku më i madh i njeriut i cili mundohet në çdo kohë dhe në çdo vend që ta devijojë atë dhe ta nxjerrë nga rruga e drejtë është shejtani i mallkuar.¹ Për këtë arsye, njeriu duhet të qëndrojë larg nga të këqijat si mendjemadhësia, mëkati, dëshpërimi, hedhja e gabimit dikujt tjetër, urretja dhe hakmarrja.² Ai duhet të jetë shumë i kujdesshëm kundrejt mashtrimeve që djalli aplikon për ta devijuar atë nga rruga e drejtë.³ Sepse Iblisi u dëbua nga mëshira e Zotit për shkak të mendjemadhësisë dhe rebelimit të tij, edhe njeriu i parë u dëbua nga xheneti ngaqë u mashtrua prej tij.⁴ Tashmë njeriu duhet ta arrijë përsëri me meritën e tij atë vend (xhenetin).

Armiku tjetër i madh i njeriut në rrugëtimin e tij për t'u kthyer në vendin e origjinës është nefs i disa nga karakteristikat e tij. Sepse nefs është krijuar i aftë edhe për të mirën, edhe për të keqen.⁵ Andaj njeriu duhet t'i edukojë cilësitë e këqija të nefsit, në mënyrë që të arrijë shpëtimin.

Në këtë botë të sprovës ka shumë elemente që e rrisin prirjen e nefsit për të keqen. Stolia e jetës së kësaj bote është një pengesë shumë tërheqëse për të. Zoti i Plotfuqishëm na njofton për këtë siç vijon: **“Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por shumë më i mirë është kthimi tek Allahu.”**⁶

Kjo botë është zbukuruar për të sprovuar njerëzit.⁷ Njeriu që kapet pas lojërave dhe argëtimit të saj,

e harron jetën reale.⁸ Nga ana tjetër, shejtani është betuar për ta mashtruar njeriun. Ai përpiqet t'i bashkojë dobësitë e njeriut dhe joshjen e kësaj bote. Kështu i afrohet njeriut nga çdo aspekt.⁹ Ai përpiqet ta bëjë njeriun t'i ngajë karakterit të tij dhe të ketë fatin e tij.¹⁰ Në këtë mënyrë, njerëzve që largohen nga besimi dhe ia kthejnë shpinën përmendjes së Allahut (xh.xh.), nuk u mbeten dëshira të tjera. Andaj fillojnë të kërkojnë mënyrat për të qëndruar gjithmonë në këtë botë.¹¹

Një nga cilësitë e nefsit të njeriut që duhet disiplinuar është padrejtësia. Ai e dëmton veten dhe njerëzit e tjerë dhe bën padrejtësi. Vepron me guxim kundër urdhrit të Allahut dhe në fund mashtrohet.¹²

Një karakteristikë tjetër e njeriut është injoranca. Duke qenë se nuk di shumë gjëra, vepron edhe në mënyrë impulsive.¹³ Nuk e di se cili do të jetë fundi i tij dhe merr përgjegjësi të mëdha pa menduar për fundin. Ai njeh vetëm anën e dukshme të jetës së kësaj bote.¹⁴ Për këtë arsye, kur bie në vështirësi, e lut dhe i përgjërohet Allahut (xh.xh.), e pohon dobësinë e tij dhe e kujton Zotin. Ndërsa kur e arrin rehatinë, e harron edhe lutjen, edhe mirënjohjen ndaj Zotit.¹⁵ **“Jo! E vërteta është se njeriu e sheh veten të mjaftueshme dhe bëhet mosmirënjohës.”**¹⁶ Kur Allahu Teala i jep mirësi në lidhje me pasurinë dhe trupin e tij, ai gëzohet.

Por kur i vjen ndonjë fatkeqësi për shkak të mëkateve që ka bërë me duart e veta, menjëherë bie në dëshpërim dhe bëhet mosmirënjohës.¹⁷ Ai gjithashtu nuk e ka kuptuar sekretin e sprovës së kësaj bote. Çdo gjë e mat me bollëkun në pasuri. **“Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke**

1. Shik. Fatir, 5-6.

2. Shik. Ibrahim, 22; Sad, 74, 82.

3. Shik. A'raf, 22; Enfal, 48; Isra, 64; Nur, 21; Zuhruf, 62; Hashr, 16.

4. Shik. Bekare, 36; Hixhr, 32-35; Ta-ha, 120-123.

5. Shik. Insan, 3; Shems, 9-10.

6. Al Imran, 14.

7. Shik. Kehf, 7.

8. Shik. Ra'd, 26; Ankebut, 64.

9. Shik. Nisa, 119; Hixhr, 39; Isra, 64; Sad, 82.

10. Shik. Isra, 62.

11. Shik. Nexhm, 29; Taberi, Xhamiu'l-Bejan, XXII, 58.

12. Shik. A'raf, 160; Ahzab, 72; Taberi, XIX, 205.

13. Shik. Ibn Faris, Mu'xhemu mekajisi'l-luga, I, 489-490; Xhevheri, es-Sihah, III, 1223.

14. Shik. Rum, 7; Ahzab, 72; Taberi, XIX, 205; Ibn Kethir, Tefsir, XI, 252.

15. Shik. Junus, 12.

16. Alak, 6-7.

17. Shik. Hud, 9; Rum, 36; Taberi, XVIII, 501.

e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: “Zoti im më ka nderuar.” Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: “Zoti im më ka poshtëruar.”¹⁸

Një veçori tjetër që e pengon qetësinë e njeriut është koprracia dhe dashuria për pasurinë. Allahu Teala thotë: “**Thuaj: Sikur ju të zotëronit thesaret e mëshirës së Zotit tim, edhe atëherë ju do të rrudhnit dorën nga droja, se do të shpenzoheni. Njëmend, njeriu rëndom është koprrac**”.¹⁹ “**Vërtet, ai është i babëzitur për pasuri**.”²⁰ “**Jo-jo, nuk është kështu! Por ju nuk silleni mirë me jetimët dhe nuk e nxitni njëri-tjetrin për t’i ushqyer të varfrit. Trashëgiminë (e të dobëtëve) e zhatni me lakmi të pangopur dhe e doni pasurinë me një dëshirë të pakufishme**.”²¹ Njeriu mendon se pasuria e tij do ta mbajë të gjallë përgjithmonë.²² Megjithatë, ky është një mashtrim i madh.

Një veçori tjetër që e çon njeriun në rrugë të gabuar është të qenët tamahqar. Ai kurrë nuk dëshiron të heqë dorë nga të drejtat, interesat dhe dëshirat e tij. Gjithmonë mendon për rehatinë e vet.²³ Nuk lodhet duke kërkuar pasuri dhe shëndet.²⁴ Allahu Teala e kundërshton këtë natyrë të tij dhe e inkurajon atë t’i bindet shariatit dhe të bëhet i mirë dhe i devotshëm.²⁵ “**...Kushdo që arrin të mbrohet nga egoizmi i nefsit të tij, ja këta do të arrijnë shpëtimin**.”²⁶

Kurani flet edhe për ndjenjën e zilisë së njeriut. Për shkak të ndjenjës së zilisë, njeriu mund të bëhet aq mizor sa të vrasë edhe vëllain e vet.²⁷

Njeriu është mosmirënjohës, i harron shpejt të mirat që i bëhen.²⁸ Ai nuk ia di vlerën mirësisë që posedon.

Një nga aspektet e njeriut që ka nevojë për disiplinim është të qenët i tij i nxituar. “Njeriu është krijuar i nxitueshëm” ose “nga nxitimi.”²⁹ Madje ai për shkak të injorancës dhe nxitimit të tij, ashtu siç lutet për të mirën, lutet edhe për të keqen e tij. Kur mërzhitet ose zemërohet, fillon ta mallkojë veten dhe të dashurit e tij.³⁰ I Dërguari i Allahut (a.s.), i paralajmëroi politeistët mekas se, nëse ata nuk do të besonin, do t’i godiste një dënim i dhembshëm.

18. Fexhr, 15-16.

19. Isra, 100.

20. Adijat, 8.

21. Fexhr, 17-20.

22. Shik. Humeze, 3.

23. Shik. Nisa, 128; Hashr, 9; Taberi, VII, 561-566; Zemahsheri, II, 157; Ibn Atijje, Muharrar, III, 37-38; Neseфи, Medarik, I, 401.

24. Shik. Fussilet, 49; Taberi, XX, 457.

25. Shik. Nisa, 128; Neseфи, I, 401.

26. Tegabun, 16.

27. Shik. Nisa, 54; Maide, 27; Jusuf, 9.

28. Shik. Ibrahim, 34; Abese, 17; Adijat, 6.

29. Shik. Enbija, 37; Ibn Ashur, Tahrir, XVII, 68.

30. Shik. Isra, 11; Taberi, XIV, 512-513; Ibn Atijje, V, 447.

Kurse ata kërkuar që ndëshkimi t’u vinte sa më shpejt, t’u binin gurë nga sipër, madje që kiameti të shpërthente sa më shpejt. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar tha: “Unë do t’ua tregoj ajetet e Mía. Andaj mos i kërkonit me nxitim.” Nëse aspekti i nxitimit të njeriut nuk disiplinohet, ai mund ta sakrifikojë lumturinë e tij të përvetshme për një kënaqësi të thjeshtë të kësaj bote.³¹

Një manifestim i nxitimit tek njeriu është prirja e tepërt ndaj jetës së kësaj bote. Emri Axhile, i cili rrjedh nga e njëjta rrënjë si nxitimi, është përdorur për këtë botë dhe tregon se njeriu i pëlqen të punojë për këtë botë dhe ta marrë shpërblimin e asaj që ka bërë pikërisht këtu. «**Jo! Në fakt, ju e doni Axhilen (të shpejtën, interesin e dynjasë që vjen e shkon shpejt), ndërsa e lini mënjandë botën tjetër**.”³²

Gjithashtu thuhet se njeriu është «një qenie që i pëlqen shumë debati».³³ Ai për shkak të ndjenjës së fortë të egoizmit që ka në vetvete, shpreh mendim edhe për çështjet që nuk ka njohuri dhe hyn në debat për këtë. Ndërkohë dija e tij është e kufizuar. Ato që nuk i di janë shumë më tepër se ato që i di. Për shembull, ai nuk mund ta dijë të padukshmen dhe nuk mund ta dijë se çfarë do të ndodhë nesër. Ai nuk mund ta dijë as kohën dhe vendin e vdekjes së tij, që është kiameti i tij, as kohën e Kiametit të madh.³⁴ Megjithatë, ai përfshihet në debate për çështje të padukshme që mund të dihen vetëm me atë që na mëson Allahu (xh.xh.). Krenaria dhe arroganca e tij e shtynë atë në debate boshe dhe të pakuptimta.

Përveç të gjitha këtyre, njeriu është krijuar edhe i dobët. Ai mbart disa dobësi fizike dhe shpirtërore. Nuk mund t’i sundojë dëshirat vetjake, nuk mund të durojë ndaj problemeve të adhurimit dhe bindjes,³⁵ nuk mund të bëjë çfarë dëshiron dhe nuk është i vendosur për ta mbajtur fjalën.³⁶ Për këtë arsye, njeriu gjithmonë ka nevojë për një edukim dhe mbështetje shpirtërore.

Së fundi, njeriu nuk duhet ta harrojë se ky udhëtim është një sprovë me çdo gjë të tij. Allahu (xh.xh.), e sprovon njeriun edhe me mirësi, begati, lumturi, shëndet dhe sukses, edhe me të keqe, vësh-tirësi, pikëllim, sëmundje dhe humbje.³⁷ Kurse ajo që duhet të bëjmë për ta fituar këtë sprovë është të jemi të durueshëm në mënyrë të mirëfilltë, duke kujtuar në çdo moment se jemi robër të Allahut dhe se jemi rrugës për t’u kthyer tek Ai.

31. Shik. Enbija, 37-38; Taberi, XVI, 270-275; Ibn Ashur, XV, 42.

32. Kijame, 20-21.

33. Shik. Kehf, 54.

34. Shik. En’am, 59; A’raf, 187; Merjem, 78; Neml, 65; Lukman, 34; Nexhm, 35.

35. Shik. Nisa, 28; Taberi, VI, 624-625; Maturidi, Te’vilat, III, 174; Zemahsheri, Keshshaf, II, 61.

36. Shik. Isra, 37; Ta-ha, 115.

37. Shik. Bekare, 155; Enbija, 35.

Fryma është ringjallje dhe përjetësi

— Rabia Brodbeck —

Sic një njeri fillon të marrë frymë sapo lind dhe vazhdon të marrë frymë gjatë gjithë jetës, si domosdoshmëri e krijimit të tij, po kështu një njeri që thotë «Unë jam mysliman» duhet t'i drejtohet Zotit me namaz sa më shpejt sapo kjo fjalë t'i dalë nga goja dhe, si domosdoshmëri e krijimit të tij, duhet të marrë frymë në sexhde deri në fund të jetës. Vetëm atëherë do të thotë të vërtetën dhe vetëm atëherë do të jetë e mundur që besimi të vendoset në zemrën e tij.

Çdo ditë, qindra mijëra njerëz në botë e kanë të vështirë të marrin frymë nën ndikimin e koronavirusit dhe mijëra njerëz po e humbin jetën ngaqë nuk mund të marrin frymë. Georg Floyd, i cili u ekspozua ndaj dhunës së policisë në Amerikë, u lut për tetë minuta e 40 sekonda duke thënë: “Nuk mund të marr frymë...” Ai rënkon dhe fatkeqësisht humbi jetën nën zullumin e policisë amerikane.

Në një botë ku gjithçka përbëhet nga pamjet e jashtme, po mbesim të privuar nga frymëmarrja. Në një botë ku jemi kthyer në epokën e injorancës para se të vinte në këtë botë Profeti (a.s.), në këtë botë ku shejtani i ka shtirë në dorën e tij mendjet, zemrat, jetën dhe vetëdijen tonë, në këtë botë ku njerëzit janë të shkëputur nga përshtirshmëria dhe bëjnë një jetë si budallenjtë e interesit, po mbetemi të privuar nga frymëmarrja.

Në botën biologjike, frymëmarrja është jetë. Në botën shpirtërore, fryma është ringjallje, përjetësi dhe dritë. Kur njeriu gjendet në një sistem ku mungon rregulli e harmonia dhe ka errësirë, e humbet frymën dhe stili i tij i jetesës bëhet mekanik. Për shkak se në epokën tonë qeniet njerëzore janë privuar nga thithja e oksigjenit të pastër, po vuajnë nga vështirësia në frymëmarrje. Kur besimtari mbetet në errësirë, nuk merr dot frymë dhe frika, shqetësimi e dëshpërimi ia vështirësojnë edhe më shumë marrjen e frymës. Dashuria, mëshira, dhembshuria dhe bujaria e shtojnë frymëmarrjen dhe i zgjerojnë mushkëritë.

Natyra po e ka të vështirë të marrë frymë. Jeta moderne e ka humbur hijeshinë, begatinë dhe lë-

vizshmërinë e saj. Rrjedha e jetës është ndalur. Ajri harmonik dhe paqësor është zhdukur. Jemi mbytur, fyti na është shtrënguar dhe jemi të privuar nga thithja e rrymës universale të jetës. Në shoqëritë moderne, jeta e njeriut është e privuar nga bukuria, hiri, bollëku, sharmi dhe dashuria. Ajo e ka humbur themelin. Thelbi i saj është shkullur dhe shkatërruar. Ndjenja e admirimit, ndjenja e aderimit dhe ndjenja e frikërespektit ndaj Zotit kanë humbur kundrejt mirësive të pafundme të Allahut (xh.xh.). Kjo është arsyeja pse jemi në një verbëri shpirtërore. Të jesh i verbër ndaj mrekullive të artit të Tij do të thotë të jesh injorant dhe mosmirënjohës.

Sic vdes njeriu nga mungesa e ajrit, edhe mungesa e Islamit e vret atë. Njeriu i privuar nga Islami është i dënuar me vdekje pas një kohe të caktuar, pikërisht si truri i privuar nga oksigjeni ose trupi i privuar nga rrjedhja e gjakut. Kur Islami është i paplotë, ne mbetemi të privuar nga atributet njerëzore. Kur të mungojnë cilësitë njerëzore, realizohet vdekja shpirtërore.

Lutja e njeriut është si kordoni që lidh embrionin me nënën. Njeriu është i lidhur me Allahun ashtu si foshnja është e lidhur me nënën. Pa kordonin që ushqen embrionin dhe i jep jetë, foshnja vdes menjëherë. Edhe ne duhet të mbahemi me gjithë forcën dhe insistimin tonë pas kordonit që na lidh me Zotin (xh.xh.). Në momentin që e lëshojmë këtë kordon, përjetojmë vdekjen shpirtërore.

Hz. Mevlana bën një përcaktim të qëlluar: «Ata



po e vrasin jetën e tyre të përhershme me duart e tyre.» “Ndjekja e dëshirave të nefsit nga njeriu do të thotë që ky i fundit të ikë dhe largohet nga Allahu dhe të derdhë gjakun e qenies së tij shpirtërore në audiencën e drejtësisë së Tij.”

Në krijimin e njeriut është fryrë Nefhatu'r-Rahman (fryma e Zotit). Vepra e krijimit të Allahut u bë duke i fryrë njeriut këtë frymë. Njerëzve u jepet jetë me këtë Frymë Mëshire. Të gjitha krijesat janë të mbushura plot me këtë frymë, dhe kjo frymë ekziston në të gjithë universin. Hz. Ibnu'l-Arabiu thotë: «Universi qarkullon me frymën e Tij.» Për këtë arsye, të gjitha krijesat janë në adhurim të vazhdueshëm ndaj Zotit (xh.xh.). Në Kuranin Fisnik thuhet: **“Shtatë qiej dhe toka dhe çdo gjë në to e lavdërojnë Atë. Dhe nuk ka asgjë që nuk e lartëson Atë me lavdërim.”** (Isra, 44) Ajeti: **“Pra, cilën nga mirësitë e Zotit tuaj mohoni?”**, është përsëritur tridhjetë e një herë në suren Rrahman. Allahu i Madhëruar na e kujton se duhet t'ua dimë vlerën mirësive dhe dhuratave të panumërta të Tij. Ai na fton të dëshmojmë bukurinë e përrjetshme të thesareve të krijimit. Na thërret në admirim, dashuri dhe frymëzim hyjnor.

Njeriu modern është në një gjendje që e ka humbur dimensionin e tij shpirtëror. E ka humbur realitetin, ekuilibrin dhe lidhjen vertikale. Për këtë arsye, ai duhet të përshtatet me rendin hyjnor, në mënyrë që ta rivendosë harmoninë me veten dhe ambientin përreth tij. Qëllimi i një besimtarit që beson në tevhid është ta rizbulojë dhe rifitojë lidhjen që e ka humbur me gjithësinë. Ai duhet t'i rifitojë ndjeshmërinë dhe pastërtinë e tij ndaj mëshirës e mirësisë dhe ta fitojë përsëri furnizimin e ahiretit. Duhet t'i rifitojë ato që i janë fshirë nga ndërgjegjja dhe ato që i janë shkullur nga zemra. Ai duhet të rimësojë t'i thitë (perceptojë) tokën, gurët, shkretëtirën, ujin, malet, pemët, qiellin, hënën dhe yjet. Duhet të rimësojë të dorëzohet në rrjedhën kozmike të universit. Me pak fjalë, duhet ta zgjojë veten për ato gjëra që na janë zhdukur nga vetëdija dhe zemra


jonë. Duhet të gjejmë mundësinë për ta korrigjuar, përforcuar dhe zbukuruar marrëdhënien tonë me Zotin Dhu'l-Xhelali ve'l-Ikram.

Asnjëherë më parë në këtë botë nuk kemi pasur një nevojë të tillë për të kujtuar se nga kemi ardhur dhe për t'u kthyer tek rrënjët tona. Në botën e sotme, paqëndrueshmëria, sëmundjet, terrori dhe fatkeqësitë po e bëjnë njerëzimin urgjentisht të ketë nevojë për rinovim, qetësi, rehati, pastërti dhe dëlirësi. Ne duhet të jemi në gjendje ta bëjmë të dukshme pastërtinë dhe unitetin e të gjitha qenieve. Edhe Kurani Fisnik është dërguar për paqen, dritën, të vërtetën dhe virtytin në një kohë kur njerëzimi ishte i shkatërruar dhe kishte rënë në errësirën e injorancës. Shpalljet theksuan burimin e gjithë ekzistencës.

Në fillim të ekzistencës kishte një përtëritje, një ringjallje. Sot shoqëria moderne e ka humbur lidhjen me rrënjët dhe qëllimin e vërtetë të jetës. Çdo gjë duhet të kthehet në vendin e vërtetë. Është e nevojshme të ktheheni në lamekan (aty ku s'ka vend, te Zoti), ku gjendja e njëshmërisë së Allahut të Madhëruar dhe Realitetit Hyjnor nuk devijojnë apo ndryshojnë aspak. Në këtë mënyrë Kurani Fisnik do të na ndriçojë sërish.

Fryma që marrim mbart atributin «i gjallë» i Allahut (xh.xh.). Fryma që nxjerrim mbart atributin «hu-ai» të Allahut. Kur të dashuruarit marrin dhe japin frymë, përjetojnë aromën e ëmbël të dhikrit. Ata dëshmojnë njëshmërinë e Allahut të Madhëruar në çdo frymëmarrje. Ndjejnë aromën e këndshme të ekzistencës. Vëzhgojnë begatinë e të gjitha gjërave në çdo moment. Marrin frymë hyjnore plot mëshirë. Shijojnë aromën e ëmbël të botës tjetër. Përjetojnë mirësinë hyjnore të shkrirjes te Zoti i tyre. Dëshmojnë rëniën e thesareve të pafundme. Magjepsen me aromat e xhenetit të atmosferës së kurbijetit/ afrimit me Zotin dhe derdhin lot lumturie.

Lamba e jetës do të fiket, frymëmarrjet e numëruara do të marrin fund. Çdo besimtar është e obliguar të shqetësohet për frymën e tij të fundit dhe të përgatitet për botën e përtejme. Në fakt, edhe Ibrahim (a.s.), i cili ishte miku i Allahut, iu përgjërue Zotit të tij me këtë shqetësim; **“Mos më turpëro në ditën kur (robërit e Tu) do të ringjallen!”** (Shuara, 87) Edhe Hz. Jusufi gjithashtu i është përgjërue Zotit duke u shprehur: **“..(O Zoti im!) Më bëj të vdes si mysliman dhe më përfshi në mesin e të mirëve!”** Mevlana Xhelaeddin Rumi lidhur me temën në fjalë ka thënë: “Thelbi i të gjitha diturive është që njeriu ta dijë se çfarë do të ndodhë në Ditën e Tubimit.” Çdo besimtar duhet të jetë i vetëdijshëm për Ditën e Kiametit.



Allahu do ta plotësojë mirësinë e të Dërguarit të Tij

— Abdullah Sert —

“O Fatime, Allahu (xh.sh.), e ka dërguar babanë tënd me një fe të tillë që, Allahu do ta çojë këtë fe në të gjitha shtëpitë dhe tendat që gjenden në sipërfaqen e tokës, Ai do t’u japë lavdi atyre që e pranojnë dhe do t’i poshtërojë ata që e luftojnë! Kjo fe do të arrijë dhe do të përhapet në çdo vend ku arrin nata.”
(Hakim, I, 664/1797; Hejthemi, VIII, 263.)

Hallka dhe vula e fundit e zinxhirit të të dërguarve, Pejgamberi ynë i Nderuar, (a.s.), ka arritur mirësi të ndryshme nga Allahu i Madhëruar si ndryshe nga të gjitha krijesat.

“O i dashuri im!) **Allahu të ka zbritur ty Librin dhe urtësinë dhe të mësoi atë që** (më parë) **nuk e dije. Mirësia dhe ndihma e Allahut mbi ty është shumë e madhe.**” (Nisa, 119) Kjo mirësi në këtë ajet është shprehur me fjalën «adhim/shumë e madhe». Në vende të ndryshme të Kuranit Fisnik lajmërohe mi se si i Dërguari i Allahut mbarohet nga Allahu, se feja që ai predikoi do të ruhet deri në ditën e kiametit dhe se veçanërisht Librin e Shenjtë që i është shpallur atij, do të mbrohet nga vetë Allahu i Madhëruar pa pësuar asnjë manipulim.

Edhe Pejgamberi ynë i Nderuar (a.s.), si një njeri që ishte, sigurisht që kishte nevojë për një ngushëllim hyjnor. Për këtë arsye, Zoti (xh.sh.), ka shprehje të veçanta për të dashurin e Tij:

“Ne të kemi dërguar ty (o i dashuri Im) si profet për të gjithë njerëzit. Allahu të mjafton si dëshmitar (për këtë).» (Nisa, 79)

“Jobsimtarët thonë: “Ti nuk je i dërguar!” Thuaju (o Muhamed!): “Mjafton Allahu për dëshmitar midis meje dhe jush dhe ata që kanë dijeni për Librin (besimtarët çifutë dhe të krishterë të asaj kohe).” (Ra’d, 43)

“Ne të mjaftojmë ty kundër atyre që të tallin, e të cilët, përveç Allahut, adhurojnë edhe zot tjetër. Do ta marrin vesh mirë ata! Ne e dimë mirë, që ty të ngushtohet zemra nga fjalët e tyre, andaj, lartësoje Zotin tënd duke e lavdëruar dhe bëhu

prej atyre që i përulen Atij duke u falur!”
(Hixhr, 95-98)

“Ti (o Muhamed) mos u brengos nga ata që nxitojnë në mohim, sepse, në të vërtetë ata nuk mund ta dëmtojnë Allahun aspak. Allahu dëshiron që të mos i shpërblejë me kurrfarë dhurate në botën tjetër; dhe për ata ka ndëshkim të madh.” (Al Imran, 176)

“Sa për ata që nuk besojnë, ti (o Muhamed), mos u brengos nga mohimi i tyre. Ata do të kthehen te Ne, e Ne do t’i njoftojmë për atë që kanë bërë. Me të vërtetë, Allahu di ç’ka në zemrat e njerëzve.” (Lukman, 23)

Ndërsa nga njëra anë Zoti i Madhërishtëm e ngushëllon të Dërguarin e Tij, nga ana tjetër ka dhënë mirësi hyjnore në lidhje edhe me personatitetin e tij të bekuar, edhe me fenë sublime që ai predikonte:



“Vallë, a nuk ta hapëm ty (Muhamed) kraharorin (për të pranuar besimin) dhe ta hoqëm barrën, e cila ta rëndonte tepër kurrizin, dhe ta ngritëm lart emrin?!» (Inshirah, 1-4)

Në veçanti, ajetet e para të sures Fet’h: **“Ne të dhamë ty një fitore të qartë, për të t’i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme, për ta plotësuar dhuntinë e Vet ndaj teje dhe për të të udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe që Allahu të të japë ndihmë të madhe.”** (Fet’h 1-2), janë specifikisht për të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Kadi Ijaz (1083 -1149), autori i veprës me titull «esh-Shifa bi ta’ rifi hukuki’l-Mustafa» apo me titullin e saj të njohur «Shifau’sh-Sherif», e cila ka një vend shumë të veçantë në mesin e veprave të panumërta për biografinë e Hz. Pejgamberit, për luftërat e tij e për transmetimet dhe e cila është lexuar si burim i rëndësishëm në mbarë botën islame për shekuj me radhë, është shprehur në lidhje me interpretimin e këtyre ajeteve:

“Këto ajete tregojnë se çfarë mirësish i dha Allahu Teala të Dërguarit të Tij, se si e lavdëroi, se si ia ngriti/lartësoi vlerën e tij dhe se si i dhuroi mirësi që nuk mund të numërohen dhe nuk mund t’u dihet natyra e tyre. Ja pra, për t’i treguar këto, Allahu i Lartësuar i shpalli atij se çfarë të ardhme i kishte caktuar që nga momenti kur ai doli si pejgamber dhe e filloi fjalën e Tij duke informuar se Pejgamberi do t’i mundte armiqtë e tij dhe se feja që solli do të përhapej në të gjithë botën. Pastaj u shpreh: «Ai do ta plotësojë mirësinë e Tij ndaj Teje.» Kuptimi i kësaj është: “O i Dërguari Im! Unë do të bëj që të të nënshtrohen ata që janë kryelartë kundër teje, umeti yt do të arrijë një fitore të lavdishme dhe të ndershme, paqja dhe qetësia do të zbresin në zemrat e umetit tënd besimtar, armiqtë e profetit do të humbasin në këtë botë dhe në botën tjetër ata do të jenë të mallkuar dhe të larguar nga mëshira Ime dhe një fund i keq është gati për ta.» (Shifau’sh- Sherif, vëll. 1, fq. 145-146).

Këto përgëzime hyjnore u realizuan qartazi derisa i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte ende gjallë. Lajmet më interesante ndërmjet shumë lajmeve rreth të ardhmes që do të ndodhin deri në kiamet në lidhje me umetin, janë deklaratat profetike për të ardhmen e Islamit.

Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), u kthye nga një ekspeditë, shkoi te vajza e tij, Fatimeja (r.anha) Hz. Fatimeja filloi të qante pasi i puthi fytyrën dhe sytë e babait të saj të nderuar. Profeti (a.s.), e pyeti:

«Çfarë ke, pse po qan?» Fatimeja (r.anha), i tha:

“O i Dërguari i Allahut, fytyra të është zbehur, rrobat të janë vjetruar, edhe ty po të shoh shumë të lodhur dhe të rraskapitur!”

I Dërguari i Allahut, alejhi’s-salam, i tha vajzës së tij të dashur:

“O Fatime, Allahu (xh.sh.), e ka dërguar babanë tënd me një fe të tillë që, Allahu do ta çojë këtë fe në të gjitha shtëpitë dhe tendat që gjenden në sipërfaqen e tokës, Ai do t’u japë lavdi atyre që e pranojnë dhe do t’i poshtërojë ata që e luftojnë! Kjo fe do të arrijë dhe do të përhapet në çdo vend ku arrin nata.” (Hakim, I, 664/1797; Hejthem, VIII, 263.)

Abdullah ibn Mes’udi (r.a.), thotë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (a.s.), duke thënë:

“Ju do të ndihmoheni dhe do t’i mposhtni armiqtë tuaj, do të fitoni plaçka lufte dhe do të çlironi shumë vende. Kushdo prej jush që e arrin këtë kohë, le t’i frikësohet Allahut, të urdhërojë për të mirë dhe të ndalojë nga e keqja. Kushdo që me vetëdije gënjen në emrin tim, le të përgatitet për vendin e tij në xhehenem.” (Tirmidhi, Fiten, 70/2257; Ahmed, I, 401, 436.)

Ata që kanë luftuar me fenë e Allahut dhe me të dërguarit e nderuar, të cilët e kanë predikuar atë fe gjatë gjithë historisë, qofshin ata një komunitet apo udhëheqësit e një komuniteti, nuk e kanë gjetur dot atë që kanë shpresuar.

Ato që mbeten prej tyre janë historitë e trishtueshme që i kanë përjetuar që në këtë botë si rrjedhojë e padrejtësive të tyre:

«Ata e kthejnë mënjanë kokën (nga mendjema-dhësia), që të largojnë të tjerët nga rruga e Allahut. Këta njerëz do të poshtërohen në këtë botë, kurse në Ditën e Kiametit Ne do t’i bëjmë, që të shijojnë dënimin e zjarrit të ndezur fort (duke iu thënë): “Ky (dënim) është për shkak të veprave tuaja, se Allahu nuk është i padrejtë ndaj robërve të Tij.” (Haxh, 9-10)

«Kush mendon se Allahu nuk do ta ndihmojë (Muhamedin) në këtë botë dhe në botën tjetër, le të lidhë një litar në tavan e të varet! Pastaj le të shohë nëse do t’ia largojë ky veprim hidhërimin!» (Haxh, 15)

Ruga e vetme për qetësinë e zemrës dhe prehjen shpirtërore në këtë botë dhe e shpëtimit në botën e përjetshme është besimi në të Dërguarin, respekti ndaj tij, ndihma ndaj tij dhe ndjekja e Nurit (Kuranit) që i është shpallur Atij.

Kjo është bota reale dhe shpëtimi në ahiret. (shik. A’raf, 157.)



Shembull i dinjitetit në dije, ibadet dhe singefitet:

IMAM MALIKU (R.A.)

“UDHËRRËFYESJA JOTE LE TË JETË DEVOTSHMËRIA!”

Dijetari i madh i hadithit dhe jurisprudencës i Medinës, vendit të hixhretit, Imam Maliku, i këshillonte kalifët e periudhës së tij. Atyre u jepte si shembull kalifët e drejtë që ishin paraardhësit e devotshëm të tyre dhe gjendjet e mrekullueshme plot asketizëm dhe devotshmëri të sahabëve dhe tabiinëve. Në një letër që ia kishte shkruar kalifit të asaj kohe, kishte thënë:

“Omeri (r.a.), ka bërë haxh dhjetë herë. Sipas informacionit që kam unë, përgjatë një haxhi harxhonte vetëm dymbëdhjetë dinarë. Ai bunte në hije të pemës, jo në çadër. Torbën e qumështit e mbante në qafë. Ecte nëpër tregje dhe i pyeste tregtarët për gjendjen e tyre. Siç dihet, kur u plagos, sahabët i shkuan pranë dhe filluan ta lavdëronin e vlerësonin. Ndërsa Omeri (r.a.), ua ktheu:

“Është mashtruar ai që kaplohet nga fjalë të tilla. Nëse do të kisha të gjithë florinj të botës, do t'i sakrifikoja të gjithë për të shpëtuar nga tmerret e ditës së mahsherit!”

Ky ishte Omeri i cili çdo gjë e bënte me vend dhe drejtësi. Në çdo gjë pati korrur sukses. I Dërguari i Allahut (a.s.), e pati përgëzuar me xhenet. Krahas kësaj, ai përsëri kishte frikë dhe përpiqej që t'i administronte në formën më të mirë punët e myslimanëve që i kishte marrë përsipër. Nëse ai mendonte kështu, atëherë të tjerët e kanë punën të vështirë.

O kalif! Bëj vepra që të afrojnë te Allahu, në mënyrë që ato vepra të të shpëtojnë nesër. Ki frikë nga ajo ditë e tmerrshme në të cilën të shpëton vetëm vepra jote. Le të jenë shembull për ty të mirët prej njerëzve të kaluar. Ji i devotshëm! Devotshmëria le të jetë udhërrëfytesja jote kurdo që të duash për të bërë ndonjë punë. Mbaji parasysh gjithmonë këto që t'i kam shkruar. Bëja detyrë vetes për t'i pasuar ato, për t'i vlerësuar dhe për të vepruar sipas tyre. I lutem Allahut që të na japë suksese dhe udhëzim.” (Kadi Ijaz, Tertibu'l-Medarik, Daru Kutubi Misrije, fq. 271.)

Përsëri Imam Maliku ka thënë:

“Nëse njeriu nuk i bën mirësi vetes, edhe njerëzit nuk i bëjnë mirësi atij.”





“Ai që nuk i bën dobi vetes, nuk mund t’u bëjë dobi të tjerëve.”

“Imam Maliku ka thënë: “Nëse njeriu nuk i bën mirësi vetes, edhe njerëzit nuk i bëjnë mirësi atij.”

“Ai që hyn në xhami dhe ka në zemër shenjë të hipokrizisë, i ngjan harabelit në kafaz. Sapo të hapet dera e kafazit, menjëherë fluturon dhe arratiset.”

Bazuar në këtë të vërtetë, patjetër duhet të mendojmë për gjendjen e atyre që nuk e shoqërojnë xhematin.

“Nëse dikush fillon ta lavdërojë veten, i bie vlera.”

“Mburoja e dijes është thënia “Nuk e di”.”

“Ai që dëshiron të marrë dije, duhet të ketë dinjitet dhe t’i frikësohet Allahut.”

“Imam Maliku (r.a.), ka thënë: “Mburoja e dijes është thënia “Nuk e di”.” “Ai që dëshiron të marrë dije, duhet të ketë dinjitet dhe t’i frikësohet Allahut.”

Imam Maliku ishte një ditetar i madh i rritur në një mjedis dhe familje që preokupoheshin me mësimin dhe përhapjen e haditheve fisnike të Pejgamberit (a.s.), në atmosferën e lartë shpirtërore të Medinetu’l-Munevvera e cila u ndriçua me nurin e Krenarisë së Gjithësisë, të Nderuarit tonë (a.s.). Imam Maliku jetonte me një respekt dhe përpikëri të madhe, sepse sipas tij Medina ishte vendi më i shenjtë në botë;

MADJE MË E LARTË SE QABEJA

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, është dërguar për të gjithë botën. Për këtë arsye, Imam Maliku Ravzatu’l-Mutahharanë në të cilën gjendet varri i të Nderuarit tonë, e konsideronte si vendin më të shenjtë në sipërfaqen e tokës, madje edhe më të shenjtë se Ka’betu’l-Muadhdhama. (Kadi Ijaz, Shifa, II, 95-96.)

Imam Maliku për shkak të respektit të madh që buronte nga dashuria dhe sinqeriteti ndaj Hz. Pejgamberit, nuk hipte në kafshë brenda kufijve të Medinës duke u shprehur:

“Nuk mund ta dijë se ku ka shkelur i Dërguari i Allahut.” Kur kishte nevojë për të marrë abdest, dilte jashtë Medinës, sepse Krenaria e Gjithësisë, i Dërguari i Allahut (a.s.), gjendej në Ravzatu’l-Mutahhara edhe pas vdekjes siç gjendej edhe kur ishte gjallë. Ai që e vizitonte Ravzanë pas vdekjes së Pejgamberit (a.s.), ishte sikur ta kishte vizituar për së gjalli të Nderuarin tonë. Selamet, salavatet dhe veprat e umetit i shfaqen Krenarisë së Gjithësisë, Pejgamberit tonë të Nderuar. Për këtë arsye, respekti që urdhërohet në ajete fisnike për t’u shfaqur ndaj të Nderuarit tonë, duhet të shfaqet edhe në Ravzatu’l-Mutahhara pas vdekjes së tij.

Sepse Allahu Teala thotë edhe për dëshmorët:

“Mos thoni për ata që vriten në rrugën e Allahut se janë të vdekur! Jo! Ata janë të gjallë, ndonëse ju nuk e ndjeni!” (Bekare, 154)

Edhe ky veprim i nënës sonë, Aishes (r.anha), e përforcon këtë të vërtetë:


Kur hyja në dhomën time, në të cilën ishin të varrosur i Dërguari i Allahut dhe babai im, e hiqja mbulesën pa ndonjë problem dhe thosha:

“Njëri është bashkëshorti, ndërsa tjetri është babai im.” Por pasi u varros pranë tyre edhe Omeri (r.a.), betohem në Allahun se hyja në dhomën time duke u mbuluar mirë ngaqë më vinte turp prej Omerit.” (Ahmed, VI, 202; Hakim, III, 63/4402.)

“Imam Maliku për shkak të respektit të madh që i buronte nga dashuria dhe sinqeriteti ndaj Hz. Pejgamberit, nuk hipte në kafshë brenda kufijve të Medinës duke u shprehur: “Nuk mund ta dijë vendin ku ka shkelur i Dërguari i Allahut.””

Siç janë të gjallë dëshmorët në një dimension që ne nuk e shohim, sigurisht se edhe i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, gjendet në një dimension të ndryshëm të jetës në Mesxhidu’n-Nebevi. Andaj e kemi detyrë që të shfaqim respekt dhe vlerësim në audiencën e tij sublimë.

Një ditë kur Imam Maliku (r.a.), ishte i preokupuar duke u dhënë mësim nxënësve të tij në mihra-



“SIÇ I TRADHTON
MIRAZHI SHIKUESIT DHE UA
ÇON DËM SHPRESËN ATYRE
QË SHPRESOJNË TE AJO, EDHE
SHPRESAT, DËSHIRAT DHE
PASIONET VETJAKE NDAJ KËSAJ
BOTE I KANË SHKATËRRUAR
SHUMË NJERËZ.”

bin e Mesxhidu'n-Nebevi, në xhami hyri kalifi i asaj periudhe, Ebu Xhafer el-Mansuri. Ai bëri disa pyetje. Ndërmjet tyre filloi një diskutim shkencor. Por kur Ebu Xhafer el-Mansuri u kaplua nga emocioni i diskutimit dhe e ngriti zërin, Imam Maliku i tha:

“O prijësi i besimtarëve! Mos e ngre zërin këtu, sepse Allahu Teala ka thënë si më poshtë duke i mësuar edukatën një grupi njerëzish:

“Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Pejgamberit!” (Huxhurat, 2)

Ndërsa për një grup tjetër njerëzish ka thënë duke i lavdëruar:

“Ata që e ulin zërin në prani të të Dërguarit të Allahut...” (Huxhurat, 3)

Po ashtu ka thënë duke e qortuar edhe një grup tjetër njerëzish:

“Vërtet, ata që të thërrasin ty (o Muhamed) me zë të lartë nga jashtë dhomave të tua, shumica e tyre nuk marrin vesh.” (Huxhurat, 4)

Shfaqja e respektit ndaj tij edhe pasi ka ndërruar jetë është njëlloj si shfaqja e respektit ndaj tij kur ishte gjallë.”

“Kur kalifi, Ebu Xhafer el-Mansuri e ngriti zërin në Mesxhidu'n-Nebevi, Imam Maliku i tha: “O prijësi i besimtarëve! Mos e ngre zërin këtu, sepse Allahu Teala ka thënë si më poshtë duke i mësuar edukatën një grupi njerëzish: **“Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Pejgamberit!”** (Huxhurat, 2)”

Kalifi kundrejt kësaj edukate të lartë që e dëshmoi, pyeti:

“O Imam! A të kthehem nga kibla apo nga i Dërguari i Allahut kur të bëj lutje?”

Imam Maliku i tha:

“Përse të mos drejtohesh nga ai?! Ai është shkak për faljen dhe shpëtimin tënd dhe të gjyshit tënd, Ademit te Allahu. Përkundrazi kthehu nga Pejgamberi ynë i Nderuar dhe kërko ndërmjetësimin e tij, në mënyrë që edhe Allahu Teala ta bëjë atë ndërmjetës për ty!...” Allahu i Madhëruar thotë:

“...Dhe në qoftë se ata, kurdo që ta ngarkonin veten (me gjynahe), të vinin te ti për t'i kërkuar falje Allahut dhe i Dërguari t'i lutej Allahut për shfajësimin e tyre, do ta vërenin, se Allahu, me të vërtetë, është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.” (Nisa, 64)” (Kadi Ijaz, Shifa, II, 41.)

“Imam Maliku (r.a.), kur vinte ndonjë mysafir për të pyetur në lidhje me ndonjë hadith fisnik, merrte abdest, vinte çallmën, hidhte aromë të mirë, ulej në një vend të lartë dhe pastaj e pranonte brenda atë. Pyetjes i përgjigjej me një përkushtim të madh.”

Edhe ne duhet të marrim mësim nga kjo edukatë

e madhe e Imam Malikut, (r.a.) dhe veten duhet ta pyesim:

PO NE?..

Ne nuk duhet ta harrojmë kurrë se jemi në audiencën sublime të të Nderuarit tonë (a.s.), përgjatë vizitave që i bëjmë në Ravza dhe në Mesxhidu'n-Nebevi, madje edhe në çdo vend tjetër të Medinetu'l-Munevveras. Në atë vend më të bekuar duhet të turpërohemi nga lëndimi apo shqetësimi edhe më i vogël ndaj çdo individi të umetit të Muhamedit dhe duhet të shfaqim një edukatë të madhe. Zëri nuk duhet të ngrihet kurrë dhe veçanërisht duhet të preferohet meditim i thellë në heshtje duke u larguar nga bisedat e padobishme. Gjuha dhe zemrat në atë vend të shenjtë duhet të magjepsen ndaj selameve dhe salavateve me një mallëngjim tepër të madh.

“Një ditë kur Imam Maliku (r.a.), po jepte mësim hadithi, një akrep e pickoi disa herë. Ndërsa ai bëri durim deri në fund të mësimit për shkak të respektit që kishte ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.).”

Ja pra, Imam Maliku i cili dallohej me këtë edukatë të jashtëzakonshme, banonte në shtëpinë që kishte banuar Abdullah ibn Mes'udi (r.a.), në Medine. Ndërsa në Mesxhidu'n-Nebevi (Xhaminë e Pejgamberit) ulej në vendin ku ishte ulur Omeri (r.a.). Edhe Imam Maliku ashtu si Imam Azami i jepte mësimet në xhami. Përgjatë jetës ditore që e kalonte në Mesxhidu'n-Nebevi, falte pesë kohët e namazit, frekuentonte me xhemat namazet e xhena-zeve, vizitonte të sëmurët, kryente punët personale dhe pastaj ulej e qëndronte në xhami. Përgjatë kësaj kohe nxënësit mblidheshin rreth e rrotull tij dhe merrnin mësim.

Imam Maliku sillej me një përpikëri të madhe dhe edukatë të lartë në atë vend fisnik dhe detyrë sublime. Sa shembull i bukur është për këtë kjo histori që e tregon Abdullah ibn Mubareku (r.a.):

“Isha pranë Imam Malikut. Ai po na transmetonte hadithet fisnike të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Përgjatë kësaj kohe atij i ndodhi diçka. Nga fytyra dukej se po ndjente dhimbje. Ngjyra i ndryshonte dhe fytyra i zverdhej, por prapë se prapë nuk e ndërpriste transmetimin e haditheve fisnike të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Kur mbaroi mësimi dhe njerëzit u shpërndanë, e pyeta:

“O Imam! Sot të pashë në një gjendje pak si të çuditshme?”

Ai mu përgjigj:

“Po. Përgjatë mësimit erdhi një akrep dhe më pickoi disa herë. Çdo herë që më pickoi bëra durim. Këtë durim e shfaqta vetëm për shkak të respektit të

madh që kam ndaj Resulullahut (a.s.).” (Munavi, III, 333; Sujuti, Miftahu’l-Xhennet, fq. 52.)

Imam Maliku, (r.a.), dallohej me dinjitetin dhe madhështinë të cilat janë një faktor i rëndësishëm i personalitetit Islam. Ai vepronte me seriozitetin që ia kërkonte dija që ua mësonte të tjerëve dhe mihrabi në të cilin gjendej. Ai thoshte:

“Ata që marrin dije duhet të kenë dinjitet, të jenë seriozë dhe të shkojnë në rrugën e paraardhësve. Dijetarët duhet të qëndrojnë larg shakasë, sidomos përgjatë diskutimeve shkencore. Të mos qeshësh me zë të lartë, por vetëm të buzëqeshësh është prej edukatës që dijetari duhet ta posedojë.”

KUR FILLONTE HADITHIN FISNIK...

Një nxënës i tij thotë:

“Kur Imam Maliku qëndronte me ne, sillej sikur të ishte një prej nesh. Ai merrte pjesë në një formë krejt të thjeshtë në bisedat tona. Por kur fillonte të fliste dhe të shpjegonte hadithet fisnike, fjalët e tij mbartnin shumë madhësi. Sikur ai nuk na njihnte ne dhe ne nuk e njihnim atë.”

“Imam Maliku (r.a.), ka thënë: “Ai që hyn në xhami dhe ka në zemër shenjë të hipokrizisë, i ngjan harabelit në kafaz. Sapo të hapet dera e kafazit, menjëherë fluturon dhe arratiset.”

Imam Maliku kishte një ndjeshmëri të veçantë ndaj shkencës së hadithit për shkak të respektit që kishte ndaj Pejgamberit tonë të Nderuar. Ndërkohë që sillej normal ndaj atyre që vinin për të marrë fetva dhe për të mësuar jurisprudencën islame, kur vinte ndonjë mysafir për të pyetur në lidhje me ndonjë hadith fisnik, merrte abdest, vinte çallmën, hidhte aromë të mirë, ulej në një vend të lartë dhe pastaj e pranonte brenda atë. Pyetjes i përgjigjej me një përkushtim të madh. Brenda ndizej temjan. Kështu që temjanica përhapte aromë të këndshme derisa mbaronte mësimi i hadithit fisnik.

Në këtë mënyrë e përgatiste veten ndaj përsjerpshmërisë së të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe shfaqte një përpikëri të jashtëzakonshme ngaqë do të transmetonte fjalët e tij të bekuara. Ai i jepte shumë rëndësi dëgjimit të haditheve fisnike me prehje shpirtërore dhe qetësi. Për këtë arsye, nuk dëgjonte hadith kur ishte në këmbë dhe nuk jepte mësim

hadithi kur ishte në vështirësi, i mërztur apo i pavendosur. Ai kishte shumë frikë nga rënia në gabim për sa i përkiste çështjes së haditheve fisnike.

“Imam Maliku (r.a.), ka thënë: “Kur dikush të fillojë të lavdërojë veten, i bie vlera.”

Imam Maliku, (r.a.), aq sa ishte madhështor, ishte edhe modest në të gjitha sjelljet e tij. Përgjatë mësimit përhapte një qetësi shpirtërore shumë të jashtëzakonshme. Fytyra i shkëlqente qoftë kur jepte fetva në lidhje me çështjet, qoftë kur transmetonte hadithe fisnike nga Pejgamberi.

Një shembull tjetër i pashoq për respektin dhe dashurinë e madhe që kishte Imam Maliku ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), ishte falja dhe bërja hallall hakun e vet një administruesi që i kishte bërë padrejtësi. Ai e fali dhe ia bëri hallall hakun e vet vetëm se ky administrues zullumqar ishte i afërt i Krenarisë së Gjithësisë, të Nderuarit tonë (a.s.).

“MË VJEN TURP!”

Prefekti i Medines kërkoi nga Imam Maliku që të hiqte dorë nga një ixhtihad i tij. Pasi Imami nuk pranoi, ai i bëri padrejtësi duke e lënduar. Kurdo që e lëndonin, Imam Maliku thoshte:

“O Zot! Fali ata, sepse ata nuk dinë.” Më së fundi i ra të fikët dhe u shemb përtokë.

Më vonë kur erdhi në vete, tha:

“Dëshmoni se ua kam bërë hallall hakun tim atyre që më kanë bërë padrejtësi.” Kur kalifi dëgjoi për këtë situatë, shkoi për ta vizituar. Kur i kërkoi ndjesë

dhe i tha se do ta ndëshkonte prefektin, Imami i madh i tha:

“Jo, unë e kam falur atë.”

Kur u pyet për shkakun, u përgjigj:

“Kam turp të padis në Mahsher një person që është nipi i Resulullahut!..”

Imam Maliku, i cili formonte marrëdhënie të mira me kalifët, pas periudhës së kalifëve të drejtë dhe pasi i panë rezultatet trishtuese të ngjarjeve “kijam” për ta arritur përsëri atë pjekuri, e konsideronte si më të dobishme që t’i mbante udhëheqësit në rrugën e drejtë nëpërmjet këshillave. Ai me autoritetin e tij shpirtëror u sugjeronte drejtësinë kalifëve që i drejtoheshin. Në lidhje me këtë vepër nuk mendon-



te për interes as material, as shpirtëror. Qëllim të vetëm kishte vetëm mirëqenien e umetit.

Kështu, kur Harun Rrashidi i tha:

“O Imam! Do t’i shumoj librat e tu dhe do t’i dërgoj në çdo vend. Të gjithë do t’i urdhëroj t’i pasojnë ata dhe të ndjekin medhhebin tënd.”, Imami ia ktheu:

“O kalif! Në hadithin fisnik thuhet:

“Mendimet (e ndryshme shkencore) të dijetarëve të umetit tim janë mëshirë.” Andaj, mendimet e ndryshme të dijetarëve janë mëshirë e Allahut Teala. Secili prej tyre është i udhëzuar. Myslimanët nuk mund të privohen nga kjo mëshirë.” Në këtë mënyrë e bëri kalifin që të hiqte dorë nga vendimi i tij.

“Harun Rrashidi i kërkoi Imam Malikut që çdo ditë të shkronte te shtëpia e tij dhe t’u jepte mësim bijve të tij, Eminit dhe Me’munit. Ndërsa Imam Maliku nuk e pranoi këtë. Kështu që fëmijët shkuan te dijetari.”

Kur Imami i madh i këshillonte kalifët, shfaqte një kujdes të veçantë për të mos i lejuar ata që ta shkelnin fisnikërinë dhe dinjitetin e dijes.

“Imam Maliku (r.a.), priste me orë të tëra nën diell te dera e shtëpisë së njerëzve si Ibn Shihab ez-Zuhri dhe Nafi, i cili ishte skllavi i liruuar i Abdullah ibn Omerit (r.a.), për të bërë një pyetje.”

Harun Rrashidi i kërkoi Imam Malikut që çdo ditë të shkronte te shtëpia e tij dhe t’u jepte mësim bijve të tij, Eminit dhe Me’munit. Imam Maliku i dha kalifit këtë përgjigje shumë domethënëse:

“O kalif! Më e mirë është që fëmijët tuaj të vinë në shtëpinë tonë. Allahu Teala ua shtoftë fisnikërinë! Nëse e nderoni dijen, bëheni të nderuar. Nëse e përçmoni, bëheni të përçmuar. Dija nuk i shkon te këmbët askujt, por njeriu duhet të shkojë te dija.”

Pas këtyre fjalëve kalifi i kërkoi ndjesë Imam Malikut dhe i dërgoi fëmijët e tij për një kohë të caktuar që të merrnin mësim prej Imamit.

Imam Maliku, Allahu e mëshiroftë, e ndjente thellë në zemër seriozitetin dhe përgjegjësinë e dijes. Andaj nuk i jepte përgjigje çdo lloj pyetjeje që i parashtrohej. Disa pyetjeje që i bëheshin u jepte

përgjigje vetëm pasi t’i studionte dhe të meditonte rreth tyre. Një ditë dikush e pyeti për diçka Imam Malikun dhe i tha se çështja për të cilën e kishte pyetur ishte e thjeshtë.

Imam Maliku u nxeh për këtë dhe ia ktheu:

“Është e thjeshtë, ë! Nuk ka diçka të thjeshtë në dije. A nuk e ke dëgjuar ajetin e Allahut Teala i cili thotë:

“Me të vërtetë do të të shpallim një fjalë të rëndë për t’u mbartur.” (Muzemmil, 5) Gjithë dija është e vështirë. Veçanërisht dija për të cilën jemi përgjegjës në ditën e kiametit!”

Madhështia e Imam Malikut buronte nga jeta plot devotshmëri që bënte dhe dija që ua mësonte të

tjerëve. Një ditë kur përsëri ishte pranë kalifit, biri i kalifit u frikësua dhe nuk shkoi dot pranë tyre për shkak të madhësisë së Imamit. Në mexhllisin ku gjendej ai ndjehej një respekt dhe ndikim që nuk e posedonin sulltanët dhe evliatë. Sa bukur e shpjegon madhësitinë e Imam Malikut dhe të fshehtë të kësaj madhësie një poet i cili ishte bashkëkohës i tij:

Ka dinjitet dhe edukatë,
Është fisnik prej devotshmërisë,
Sulltan nuk është, por ama,
Ka madhështi si një Shah (mbret).

Esenca e një pjekurie të tillë sigurisht se ishte edukimi shpirtëror... Atë që nuk e kanë nënvlerësuar të gjithë të mëdhenjtë e Islamit:

EDUKIMI SHPIRTËROR

“Imam Malikut babai i tij i jepte nga një dhuratë për çdo hadith që mësonte përmendësh, në mënyrë që ai të ushtrohej me dijen dhe të merrte frymëzim. Imam Maliku edhe pas shumë vitesh thoshte: “Kur transmetoj një hadith fisnik, akoma ndjej gëzim dhe kënaqësi sikur po marr ndonjë dhuratë të babait.”

Ashtu si imamllarët e tjerë edhe Imam Maliku nuk i pati neglizhuar dijet shpirtërore. Imam Maliku pati marrë dije e mësim nga Xhafer es-Sadiku dhe pati frekuentuar në ligjëratat fetare të atij miku të madh të Allahut. Ai vetë shprehet si më poshtë në



lidhje me Xhafer es-Sadikun:

“Shkoja te Xhafer ibn Muhamedi. Ai ishte shumë i butë dhe kishte një fytyrë të qeshur. Kur përme-ndej në prani të tij Resulullahu (a.s.), i zverdhej fytyra.

Mexhllisin e tij vazhdova ta frekuentoja për një kohë të gjatë. Kurdo që e shihja atë, gjithmonë e gjeja ose duke falur namaz, ose duke agjëruar, ose duke lexuar Kuran. Pa abdest nuk transmetonte hadith. Asnjëherë nuk thoshte fjalë të pakuptimta. Ai ishte prej njerëzve të devotshëm, asketë, adhurues dhe dijetarë. Kur shkoja te ai, e merrte jastëkun në të cilin ishte mbështetur dhe patjetër ma jepte mua.”

“Edhe ne duhet t’i mbledhim si lulet nga siretu’-Nebi (biografia e të Dërguarit të Allahut) metodat e edukimit profetik që ua bëjnë të dashura fëmijëve tanë dijen, adhurimin dhe devotshmërinë dhe t’i praktikojmë në jetë.”

Imam Maliku (r.a.), ia kishte dedikuar jetën Allahut, adhurimit të Tij dhe mësimin të dijes për hir të Tij. Ai duroi çdo lloj vështirësie përgjatë rrugës së marrjes së dijes dhe e shpenzoi çdo gjë që posedonte, madje e shiti edhe shtëpinë. Ai priste me orë të tëra nën diell te dera e njerëzve si Ibn Shihab ez-Zuhri dhe Nafi, i cili ishte skllavi i liruuar i Abdullah ibn Omerit, për të bërë një pyetje. Këta ishin personalitete shumë të mëdha të tabiinëve në shkencat e hadithit dhe jurisprudencës islame.

Kur ishte i vogël, nuk ishte i vetëdijshëm për aftësitë e tij. Andaj lozte me pëllumbat dhe e çonte dëm kohën. Kur babai i tij e kuptoi këtë, i bëri një pyetje Malikut bashkë me vëllain e tij të madh në lidhje me jurisprudencën islame. Vëllai i tij i madh e gjeti përgjigjen, ndërsa Maliku jo. Babai i tij e qortoi duke i thënë:

“Malik, më duket se të çoroditën pëllumbat!” – dhe i hodhi në zemër dashurinë për dijen.

Babai i tij edhe pse nuk ishte një dijetar i madh, por që kuptohet se ishte një edukues i madh i cili u bë shkak për edukimin e një dijetari të madh, i jepte Malikut nga një dhuratë për çdo hadith që mësonte përmendësh, në mënyrë që Maliku të ushtrohej me dijen dhe të merrte frymëzim prej saj. Si një fryt i kësaj praktike të bukur, Imam Maliku edhe pse kishin kaluar vite, thoshte:

“Kur transmetoj ndonjë hadith fisnik akoma ndjej një gëzim dhe kënaqësi sikur po marr dhuratë nga babai.” Edhe në edukimin e këtij dijetari ka shumë shembuj për ne. Ndërkohë që lojërat helmuese dhe tërheqëse të botës po i ftojnë fëmijët tanë me shumë lloj joshjes, nuk është e drejtë të presim që

ata të zgjedhin rrugën e lodhshme të ahiretit pa u bërë asnjë inkurajim, dhuratë dhe orientim. Edhe ne duhet t’i mbledhim si lulet metodat profetike nga biografia e Hz. Pejgamberit dhe pastaj duhet t’i praktikojmë në jetë, sepse ato ua bëjnë të dashur fëmijëve tanë dijen, ibadetin dhe devotshmërinë. Vetëm përpjekjet e tilla do t’i rrisin fëmijët që do të bëhen si Imam Maliku, Sulltan Fatihu e arkitekt Sinani dhe të cilët do të jenë e ardhmja e karvanit të miqve të Allahut.

ME BEGATINË E DEVOTSHMËRISË DHE DIJES...

Imam Maliku, i cili e gdhendi dijen në zemër qoftë ekzoterike apo qoftë ezoterike, qoftë materiale apo qoftë shpirtërore, dhe i cili jetoi me një respekt dhe edukatë të jashtëzakonshme, arriti një pjekuri të tillë që edhe ëndrrat i kishte të mbushura me të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Me një frymëzim dhe përsipirtshmëri të tillë solli në pah veprën e njohur të tij me titull Muvatta’ në të cilën mblodhi hadithet fisnike të të Dërguarit të Allahut (a.s.), jurisprudencën islame të banorëve të Medinetu’l-Munevvera prej sahabëve dhe tabiinëve dhe transmetimet që tregonin për jetën e tyre të devotshme.

“Edhe Imam Maliku ka marrë mësim dhe dije nga Xhafer es-Sadiku dhe ka frekuentuar në mexhllisin e atij miku të madh të Allahut.”

Medhhebi Maliki i cili u formua nga ata që ndiqnin mendimet e Imam Malikut në fushën e jurisprudencës islame, arriti me miliona ndjekës veçanërisht në Afrikë dhe Andaluzi. Në këtë medhheb janë edukuar shumë dijetarë si Imam Karafi.

Sa shembull i bukur që është për ne kjo mirësi e madh e lëmoshës rrjedhëse që Imam Maliku e arriti falë dashurisë dhe respektit të jashtëzakonshëm që kishte ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Allahu i Lartësuar na e mundësoftë që të marrim prej gjendjeve të bekuara të paraardhësve tanë të devotshëm në respekt dhe dashuri ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), ndaj sunetit të tij, ndaj qytetit të tij, ndaj Ravzasë dhe ndaj Mesxhidit (xhamisë) së tij!

Na e mundësoftë të gjithëve që të bëjmë një jetë të mbushur me dije të dobishme, vepra të mira dhe shërbime fetare nën orientimin e sunetit profetik dhe ta japim frymën e fundit me një prehje të plotë shpirtërore duke qenë ithtarë të Islamit!

Amin!..

HZ. JUSUFI ﷺ DHE HZ. MUSA ﷺ -2-

(Një krahasim etno-psikologjik)

— Et'hem Xhebexhiollu —

Ndërsa Jusufi (a.s.), u provua me familjen e tij, Hz. Musai (a.s.), u provua me popullin e tij. Padyshim që sprova më e vështirë është ajo me familjen që njeriu e do shumë, pra me vëllezërit e motrat, prindërit, fëmijët dhe bashkëshorten. Sepse lidhja e dashurisë mes tyre është shumë e fortë. Goditjet nga i afërmi i dashur janë më shkatërruese se ato që vijnë nga dikush i largët.

Në artikullin tonë të mëparshëm, filluam të tregojmë me një metodë krahasuese, duke u nisur nga qendra e detyrës së tyre në Egjipt, për ngjashmëritë dhe dallimet mes Hz. Jusufit (a.s.) dhe Hz. Musait (a.s.). Tani le të vazhdojmë me ngjashmëritë:

- Të dy profetët u martuan në statusin e të qenët të dashuruar nga pala tjetër dhe jo të dashur. Vajzat e Hz. Shuajbit e pëlqyen Hz. Musain (a.s.).¹ Zulejhaja gjithashtu u dashurua plotësisht me Jusufin (a.s.)² dhe e humbi statusin e saj të lartë shoqëror për hir të tij.

1. Shik. Surja Kasas, 26 dhe të tjera.

2. Shik. Jusuf, 30.

- Të dy kanë marrë edukatë të pallatit mbretëror. Me fjalë të tjera, personalitetet e tyre u formësuan si një akumulim me edukimin, mirësjelljen, edukatën dhe protokollin e pallatit mbretëror. Padyshim, përkatësia e tyre në aristokracinë e pallatit mbretëror, u bë shkak që ata të fitonin një përsosmëri të ndryshme në nivelin më të lartë me edukimin e sjelljeve të tilla si finesa, hijeshia dhe delikatesa.³ Fakti që në planin e pasëm të një edukimi të ngjashëm që jepej në Enderunin osman,⁴ si një frymëzim, me shumë mundësi është shembulli i Jusufit (a.s.) dhe Musait (a.s.), i cili luajti një rol të rëndësishëm.

3. Shik. Surja Jusuf, 22; Kasas 9 dhe të tjera.

4. Shik. Ismail Hakki Bajkall, Enderun Mektebi Tarihi, Stamboll 1952.



• Të dy u ndoqën penalisht. Jusufi (a.s.), hyri në burg.⁵ Gjyqi në mungesë që u bë për Musain (a.s.), e bënte të domosdoshme arratisjen e tij nga Egjipti.⁶ Gjyqi u bë emëruesi i përbashkët i të dyve.

• Hz. Musai (a.s.), përjetoi psikologjinë e vrasjes. Hz. Jusufi (a.s.), përjetoi psikologjinë e vrasjes nga të tjerët.⁷ Si reflektojnë vallë vrasja dhe të vrarët nga të tjerët në nënvetëdije? Si formohen aty? Vallë në cilin drejtimi kjo strukturë e karakterit të çon drejt një evolucioni të përsosmërisë?

Është e vështirë për ne që ta vlerësojmë plotësisht këtë. Megjithatë, kjo përvojë e rëndë «vrasjeje» e të dy profetëve para se të bëheshin peygamberë, tregon një situatë shumë të vështirë për ta.⁸

Është e sigurt se kjo përvojë vrasjeje u formësua tek ata si vetëdija e ringjalljes së njerëzve, shpëtimit të tyre dhe leximit të jetës pasi u bënë profetë. Ose më shumë...

Nuk duhet harruar se detyra e çdo profeti është të shpëtojë mbarë njerëzimin duke u shërbyer njerëzve. Është e sigurt se këto përvoja i motivuan ata që t'i gjallëronin njerëzit shpirtërisht, pasi predikimi i fesë është një proces ringjalljeje shpirtërore.⁹

Ndërkohë, duhet mbajtur mend se edhe hoxhallarët i bëjnë nxënësit e tyre të kthehen në parametrat e fabrikës (natyrshmërinë e tyre) dhe e modifikojnë personalitetin e tyre...¹⁰

• Të dy profetët u ndanë nga atdheu i tyre në fund të historive të jetës së tyre dhe vdekja e tyre ishte në të njëjtin vend ku ata shkuan.¹¹ E njëjta gjë ndodhi edhe me Profetin tonë të Nderuar (a.s.).¹² Ai migroi larg nga vendi i Mekës. Në aspektin e jashtëm ky kurbet në këtë botë materiale e të pavlerë, ishte një faktor që ushqente kurbetin shpirtëror, i cili manifestohet si qëndrim i ndarë nga Allahu (xh.xh.), në botën e brendshme. Nuk duhet harruar se kurbeti/mërgimi i jashtëm i pjek njerëzit. Mërgimi ka një rëndësi të madhe në zhvillimin e personalitetit.

• Të dy profetët u dërguan te shoqëri pagane politeiste.

5. Shik. Jusuf, 35.

6. Shik. Kasas, 20.

7. Shik. Jusuf, 15.

8. Shik. Kasas, 16.

9. Shik. Maide, 32.

10. Hatixhe Kybra Tongar, Fitrat Pedagojisi – Pedagogjia e Natyrshmërisë, Libraria Hajj, Stamboll, 2015, fq. 36-7.

11. Harman, "Jusuf", Enciklopedia Islame e Dijanitit Turk, vëll. 44, fq. 3 etj.; "Musa", vëll. 31, fq. 210 etj.

12. Osman Nuri Topbash, Muhamed Mustafai (Sal-lallahu alejhi ve sel-lem), Botimet Erkam, Stamboll 2005, fq. 548 etj.; Shik. Buhari, Megazi, 83.

Ata u përpoqën ta shndërronin politeizmin në tevhid te shoqëritë e tyre. Hz. Jusufi u foli për Allahun (xh.xh.), i cili është një, duke u shprehur: «E erbabun muterrikune hajrun emil-lahu'l-vahidu'l-kahhar?»¹³

Në Egjiptin gjatë epokës së Musait (a.s.), njerëzit kishin devijuar nga rruga e drejtë me besime dhe adhurime¹⁴ të përziera me elemente paganiste si lopët, statujat, etj.

• Ndërsa Jusufi (a.s.), u sprovua me familjen e tij, Hz. Musai (a.s.), u sprovua me popullin e tij. Padyshim që sprova më e vështirë është ajo me familjen që njeriu e do shumë, pra me vëllezërit e motrat, prindërit, fëmijët dhe bashkëshorten. Sepse lidhja e dashurisë mes tyre është shumë e fortë. Goditjet nga i afërmi i dashur janë më shkatërruese se ato që vijnë nga dikush i largët. Prandaj sprova e brendshme e Jusufit (a.s.), nuk ishte më e lehtë se sprovat e jashtëme që Musait (a.s.), i erdhën nga populli i tij. Për këtë arsye, surja Jusuf është emërtuar nga Allahu (xh.sh.), «ahsenu'l-kasas / historia më e bukur».¹⁵

• Babai i Jusufit (a.s.), ishte Peygamberi Jakub (a.s.). Kurse vëllai i tij, Buniamini nuk ishte profet. Tek Musai (a.s.), kjo situatë u shfaq krejt e kundërta. Ndërsa babai i tij nuk ishte peygamber, vëllai i tij, Hz. Haruni (a.s.), ishte peygamber.

Struktura babai peygamber- vëllai peygamber u shfaq në formën e edukimit për Jusufin (a.s.) dhe të ndihmës e mbështetjes¹⁶ për Musain (a.s.). Si përmbledhje, të afërmit e shkallës së parë të të dyve ishin profetë.

• Të dyve ndjenjat e besimit dhe sigurisë iu dëmtoan që në fëmijëri dhe adoleshencë. Me fjalë të tjera, ata e përjetuan psikologjinë e «kërkimit të sigurisë» që në moshë të vogël dhe kjo ishte një përvojë e dhimbshme që i mësoi ata t'i besonin vetëm Allahut (xh.sh.).

• Të dy përjetuan dy tradhti individualisht:

Hz. Jusufi (a.s.)¹⁷ përjetoi tradhtinë e vëllezërve dhe të Zulejhasë,¹⁸ kurse Hz. Musai (a.s.), përjetoi tradhtinë e një çifuti në lidhje me vdekjen e një kopti¹⁹ dhe të Samiriut.²⁰

13. Shik. Jusuf, 39.

14. "O shokët e mi të burgut! A janë më mirë një mori zotash të ndryshëm apo Allahu, i Vetmi, Ngadhënjimtari?"

15. Shik. Jusuf, 3.

16. Shik. Taha, 31.

17. Shik. Jusuf, 15.

18. Shik. Jusuf, 25.

19. Shik. Kasas, 15.

20. Shik. Taha, 97.



• Hz. Musai (a.s.), e pasuroi shpirtin e tij i vetëm në Tur.²¹ Edhe Hz. Jusufi (a.s.), e pasuroi shpirtin e tij²² në fund të pusit të errët.²³ Ata që arrijnë të jenë vetëm për vetëm me Allahun (xh.xh.), i pasurojnë shpirtat e tyre. Pothuajse të gjithë profetët e kanë përjetuar këtë «qëndrim në vetmi» në një farë mënyre.

Edukimi i sufizmit e realizon këtë ligj të natyrshëmrisë përmes edukimit të tarikatit. Kjo, sipas mendimit tonë, tregon se edukimi sufist e ka origjinën nga Kurani, pra posedon një nga argumentet e dorës së parë.

• Fjala Egjipt përmendet 5 herë në Kuran, 2 herë përmendet në lidhje me Jusufin (a.s.): Jusuf 12/21, Jusuf 12/99. 3 herë përmendet në lidhje me Hz. Musain (a.s.): Junus 10/78, Zuhruf 43/51, Bekare 2/61. Fjala Egjipt u përdor në Kuran vetëm nëpërmjet këtyre dy profetëve.

• Kur lindën të dy profetët, u adoptuan nga një nënë tjetër.

Ndërsa Musai (a.s.), u adoptua nga Faraoni dhe bashkëshortja e tij, Asija, Jusufi (a.s.), iu dha hallës së tij kur lindi. Halla e tij u kujdes për Jusufi (a.s.) dhe e rriti derisa ajo vetë vdiq. Kur vdiq, e mori përsëri babai i tij. Pra, fati i dy profetëve ishte i njëjtë: Ndarja nga nëna sapo lindën...²⁴

• Fjala Jusuf rrjedh nga fjala arabe “esef” dhe u quajt “Jusif” ngaqë ndarja e tij shkaktoi pikëllimin e babait të tij dhe “Jusef” për shkak se ishte i trishtuar nga ndarja prej babait.²⁵

Ky trishtim dhe këto vuajtje që përjetoi derisa u ribashkua me të atin, realizuan urtësinë «el-esma

tenzilu mine’s-sema / emrat zbresin nga qielli» ngaqë Hz. Jusufi (a.s.), u quajt «Jusuf».

Është shënuar se emri i Musait (a.s.), përbëhet nga «mu» që do të thotë ujë në hebraisht dhe «sa» që do të thotë pemë, dhe kështu ai u bë Musa. Ai u quajt Musa ngaqë u vendos në një sënduk prej druri në ujë.²⁶ Ose quhej Mosha, që do të thotë i nxjerrë nga uji duke kombinuar fjalët Mo: Su dhe Sha.²⁷

Emri i Hz. Jusufit (a.s.), që kishte lidhje me trishtimin dhe emri i Musait i lidhur me ujin formuan programin e fatit të të dy profetëve.

Derisa Jusufi (a.s.), u ribashkua me të atin, përjetoi vuajtje, telashe dhe sprova.

Hz. Musai (a.s.), u hodh në Nil,²⁸ me Hizrin (a.s.), u takua aty ku bashkohen dy detet,²⁹ bëri udhëtime, çau Detin e Kuq si një mrekulli,³⁰ goditi shkëmbin me shkopin e tij dhe nxori 12 burime,³¹ jeta i ndryshoi pasi mori ujë nga pusi dhe ua dha deleve,³² me pak fjalë, pati një fat interesant të lidhur me ujin. Si përmbledhje, emrat e të dyve u bënë njëkohësisht edhe fatet e tyre.

• Epigjenetikiisht, Hz. Jakubi (a.s.), Hz. Is’haku (a.s.) dhe Hz. Ibrahim (a.s.) emërues të përbashkët patën ndjeshmërinë e tevhidit, në të njëjtën kohë ky është emëruesi i përbashkët edhe i Hz. Jusufit dhe Musait (a.s.). Për shembull, cilado qoftë dëlirësia e Jusufit (a.s.), në pallatin mbretëror, edhe dëlirësia e Hz. Musait ishte në të njëjtin nivel në pallatin mbretëror. Kur Philoni numëron shkencat që mësoi Musai (a.s.), e admiron jetesën e tij si një i ri modest dhe i dëlirë mes pasurive dhe argëtimeve të pallatit mbretëror.³³

vijon...

21. Shik. Surja Taha, 10 dhe të tjera.

22. Ramazanogllu, Mahmud Sami, Hz. Jusufi (a.s.), Botimet Erkam, Stamboll 1984, fq.39-40.

23. Shik. Jusuf, 15.

24. Dilaver Gyner, Füsusu’l-hikem ve Mesnevide Peygamber Öyküleri - Historitë e Pejgamberëve në Füsusu’l-hikem dhe Mesnevi II, Botimet Bashkia Meram. Nr: 2, Konja 2007, fq. 93; Ahmet Xhevdet Pasha, Kisasü’l-Enbiyâ - Historitë e Pejgamberëve, vëll. 1, fq. 8-15. Lindja e Jusufit (a.s.), është viti 1300 para erës sonë. Ai ka lindur në Palestinë. Filloi të jetonte në Egjipt që në moshën 17 vjeçare. Gyner, Historitë e Pejgamberëve II, fq. 93. Hz. Musai u largua nga Egjipti rreth moshës 40-vjeçare. Omer Faruk Harman, “Musa”, Enciklopedia Islame e Dijanetit Turk, vëll. 31, fq. 201-1.

25. Firuzabadi, el-Kamusu’l-muhit, Bejrut 1986, vëll. VI, fq. 6.

26. Mevhub ibn Ahmed el-Xhevaliki, el-Mu’arreb, Dimashk 1990, fq. 567.

27. Harman, “Musa”, Enciklopedia Islame e Dijanetit Turk, vëll. 31, fq. 201, etj.

28. Shik. Surja Kasas, 9 dhe të tjera.

29. Shik. Surja Kehf, 63 dhe të tjera.

30. Shik. Taha, 77.

31. Shik. Bekare, 60.

32. Shik. Kasas, 27.

33. Harman, “Musa”, Enciklopedia Islame e Dijanetit Turk, vëll. 31, fq. 208.

O Allah, na preokupo me adhurimin ndaj Teje

— Sadik Dana —

O Allah! Na bëj rrësk të kemi sjellje të mirë dhe edukatë qoftë kundrejt Teje, qoftë kundrejt robërve të zgjedhur të Tu! Mos na bëj prej atyre që kaplohen nga sprova e besimit në vetvete duke u mbështetur te shkaqet! Na bëj të qëndrueshëm në tevhid dhe mbështetje ndaj Teje! Na bëj të mjaftohemi me Ty dhe t'i shfaqim nevojat vetëm ndaj Teje! Mos na sprovo me fjalët dhe me veprat tona! Mos na ndëshko për shkak të tyre dhe na trajto me mirësinë e bujarinë Tënde, duke hequr dorë nga dënimin dhe duke na toleruar!


O Allah! O Krijues i të gjitha qenieve! O krijuesi i shkaqeve! Na shpëto nga njohja e qenieve dhe shkaqeve si ortak me Ty. O Zot! Mos na bëj as ne, as atë që kërkon lutje të kemi nevojë për askënd përveç Teje! Vetëm për Ty le të kemi nevojë. Le të mjaftohemi me Ty dhe vetëm Ty le të të përmendim. Le të të kërkojmë vetëm prej Teje.

O Allah! Na zgjo nga gjumi i shkujesjes. Na bëj të përfitojmë nga njëri-tjetri. Në mënyrë që nefset tona të rregullohen. Tregojua nefseve tona rrugën që vjen te Ti, në mënyrë që pjesën e jetës sonë që na ka mbetur ta kalojmë me preokupim në rrugën Tënde.

O Allah! Na shpëto nga shkatërrimi. Prej Teje kërkojmë vetëm afrimitetin me Ty. Kërkojmë të të shohim vetëm Ty edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër, në këtë botë me zemrat tona dhe në botën tjetër me sytë tanë.

O Allah! Drejtoji të gjithë njerëzit te dera Jote. Gjithçka të përket Ty, gjithçka është e Jotja. O Allah! Dërgoji salavate dhe selame Muhamedit, (a.s.) dhe pasardhësve të tij. Mbroje umetin Islam. Lidhni zemrat e tyre në bisedën për bamirësi. Le të jenë të bashkuar në vepra të mira. Largoje të keqen e njëri-tjetrit nga njëri-tjetri, në mënyrë që të mos e dëmtojnë njëri-tjetrin.

O Allah! Ti i njej zemrat tona. Andaj rregulloji ato. Ti i di nevojat tona, andaj na i plotëso ato. Ti i di mëkatet tona, andaj na i fal ato. Ti i di të metat dhe gabimet tona, andaj na i mbulo ato... O Allah! Mos i ekspozoj veprat tona të këqija. Mos i gris perdet që



mbulojnë mëkatet tona. Mos na ndëshko për shkak të veprave tona të këqija. Mos na lër në shkujesje. Mos na dëno për neglizhencën dhe mosbindjen.

O Zot! Mos na ndëshko nëse harrojmë ose gabojmë.

O Zot! Mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu siç u ngarkove atyre që ishin para nesh.

O Zoti ynë! Mos na bëj të mbajmë atë që nuk kemi fuqi ta mbajmë. Na i fal mëkatet që i bëjmë, na fal ne. Ki mëshirë për ne. Ti je Zoti ynë. Na ndihmo kundër popujve jobesimtarë.

O Allah! Na kthe ne tek ne. Na bëj të qëndrojmë në derën Tënde. O Allah! Na bëj për Ty, te Ti dhe me Ty. Na ndero me shërbimin ndaj Teje. Le të jetë vetëm për Ty edhe ajo që marrim, edhe ajo që japim. Na pastro botën tonë të brendshme nga të qenët një vend për dashurinë e dikujt tjetër përveç Teje.

Na shpëto nga duart e nefseve tona! Na shpëto dhe na dërgo tek Ti. Le të jenë të gjitha veprat dhe veprimet tona vetëm për Ty. Le të besojmë vetëm tek Ty, le të mbështetemi vetëm tek Ti. Na zgjo nga mjerimi i të qenët i shkujesur ndaj Teje. Na vish me rrobat e bindjes, adhurimit dhe përgjërimit ndaj Teje. Bëji zemrat dhe shpirtrat tanë ta shijojnë kënaqësinë e afrimitetit me Ty.

O Zoti ynë që je Një! Na bëj nga ata që të njësojnë Ty! Na shpëto nga ata që na pengojnë të ndjekim rrugën Tënde. Na bëj nga ata që janë zgjedhur për Ty! Rregulloji pretendimet tona me provat e mirësisë dhe mëshirës Tënde.

Na i pastro zemrat. Bëji punët tona të lehta dhe të kollajshme. Na bëj të kemi miqësi vetëm me Ty. Na mbroj nga formimi i miqësisë me dikë tjetër përveç Teje. Bëji të gjitha shqetësimet tona një shqetësim! Edhe ky shqetësim le të jetë afrimiteti me Ty. Të mos kemi shqetësim tjetër përveç mendimit për të qenë afër Teje në dynja dhe ahiret! Amin!



MODELI I AISHES DHE UMMU SHERIK në predikimin e Islamit

— Shefika K. Meriç —

H. Ebu Musa, radijallahu anhu, tregon:

“Kur ne sahabëve të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), na shfaqej ndonjë problem në lidhje me ndonjë hadith, menjëherë pyesnim Aishen. Ajo patjetër na jepte të dhëna mbi atë çështje.” (Tirmidhi, Menakib, 3877.)

Një nga detyrat më të rëndësishme që Allahu i ka vënë besimtarit në ndërtimin e njeriut në Islam, është edhe predikimi. Predikimi është të shprehurit e Islamit nga besimtari me anë të gjendjes, qëndrimit, pasurisë dhe gjuhës në çdo kohë dhe në çdo vend; po ashtu është të njoftuarit e njerëzve mbi ndjeshmërinë e Islamit.

Islami kërkon nga besimtarët të jetojnë një jetë me vetëdije dhe nder. Rruga e fitimit të këtij nderi kalon nga shprehja Kuranore **“emr-i bi'l-ma'ruf, nehy-i ani'l-munker”**, pra urdhërimi për mirë dhe ndalimi nga e keqja.

Ashtu si dija që është farz për çdo mysliman qoftë burrë apo grua, edhe predikimi është farz për çdo mysliman. Të gjithë burrat dhe gratë myslimane janë përgjegjës për transmetimin e Islamit edhe te brezat e ardhshëm. Ajetet Kuranore me përmbajtje predikimin që Allahu Teala i dërgoi

Pejgamberit, (a.s.), në të njëjtën kohë janë një thirrje edhe për ne.

Disa nga këto ajete fisnike janë në këtë mënyrë:

“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve. Natyrisht që Allahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë.” (Maide, 67)

“Unë kam për detyrë veç t'ju përcjell atë që më vjen nga Allahu dhe mesazhet e Tij. Këdo që s'dëgjon Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e pret zjarri i Xhehenemit në të cilin do të mbetet përgjithmonë.” (Xhinn, 23)

“Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit! Kujdes! Nëse nuk ia vini veshin, ta dini se i Dërguari ka për detyrë vetëm të përçojë shpalljen e qartë.” (Maide, 92)

Aq sa merrnin detyra burrat sahabë përreth të Dërguarit të Allahut, (a.s.), për të predikuar Islam, po aq merrnin edhe gratë sahabe. Secila prej tyre pothuajse garonte me të tjerat për të mësuar e përhapur ajetet fisnike të reja që zbrisnin nga Allahu Teala dhe hadithet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Veçanërisht bashkëshortet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ndanin me njerëzit çdo çështje që shikonin, dëgjonin dhe mësonin nga Ai (s.a.s.), duke filluar nga gjendjet e veçanta të Tij e deri te dispozitat më të përgjithshme të Islamit. Aishja, (r.a.), kishte një vend shumë të veçantë ndërmjet tyre. Ajo u edukua në mënyrë të veçantë nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), ngaqë ishte më e reja prej bashkëshorteve të Tij dhe ngaqë ishte kureshtarë dhe e aftë për dijen. Aishja, (r.a.), pothuajse ishte “nëna mësuese” e të gjithë umetit burra-gra kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), ishte gjallë, por edhe pas vdekjes së Tij.

Nëna jonë, Aishja është një nga shtatë personat që kanë transmetuar më shumë hadithe. Kjo e shpreh qartë rolin e saj në predikimin e Islamit.

Këto të dhëna, tani le t'i konkretizojmë pak më shumë me një/dy shembuj:

Në aktivitetin e predikimit të Islamit, ka dy zona sahabe që prijnë para të tjerave. Njëra është nëna jonë Aishja, (r.a.) dhe tjetra është Ummu Sherik, (r.a.). Këto dy zonja sahabe zënë vende të ndryshme si “predikuese” në jetën e veçantë të të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem. Detyra që kryen ato në përhapjen e Islamit, përbën një rekord mësimdhënës për ne...

Krahas zgjuarsisë së madhe, aftësisë, intuitës dhe diturisë së nënës sonë Aishes, (r.a.), aktivitetet që realizoi për përhapjen e Islamit, janë kallauzë ndriçues në çështjen e predikimit të Islamit për myslimanët e sotëm. Bindja absolute që tregoi kundrejt ligjeve të Allahut Teala dhe ndaj Pejgamberit, (a.s.), kur shfaqte këtë përpjekje të sinqertë në rrugën e Allahut, është një argument i qartë për bindjen që nëna jonë, Aishja, (r.a.), kishte ndaj Zotit (xh.xh.) dhe ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Edukimi që Aishja mori nga babai i saj Siddiki Ekber, Ebu Bekri, radijallahu anhu, që në moshë të vogël dhe martesë me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), u bënë shkak për zhvillimin, pjekjen dhe thellimin më të madh të saj në aspektin moral e shkencor. Nëna jonë Aishja, (r.a.), e cila u bë myslimane që në moshë shumë të vogël, në të njëjtën kohë u bë shembull për të gjithë myslimanët me modestinë, mjaftueshmërinë ndaj asaj që i kishte dhënë Zoti dhe bujarinë e saj. Për shkak të besimit të pastër dhe sinqeritetit, gjëja më e rëndësishme për të ishte veprimi në përputhje me kënaqësinë e Allahut të Madhëruar.

Pasi i Dërguari i Allahut, (a.s.), ndërroi jetë, shtëpia e nënës sonë Aishes u bë një qendër shkencore në të cilën vinin shumë njerëz të më-

dhenj e të vegjël. Qoftë në çështjet që kanë të bëjnë me gratë apo qoftë me çështjet në lidhje me thellësitë juridike të haditheve dhe ajeteve fisnike, ajo u bë një burim i rëndësishëm dijeje nga e cila përfitonin edhe halifet si Umeri, radijallahu anhu. Ngaqë ajo ishte njëra prej “nënave të besimtarëve”, të gjithë myslimanët burra-gra shkonin te ajo për të zgjidhur problemet dhe i pranonin pa asnjë hezitim mënyrat e zgjidhjeve që u ajo u jepte.

Aishja, (r.a.), që u interesua nga shumë afër me edukimin e grave duke filluar që në kohën e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), me veten e saj dhe me nxënësit që edukoi, tregoi suksesin dhe rëndësinë e të preokupuarit me dije të grave në botën Islame.

Edhe Ummu Sherik, (r.a.), që e pranoi si detyrë predikimin e Islamit, ishte njëra prej grave sahabe që i udhëzoi gratë e Kurejshve duke shkuar shtëpi më shtëpi. Mushrikët (politeistët) u shqetësuan



nga këto aktivitete të Hazretit Ummu Sherik dhe së pari e kërcënuan.

Ata e lanë tre ditë pa ushqim dhe pa ujë në rërën e nxehtë të shkretëtirës, por edhe këto tortura, nuk ia shuan dot dashurinë për të predikuar fenë.

Ato ditë myslimanët patën filluar të shpërngulen për në Medine fshehurazi me lejen e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), sepse ishin lodhur nga torturat në Mekë. Edhe Ummu Sheriku, (r.a.), tashmë dëshironte të shpëtonte nga presionet e politeistëve Mekas dhe ta jetonte e përhapte më lehtë fenë e Allahut Teala. Ajo nuk gjeti asnjë që shkonte në Medine, për këtë arsye, u bashkua me një familje çifute. Si shpërblim i durimit dhe vendosmërisë që kishte në besim, arriti nderimin e veçantë të Allahut (xh.xh.). Ngjarja ndodhi kështu: Ummu Sherikut, (r.a.), i mbaroi uji. Çifuti e përdori këtë rast dhe i tha se s'do t'i jepte ujë përderisa të mos kthehej nga feja e saj. Edhe gruan e tij e urdhëroi në mënyrë të prerë që të mos e bënte diçka të tillë.

Koha ishte shumë e nxehtë. Udhëtimi po kalonte me shumë vështirësi. Ummu Sherik, (r.a.), ishte këputur. Fuqia i ishte prerë për shkak të etjes. Ecte dhe fliste me vështirësi. Gjendja e dobët e saj i dha shpresë çifutit. Ai mendoi se kishte kapur çastin e duhur dhe pandehi se ajo nuk kishte zgjidhje tjetër përveçse të kthehej nga feja, por Ummu Sheriku kishte një besim shumë të fortë.

Në një gjysmë nate ku dukej sikur kishin mbaruar mundësitë materiale, arriti ndihma e veçantë e Allahut Teala. Në një moment kur të gjithë po flinin, Ummu Sherik ndjeu mbi kraharorin e saj sikur iu vendos ujë. Ajo piu nga ky ujë derisa u ngop. Mbi të gjithë lagu edhe kokën dhe u freskua. Pastaj u thirri shokëve të rrugës për t'i zgjuar. Nga zëri i saj i fuqishëm, kuptohej se ajo kishte gjetur ujë dhe kishte pirë.

Çifuti pandehi se ujin ia kishte dhënë gruaja e tij, për këtë arsye, iu nxehtë, i bërtiti dhe i tha i zemëruar:

“Ti ia dhe ujin?”

Ummu Sherik, (r.a.), ndërhyri dhe i tha se kjo ishte një mrekulli nga Allahu Teala dhe se gruaja e tij nuk i kishte dhënë asnjë pikë ujë. Çifuti menjëherë shkoi te lëkurat e ujit. Ai u habit kur pa se ato ishin të lidhura.

Sinqeriteti dhe besimi i pastër i Ummu Sherikut, (r.a.), ndikoi shumë te ai. Fjalët e saj formuan një ngrohtësi në zemrën e tij. Zemra iu hap ndaj dritës së Islamit dhe tha:

“I besova Zotit tënd.”

Bashkë me familjen e tij u bënë myslimanë duke thënë shehadetin së bashku.

Të predikosh Islamit në kohët më të vështira dhe të paguash kundërvlerë për këtë, është një sakrificë që nuk mund ta bëjë çdo njeri. Nënaton, Hatixhe, Fatimja, Aishja dhe gratë e tjera sahabije, zunë vend në historinë islame si heroina shpirtërore. Edhe sot, çdo grua besimtare, duhet të përpiqet për ta valëvitur flamurin e predikimit që ka marrë prej atyre. Për një njeri që në zemër ka këtë dashuri, nuk ka shumë rëndësi koha dhe vendi. Çdo vend dhe çdo kohë ku gjenden njerëz, është një mundësi për të përhapur fenë e Allahut Teala.

Allahu i Madhëruar mos na ndaftë nga shërbiimi në rrugë të Tij! Zoti na tuboftë në Kiamet me robër prej të cilëve është i kënaqur dhe na bëftë prej atyre që marrin shembull prej sakrificave të Aishes dhe Ummu Sherikut! Amin!..





Aventura martesore

— Esin A. Tyxhar —

Martesa... Bashkimi i dy botëve të ndryshme... Që kur u shfaq ekzistenca njerëzore, që nga Hz. Ademi dhe Hz. Havaja, ajo është aventura e një burri dhe një gruaje që dalin nga vetmia dhe bëhen “ne” (bashkohen)...

Dy njerëz të ndryshëm bashkohen me një emocion e shpresë të madhe dhe me shumë ndjenja të tjera të bukura që nuk kanë emër. Jetesa familjare që prehet, dëshirohet dhe shpresohet nga zemrat me entuziazmin që japin ndjenjat, falin një emocion të madh. Në këtë mënyrë, realizohet martesa.

Martesa është një jetë e re, është shpresë dhe është gjëja e duhur. Është dashuri për njeriun e ngelur në vetmi, është gëzim dhe për më tepër, është ngjyrë që i shtohet jetës. Të gjithë e bëjnë martesën duke e shpresuar atë të ngjashme me imagjinatat e lumturisë...

Por ky institucion shprese dhe mirësie, nganjëherë mund të mos jetë siç imagjinohet dhe siç mund të shpresohet. Imagjinatat, më shumë janë gjëra që përjetohe nëpër zemra. Nëse kalohen në jetë, bëhen ideale. Nëse përjetohe vazhdimisht, bëhen të mrekullueshme.

Por kufizimi i botës moderne dhe ato që duhet të ndodhin për shkak të syzeve që media u ka vendosur të gjithëve, ato që mund të ndodhin dhe ato që dëshirohen nga martesa, janë ngatërruar me njëra-tjetrën...

Martesat nëpër telenovela që nuk i kanë ndodhur askujt, që nuk shtjellojnë jetën dhe që nuk janë afatgjata, shtojnë dëshpërimin. Ato përjetojnë ndjenjën: “Më duket se ka problem vetëm në martesën tonë!” Divorcet e shtjelluara shumë dhe përforcimi i tyre në jetë po me anën e medias, mund t’ua shkurtojë jetën martesave.

Institucioni i martesës, si në çdo vend të botës, edhe në vendin tonë po kalon një periudhë shumë problematike. Statistikat e divorceve kanë treguar se në dhjetë vitet e fundit divorcet janë shtuar në mënyrë të ndjeshme, madje është konkluduar se një në çdo dy martesa përfundon me divorc.

Individi i suksesshëm rritet vetëm në një mjedis të shëndetshëm familjar. Familja e shëndetshme mund të bëhet vetëm në mjedise ku martesat janë të lumtura. Nëse dëshirojmë që shoqëria në të cilën jetojmë, të jetojë në mirësi, duhet të studiojmë me të gjitha detajet mjediset e familjeve në të cilat është pakësuar durimi në martesë ku bashkëshortët nuk e durojnë dot njëri-tjetrin, është shtuar zemërimi, sundon dëshpërimi e brenga. Pikat në të cilat përjetohe më shumë këto, duhet të ndriçohen sa të jetë e mundshme.

Aventura për t’u bërë “Ne” ndërkohë që ishëm “Unë”

Sigurisht që askush nuk martohet duke menduar: “Nesër do të përballim me këto probleme!”



Askush nuk dëshiron që të mos jetë i lumtur. Por aventura për t'u bërë "ne", ndërkohë që ishim "unë", ka shqetësimet e saj si çdo fillim. Çështje fare të papritura dhe detaje të parëndësishme ndodhin përballë çiftit të ri si një bombë më vete.

Fejesa, nishani, të afërmit, kërkesat, ceremonitë ndërmjet atyre që "duhet të bëhen" dhe atyre që "mund të bëhen", janë sprovat e para të çiftit të ri. Shtrimi i shtëpisë, zgjedhja e mobilieve, kursimet, allishverishet, dhuratat... Ato që pëlqehen, ato që merren pa u pëlqyer, çastet në të cilat heshtet për shkak se është turp, debatet disa ditore pa nijet të keq, fjalët që thonë apo nuk thonë personat e tretë, apo fjalitë e lëndimit që fillojnë me "Mua deshi të më thoshte..."...

Në këtë mënyrë, një burrë dhe një grua, e mbajnë shpresën gjallë dhe hyjnë në shtëpinë e dynjasë me shpresat që përjetojnë në mendjen e tyre duke i kapërcyer rastet e rrezikshme që mund të shfaqen.

Ajo që tashmë ka filluar të përjetohet është një jetë e re e të rinjtë që kanë jetuar me familjet e tyre para martesës dhe që i kanë ndarë me to shumë përgjegjësi, që më parë nuk e kanë pandehur, ose më saktë e kanë ditur por nuk kanë pasur aspak përvojë nga ajo...

Veçanërisht për gruan, sjelljet që ka shfaqur më parë dhe për të cilat është lavdëruar, duartrokitur dhe mirëpritur nga të tjerët, tashmë janë bërë detyra dhe çështje të obliguara. Çdo ditë është e detyrueshme që shtëpia të jetë e pastër, e rregullt dhe ushqimet të jenë gati.

Këto janë gjëra që nganjëherë mund të kryhen lehtë për gratë e sapomartuara. Ndërsa nganjëherë shfaqet nevoja për të pyetur nënat: "A i hidhej qepë supës së thjerrzës? Cila markë ishte më e mirë për maja? Sa pika limoni duheshin për ta mbajtur të freskët pilafin?" Gjithmonë ka pyetje për t'u pyetur. Edhe nënat i kanë të gjitha përgjigjet... Nënat që mund të arrihen gjithmonë me telefon. Në këtë mënyrë vazhdon trafiku i telefonit.

Por ky trafik telefoni, gjithmonë nuk mund të japë rezultate pozitive për të rinjtë që përpiqen të bëhen "ne" duke formuar një vatër të re. Pastaj është e vështirë të vendoset se sa duhet të mbështeten të rinjtë që akoma nuk janë rritur në sy të prindërve! Pak apo më shumë? Apo duhet një mbështetje e vazhdueshme dhe e pa ndërprerë? Kjo, nganjëherë duke mos u kuptuar, kthehet në mendimin e "mbështetjes së vazhdueshme".

Mbështetjet e përzemërta

Të rinjve që po përpiqen të bëhen "bashkëshortë" në një vatër që po formohet, u jepet "mbështetja e përzemërt" e nënës, babait, vjehrrës, vjehrrit, kunatës, hallës, dajës dhe tezes. Mbështetja është një fuqi shumë e vlefshme ashtu siç edhe quhet. Por ajo është e nevojshme nëse duhet. Përndryshe është një fuqi e çuar dëm dhe një israf. Ajo është edhe "barrë" nëse nuk ka nevojë. Të "vërtetat" që secili i ka nxjerrë nga eksperiencat e tij, mundohet t'ia mësojë nuses dhe dhëndrit të ri. Ata dëshirojnë t'i bëjnë të përfitojnë nga përvojat e tyre në mënyrë që t'i ndalojnë nga rënia në të njëjtat gabime.

Në fakt nuk ekziston vetëm një e vërtetë në lidhjet dhe martesat ndërmjet njerëzve. Nuk duhet të harrohet se "çdo martesë është e veçantë" dhe karakteri i çdo familjeje është i ndryshëm. Martesat ngjajnë me njëra-tjetrën, por nuk mund të jenë të njëjta. Edhe pse të gjithë njerëzit mund të kenë anë të njëjta, ata posedojnë karaktere, kapacitete, zakone dhe veçori krejt të ndryshme personale. Martesat janë të veçanta. Ndërsa këshillat janë të rëndësishme dhe udhërrëfyese.

Nëse këshilluesi nuk është këmbëngulës, u jep mundësi të rinjve të lidhin martesën dhe të zbulojnë karakterin e njëri-tjetrit, përndryshe kaosi vazhdon. Të gjitha këshillat dhe ndarjet e përvojave të të afërmeve që fillojnë me "qëllimin e mirë", për shkak të injorancës, e kalojnë ekstremin e dashurisë duke u kthyer në një "kor me shumë zëra". Në këtë kor të gjithë përsërisin me zë të lartë përvojat që kanë kaluar përgjatë viteve. Çifti që ka marrë rrugën për t'u bërë "ne", nën këtë zhurmë të thatë nuk mund ta dëgjojnë zërin e njëri-tjetrit. Këtë zhurmë mund ta quajmë "Kori i Fëmijëve".

Kori i Fëmijëve

Deri në pesë-dhjetë vitet e fundit kryetarja e "Korit të Fëmijëve" zakonisht ishte nëna e djalit. Vjehrrat haptas ose në mënyrë të fshehtë janë sunduese të forta në formimin e këtij ekuilibri të ri. Ato kanë gjithmonë fjalë për të thënë dhe mbështetje për të dhënë në ekuilibrin brenda shtëpisë si p.sh: "Djali im është shumë i rregullt, djali im nuk i ha kurrë bamjet, djali im fle pak kur kthehet nga puna."

Këtu qëllimi është i mirë: "Të mos humbin kohë; të tregoj që ata të mos mundohen shumë për të njohur njëri-tjetrin. Të rinjtë të kalojnë mirë dhe të mos grinden."



Por në vatrën e re familjare, çifteve nuk u jepet rasti për t'i treguar veten njëri-tjetrit. Në fakt aty ekziston mesazhi: “Ju jeni akoma të vegjël, nuk jeni rritur ende! Prandaj nuk mund të jetoni pa praninë tonë!” Ndërkohë fjala që thuhet më shumë është: “Të jenë mirë në follenë e tyre!”

Por nga foleja akoma dëgjohe zëri i lartë i korit. Sa keq që të rinjtë brenda këtij kallaballëku i thonë ato që dinë me zë shumë të lartë “duke bërtitur”, kruajnë veshët ose kaplohen nga një heshtje e madhe.

Pavarësisht këtij kori të zhurmshëm, ka edhe shumë martesë që vazhdojnë pa u ndarë. Nëse ky kor i madh në këto shtëpi ka arritur përputhshmërinë dhe harmoninë, domethënë, e ka arritur ekuilibrin, zëri shumëgjyresh “i korit të fëmijëve” e vazhdon ekzistencën me strukturën e tij të zhurmshme si një kor “jo qetësues” por “që bën detyrën e tij” për atë që këndon dhe për atë që dëgjon.

Nëse të tjerët heshtin ose e ulin zërin kur flet ndonjëri i kësaj strukture të zëshme, formohet një ekuilibër i brendshëm. Për shembull, nëse nusja hesht kur flet vjehrra, nëse dhëndri dëgjon kur flet nusja, nëse nusja nuk nxehet dhe nuk ankohet kur flet kunata, ky kor e gjen ekuilibrin e tij dhe episodi vazhdon. Sigurisht që të jetosh këto që thuhet, dihet që nuk janë aq të lehta sa të thuhet apo të shkruhen. Çdo ditë e shikojmë se ky ekuilibër merr vite dhe formohet duke e përjetuar dhe provuar. Derisa të formohet ky ekuilibër, thyhen shumë zemra, derdhen shumë lot dhe kalojnë shumë vite.

Marrëdhëniet ndërmjet njerëzve kërkojnë durim dhe përpjekje. Kërkojnë mundësinë e diskutimit të dëshirave reciproke dhe ndryshimit. Kërkojnë qëllim të mirë dhe virtyt. Kërkojnë perceptimin e shpresave që imagjinohen dhe që përjetojnë në

zemra. Kur njerëzit të kuptojnë shpresat e tyre dhe t'ua bëjnë të qartë bashkëbiseduesve, zhvillohet “të kuptuarit e njëri-tjetrit. Në të kundërt fillojnë “grindjet”.

Grindja dhe ndryshimi

Kordoni e shpreh grindjen si “çasti kur del në pah e vërteta në lidhje”. Grindja ndodhet dhe duhet të ndodhet në strukturën e çdo martesë. Grindja nuk duhet të zhduket, por duhet të administrohet. Bashkimi i dy botëve të ndryshme është një grindje në vetvete. Por kjo grindje është një grindje që mund të shndërrohet në kompromis. Nëse ka kompromis, do të thotë se ka një martesë të lumtur. Nëse nuk ka, grindja ekzistuese kthehet në burim debati, kthehet në zënkë e zhurmë, kthehet në pikëllim dhe humbje.

Me kalimin e kohës, grindjet në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve mund t'i shtjellojmë në vete. Çdokush pret nga tjetri ato që duhet t'i ketë vetë. Shumica dërmuese e çifteve që kanë probleme familjare, aplikojnë për terapi duke thënë:

“I nderuar specialist! Unë kam halle..., por gruaja nuk më kupton. Si mund ta ndryshoj atë?!”

Asnjë fuqi dhe asnjë specialist i suksesshëm, nuk mund ta realizojë ndryshimin nëse nuk duan individët. Ndryshimi ndodhet në botën e brendshme të njeriut dhe është i lidhur me vullnetin e tij. Gruaja burrin dhe burri gruan e tij, në asnjë mënyrë nuk mund ta ndryshojë me imponim. Nëse ndryshimi bëhet me imponim, atëherë shfaqet dhuna. Me kalimin e kohës, ndoshta mund të “bindet”, por kjo bindje ushqehet me “zemërim” dhe “urrejtje” sapo t'i jepet shansi ngaqë nuk është mbështetur nga vullneti. Nisur nga kjo, ajo e tregon veten me një sjellje tjetër reaguese sapo t'i jepet shansi dhe shpesh herë shfaqet një gjendje patologjike e sëmure.

Nëse ndryshimi bëhet me dëshirë, shndërrohet jo në zënkë, por në paqe, jo në zemërim, por në dashuri, jo në urrejtje, por në tolerancë. Në shtëpi të tilla ka dashuri dhe mirëkuptim. Shtëpitë në të cilat ka dashuri, e rrisin me dashuri brezin e ri, u japin shpresë për të ardhmen dhe i rregullojnë problemet duke i diskutuar në vend që të sillen sikur nuk ka. Me durim dhe me shpresë...

Ndryshimi bëhet me vullnet dhe ushqehet me sakrificë. Njeriu duhet ta njohë veten, kufij të dhe ato që (nuk) duhet t'i bëjë dhe vetëm me një aventurë të tillë duhet të bëhet "ne". Përndryshe, ai që merr përsipër edhe përgjegjësitë që i përkasin palës tjetër dhe e bën këtë me njet të mirë, do të thotë se "i ka marrë përsipër rolet që priten nga pala e kundërt dhe i ka bërë me një dëshirë të madhe". Ndërsa kjo, të gjitha punët që më parë bëheshin me dëshirë, i kthen në një barrë të përballueshme dhe në një burim dëshpërimi i cili nuk ka emër.

Një detaj dhe pika e këputjes

Detyrat që nuk janë caktuar që në fillim dhe që nuk janë ndarë në mënyrë të barabartë, shpresat dhe të gjitha çështjet që nuk janë diskutuar, nënvlerësohen duke thënë: "Sidoqoftë e gjejnë vendin e tyre me kalimin e kohës!" Por çdo çështje e neglizhuar, rritet me kalimin e kohës dhe kthehet në ortek gjigant nën të cilin mund të mbetesh pa e kuptuar edhe se çfarë është. Çdo gjëje i humb kuptimi, bëhet aq e vogël sa që nuk mund të diskutohet edhe me ato që të rrethojnë dhe këputet me një detaj të parëndësishëm. Ai detaj është detaj ashtu siç edhe quhet. Por ai detaj i vogël mund të jetë ngjarja e fundit që mund të shpie në këputjen e lidhjes dhe pika e fundit që e mbush kupën. Të gjithë thonë diçka dhe komentojnë në lidhje me këtë ngjarje të fundit, japin mendime dhe këshillojnë. Ndërsa çiftet që nuk e kanë gjetur veten dhe që nuk e kanë kuptuar martesën, shpesh herë heshtin, zemërohen ose flasin shumë dhe ankohen gjithmonë. Atëherë, dy njerëzit që përpiqeshin për të qenë "ne", bëhen dy njerëz të ndarë, madje dy të huaj.

Gabimi më i madh në këtë periudhë është të folurit "rreth ngjarjes që ishte shkak për ndarjen". Shpesh herë ky proces është shumë rraskapitës... Këtu ka një pikë që kalohet: Ajo ngjarje është vetëm maja e dukshme e ajsbergut. Nën ujë ndodhet një ajsberg shumë i madh i cili nuk mund të imagjinohet. Ky ajsberg është formuar me akumulimin e gjërave të vogla.



Përfundim

Sipas statistikave të institucionit mbi studimet familjare, në çdo dy martesë, ka një divorc. Dome thënë, zemrat e bashkuara me shpresë, e humbin qetësinë, mbruhet me zemërim dhe përfundojnë në urrejtje. Kjo nxjerr në pah "ushtrinë madhështore të të zemëruarve" duke marrë pranë nxehjet dhe lëndimet. Këtyre familjeve të dëshpëruara u shtohen më së paku dy veta.

Sipas Jacobsonit dhe Christensen, "shqetësimi brenda familjes" përkufizohet si vështirësia që përjetojnë bashkëshortët në komunikim dhe në çështjen e zgjidhjes së problemeve, problem që krijohet prej jetesës së përbashkët dhe vështirësia për të pranuar ndryshimin e njëri-tjetrit.

Yelsma është shprehur se shqetësimet ndërmjet bashkëshortëve në martesë, "janë shprehje verbale që kanë lidhje me raportin verbal, paafësinë për të debatuar, sulmin verbal të tepërt të njërit prej bashkëshortëve kur tjetri sulmon më pak verbalisht, me masën se sa i pranon njëri prej bashkëshortëve shprehjet verbale negative të bashkëshortit tjetër sulmues dhe me sa hidhen pas shpine këto sjellje".

Martesa e lumtur dhe e qetë, para së gjithash, realizohet me një "komunikim të shëndoshë". Aq sa është e rëndësishme që shprehjet e komunikimit të përdoren në mënyrë dhe kohë të saktë, po aq është e rëndësishme edhe aftësia e palës së ku-



ndërt (bashkëbiseduesit) për të kuptuar. Mesazhi që dërgohet me një gjuhë teknike, së pari duhet të shikohet nga pala e kundërt, pastaj të përvetësohet dhe më në fund të lexohet. Ç'e do se edhe gjuha e të lexuarit, është shumë e rëndësishme. Në këto shprehje nuk duhet të përdoren shkurtime dhe nuk duhet të neglizhohet asgjë duke menduar se do të kuptohet.

Një shembull

Tani ejani dhe të ndjekim një film:

Kur burri vjen në shtëpi në mbrëmje, gruaja vazhdon të bëjë punët që ka në kuzhinë. Ajo është lodhur shumë gjatë gjithë ditës me punët e shtëpisë dhe fëmijët. Për shkak të punëve të shumta të bashkëshortit, nuk kanë pasur mundësi të marrin pjesë në shëtitjen e fundjavës së të birit që shkon në shkollë. Djali është mërzhitur për shkak se kanë shkuar të gjithë shokët e tij dhe që nga ajo ditë, vazhdimisht sillet keq. Edhe pak më parë e rrahu vëllain e vogël megjithëse nuk i kishte bërë asgjë. Vëllai i vogël dëshiron ta bëjë përpara syve të të tjerëve më të dhimbshme sjelljen e padrejtë që i bëri vëllai i madh dhe qan duke bërë titur edhe pse nuk e ka vrarë aq shumë. Një kaos i vërtetë...

Punët nuk kanë mbaruar akoma. Gruaja po përgatit tryezën e ushqimit. Në njërin anë përpiqet të zbrazë makinën larëse të enëve dhe në anën tjetër u flet atyre që po grinden. Pastaj në vetvete thotë për bashkëshortin: "Nuk paska pasur kohë

për fëmijët për shkak të punëve që nuk mbarojnë! Shiko, fëmija nuk shkoi dot edhe në shëtitje që bëhet një herë në vit. E çfarë? Nuk paska qenë në dijani për këtë! Ç'është kjo punë kështu? U bë një muaj që djali na tregon datën e shëtitjes..."

Në ato momente bashkëshorti hyn në shtëpi. Në dorë ka qesen e bukës dhe qesen me porositë e disa të tjera që janë mangët. Është lodhur gjatë gjithë ditës. Mbi të gjitha, ditët e fundit është rritur numri i atyre që janë hequr nga puna. Çdo ditë po shtohet numri i shokëve që nuk u rezistojnë kushteve të rënda të punës në kompani. Edhe sot, një i ri i fejuar, doli duke bërë titur me të madhe. Ai mendonte se, sikur i riu të ishte i martuar, nuk do ta ndahej kaq lehtë nga puna. Krahas këtyre mendimeve, në shtëpi nuk donte të shkonte duarbosh. Kështu që i mori ato që i kishin ngelur në mendje dhe u nis për në shtëpi. Kur burri hyri në kuzhinë dhe po kërkonte vend për të lënë qeset, i buzëqesh bashkëshortes dhe e pyet:

-Si je? Pastaj, duke i treguar qesen e bukës që ka në dorë, i thotë:

-Merri këto! Nuk e di ku t'i vendos.

Bashkëshortja vazhdon të mendojë aty ku e la më parë dhe i thotë:

-Sigurisht që nuk mund ta dish. Nëse nuk interesohesh për shtëpinë, nuk mund ta dish... Qoftë edhe një herë nuk u interesove për këtë shtëpi...

Burri nxehet:

-Çfarë? Nuk qenkam interesuar fare?

Gruaja përsëri i thotë: -Po, nuk je interesuar fare!, duke shtuar edhe zemërimin që kishte ndaj fëmijëve më parë...

-Fare?

-Po, fare!

Heshtje... Gruaja hesht dhe është e zemëruar. Ndërsa burri i tensionuar dhe i lënduar... Këto biseda i bëjnë çiftet të mendojnë: "Çfarë po flasim? Si arritëm në këtë pikë?"

Debatet fillojnë në një pikë të paimagjinueshme dhe dalin në tema të tjera pa e kuptuar se si ndodh. Edhe kurthet më të mëdha fillojnë këtu. Zemërimet dhe lëndimet burojnë më shumë nga fjalët se sa nga ngjarja për të cilën debatohet. Faktikisht ky është kurthi më i madh i martesave...

Për të mos rënë në kurth, mos u ankoni, por flisni. Dëgjojeni bashkëbiseduesin dhe përsëriteni atë që keni kuptuar.

5

Përfitimet befasuese shëndetësore të Tartufit

Tartufi është një lloj kërpudhe aromatike që përdoret zakonisht në një shumëllojshmëri gatimesh.

Ky ushqim ka fituar vëmendje të gjerë kohët e fundit, duke u bërë i preferuari i kuzhinierëve.

Përveç aromës së fortë dhe të mprehtë që e karakterizon, tartufi është gjithashtu shumë ushqyes dhe lidhet me një sërë efektesh të fuqishme shëndetësore.

Në këtë atikull ju njeh me 5 përfitimet befasuese shëndetësore të tartufit.

I PASUR ME LËNDË USHQYESE TË RËNDËSISHME

Tartufi ka një profil mbresëlënës të lëndëve ushqyese dhe është i pasur me shumë vitamina dhe minerale të rëndësishme.

Ai është i lartë në karbohidrate, proteina, fibra dhe përmban acide yndyrore të ngopura dhe të pangopura.

Gjithashtu ai është i pasur edhe në mikronutrientë, si vitamina C, fosfori, natriumi, kalciumi, magnezi, mangani dhe hekuri.

Hulumtimet tregojnë gjithashtu se tartufi mund të jetë një burim i plotë proteinash, duke siguruar të nëntë aminoacidet thelbësore që i nevojiten trupit.

Megjithatë profili i lëndëve ushqyese mund të ndryshojë midis llojeve. Për shembull, tartufi i bardhë është më i lartë në proteina, yndyrë dhe fibra se llojet e tjera.

I PASUR ME ANTIOKSIDANTË

Tartufi është i pasur me disa antioksidantë të rëndësishëm si vitamina C, likopeni, acidi galik dhe acidi homogjentisik.

Të cilët mund të ndihmojnë në zvogëlimin e rrezikut të sëmundjeve kronike, zvogëlojnë rritjen e qelizave kancerogjene dhe reduktojnë inflamacionin.

KA VETI ANTIBAKTERIALE

Disa studime me epruveta tregojnë se tartufi mund të ulë rritjen e disa llojeve të baktereve.

Megjithatë, kërkimet tek njerëzit mungojnë.

Mund të ndihmojë në vrasjen e qelizave kancerogjene

Edhe pse provat aktualisht janë të kufizuara, disa kërkime sugjerojnë se tartufi mund të ketë veti të fuqishme antikancerogjene.

Një studim tregoi se përbërësit e nxjerrë nga lloje të ndryshme tartufi ndihmuan në bllokimin e rritjes së qelizave të tumorit të mëlçisë, mushkërive, zorrës së trashë dhe gjirit.

Megjithatë, nevojiten studime shtesë për të vlerësuar se si tartufët mund të ndikojnë në rritjen e kancerit tek njerëzit kur hahen dhe jo në formë ekstrakti të koncentruar.

MUND TË NDIHMOJË NË ULJEN E INFLAMACIONIT

Disa studime me epruveta tregojnë se tartufi mund të ndihmojë në reduktimin e inflamacionit për të promovuar shëndetin e përgjithshëm. Megjithatë, nevojiten më shumë studime te njerëzit.



Ushqimet që shtojnë sekrecionet dhe përkeqësojnë shëndetin e fytit

Nëse po luftoni me të ftohurin dhe po përjetoni një infeksion të sinuseve, mënyra e të ushqyerit është shumë e rëndësishme.

Ushqimet që hamë mund të përmirësojnë ose përkeqësojnë situatën dhe në disa raste mund të jetë shkaku kryesor për prodhimin e tepërt të sekrecioneve.

Ju njeh me disa ushqimet që mund të ndikojnë duke përkeqësuar gjendejn tuaj.

ÇOKOLLATA

Çokollata në këtë rast mund të rrisë prodhimin e acidit në stomak, dhe mund të dobësojë sfinkterët e ezofagut.

Sfinkterët në ezofag, lejojnë kalimin ushqimit dhe lëngjeve në stomak dhe parandalojnë acidin e stomakut të lëvizë lart në ezofag, faring dhe laring.

Nëse ata dobësohen dhe acidi i stomakut përfundon atje ku nuk duhet, ju mund të përjetoni ngjirje ose humbje të zërit, kollë dhe gëlbasë në pjesën e pasme të fytit tuaj.

MENTJA DHE NENEXHIKU

Ashtu si çokollata, nenexhiku dhe mentja, mund të përkeqësojnë gjendjen tuaj, veçanërisht nëse keni refluks laringofaringeal (LPR) ose gastroesofageal (GERD).

Ato mund të dobësojnë sfinkterët e sipërm dhe të poshtëm të ezofagut, duke shtuar sekresionet dhe përkeqësuar simptomat e tjera.

KAFEJA

Po ashtu si ushqimet e sipër përmendura, kafeja dobëson shumë sfinkterët e ezofagut, duke lejuar acidin e stomakut të rikthehet në ezofag dhe fyt.

Ky acarim mund të shtojë prodhimin e sekrecioneve.

ALKOOLI

Alkooli gjithashtu mund të dobësojë sfinkterët e

sipërm dhe të poshtëm të ezofagut, duke shkaktuar acarim dhe sekrecione.

Dhe nëse e teproni, ai mund t'ju lërë të dehidruar. Kur jeni të dehidratuar, sekrecionet kanë tendencë të mblidhen dhe të qëdrojnë në fyt më gjatë.

USHQIMET QË KANË SHUMË HISTAMINË

Trupat tanë përmbajnë histaminë, por ka ushqime dhe pije që përmbajnë gjithashtu histaminë.

Këto ushqime janë djathi, kosi, lakra turshi, mi-shi dhe peshku i përpunuar, qershitë, patëllxhani e shumë të tjera.

Nëse keni intolerancë ndaj tyre, ju mund të përjetoni simptoma të ngjashme me një alergji ushqimore, duke përfshirë rritjen e prodhimit të sekrecioneve.

PIJET E GAZUARA

Edhe pse ky nuk është një problem për shumicën e njerëzve, mund të jetë i tillë për njerëzit që përjetojnë reflukse të shpeshta.

Gazi në këto pije, mund të shkaktojë gogësima dhe si pasojë të nxisë refluksin dhe t'ju shtojë sekrecionet.

USHQIMET QË SHKAKTOJNË ALERGJI

Qumështi, vezët, kikirikët, soja, susami, janë disa nga ushqimet e zakonshme, që shkaktojnë alergji.

Krahas simptomave tipike të alegjive nga ushqimi, si kruarje, ënjtje, marrje mendsh ose të vjella, ju mund të përjetoni simptoma në pjesën e fytit ose mushkërive. Simptomat mund të jenë: shtim i mukosit, vështirësi në frymëmarrje, kollitje ose ënjtje e fytit.

Megjithatë, ka shumë ushqime tek të cilat ju mund të mbështeni në rast se përjetoni shtim të sekrecioneve.

Disa prej tyre janë: ushqimet pikante; supa; ushqimet e pasura në fibra si frutat, legumet, perimet, drithërat.



Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar


5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR
(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË





“Urdhëroji njerëzit e tu
të falin namazin
dhe ji i vazhdueshëm
edhe vetë në të.
Ne nuk kërkojmë
furnizim prej teje,
Ne jemi ata
që të furnizojmë ty.”

(TaHa, 132)